# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor në Fizikë", i Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti i Tiranës"**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. **Prof. Dr. Partizan Malkaj**
2. **Dr. Niko Hyka**


**Prill / 2023**

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për programin e studimit Bachelor në "Fizikë"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Fizikës |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Fizikë" |
| 4 | Urdhëri/ VKM i licencimit: | Urdhër i Ministrit të Arsimit Nr. 31, datë 30.12.1994 |
| 5 | Urdhëri/ VKM i riorganizimit: | Shkresë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 7897 datë 14.02.2005 |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 297, datë 20.07.2012 |
| 7 | Urdhëri/ VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite/ 6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | Jo |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit: (v.a 2021- 2022) | 29 PAE/ 4 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | v.a 2017 -2018, 74 Studentë<br>v.a 2018 -2019, 37 Studentë<br>v.a 2019 -2020, 26 Studentë<br>v.a 2020 -2021 23 Studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Fizikë ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës. Programi i studimit Bachelor në Fizikë u aplikua në Departamentin e Fizikës në vitin 2005 me shkresë të MASH Nr. 7897 datë 14.02.2005, me organizimin e ri të programeve të studimit në kuadrin e Marrëveshjes së Bolonjës.
Bazuar në të dhënat që mbështesin RVB, funksionimi i këtij programi mbështetet në një përvojë të gjatë të mësimdhënies e cila i ka fillesat që në vitin 1946, vit në të cilin u themelua Instituti Pedagogjik dyvjeçar. Me themelimin e Universitetit të Tiranës (1957), u krijua Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Katedra e Fizikës. Katedra e Fizikës mbulonte degën e Fizikës, me shtrirje studimesh në katër vjet. Ajo përgatiste mësues të Fizikës për shkollat tetëvjeçare dhe të mesme, si dhe jepte formimin bazë për studiuesit e Fizikës, të cilët përzgjidheshin nga studentët më të mirë të degës. Në vitin 1966 u hap dega e re e Fizikës 5-vjeçare, e cila ndahej nga trungu i Fizikës 4-vjeçare pas vitit të dytë të studimeve dhe përmblidhte një numër të kufizuar studentësh me rezultatet më të mira.

Aktualisht Departamenti i Fizikës ofron programin e studimit të ciklit të parë të studimeve "Bachelor në Fizikë", diplomë që fitohet pas tre vitesh studimi. Mbi të është ndërtuar programi Master i shkencave në Fizikë (dy vjet), Master i shkencave "Mësues Fizike për Arsimin e Mesëm të lartë" (dy vjet).

Referuar përmbajtjes së programit, ai është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës si dhe fushën e veprimtarisë. Ai synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Veprimtaria e tij është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përgatisë individë të kualifikuar, të cilët, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë në fushën e mësimdhënies apo në mënyrë të drejtpërdrejtë në fusha të tjera, kontribojnë në zhvillimin ekonomik të mbarë shoqërisë. Programi i studimit, i përmbahet një strategjie të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të parë të programit të studimit, BSc. Fizikë, ofruar nga Departamenti i Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë Bachelor, pjesë e Kodit të Cilësisë. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, mbështesin vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.
Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e Vlerësimit të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL, sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 103 ditë.
Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në aneks.
Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit, AMS.
Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Partizan Malkaj, Dr. Niko Hyka, dhe Koordinatori Teknik nga ASCAL për këtë proces vlerësimi, z. Muhamed Prezja.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm, ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe Dokumentacioni Mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në FSHN, ku janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Në përgjithësi dokumentacioni i vënë në dispozicion është i plotë dhe mbulon fushat e vlerësimit. GVJ ka konstaton se Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është shkruar qartë në përmbushje të standarteve/kritereve. Informacioni i dhënë është i plotë dhe i referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e të saktë.
Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UT.
GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizititës në institucion. GVJ merr në konsideratë edhe vështirësitë që ka patur institucioni gjatë viteve të pandemisë Covid 19 ku impakti është i dukshëm në veprimtari të ndryshme mësimore, praktika profesionale. etj.
Gjithashtu, GVJ falenderon ASCAL dhe Koordinatorin Teknik për mënyrën e menaxhimit dhe korrektësinë e treguar gjatë gjithë procesit.

Më datë 13.04.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 1/74 Prot., datë 13.04.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 24.04.2023, ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formen përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR NË FIZIKË"**

## I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Programi i studimit Bachelor në Fizikë është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës si dhe fushën e veprimtarisë. Ai synon zhvillimn e traditës së njërit nga programet me historikun më të madh në Shqipëri në fushën e shkencave të natyrës.<br>Programi ofrohet nga Departamenti i Fizikës në FSHN, Universiteti i Tiranës dhe ka si qëllim kryesor përgatitjen e studentëve në fushën e fizikës së përgjithshme, fizikës teorike, të aplikuar etj. **Evidenca 1.1**<br>Programi i studimit synon përgatitjen e një e kategorie të kualifikuarish që mund të japin kontribute në fushën e sshkencave natyrore, kërkimit dhe zhvillimit. Në këtë mënyrë, programi është në funksion të zhvillimit ekonomik, shkencor dhe vlerave kombëtare të vendit. **Evidenca 1.5**<br>Programi është në linjë me synimet dhe misionin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për të përgatitur individë me integritet të cilët në fushën e mësimdhënies apo në fusha të tjera përçojnë interesat dhe vlerat më të mira të kombit. **[www.unitir.edu.al]** |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi synon konsolidimin e vlerave akademike, kulturore e kombëtare të sanksionuara në statutin e UT. Programi i studimit Bachelor në Fizikë është në përputhje me interesat kombëtare dhe ka për qëllim ruajtjen, promovimin e njohurive shkencore e akademike nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke i vënë ato në shërbim të zhvillimit kombëtar. **Evidenca 1.1.** Si programi i vetëm në nivel kombëtar në fizikë, ai merr një rol të rëndësishëm në plotësimin e nevojave që ka vendi në nivel kombëtar për fizikanë me njohuri të avancuara që mund të angazhohen në ciklet e tjera të studimeve, kërkim dhe studime shkencore. **Evidenca 1.1, Evidenca 1.4, Evidenca 10** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | UT është institucioni kryesor në vend me histori shumëvjeccare në zhvillimin e vendit. Kontributi i tij është i rëndësishëm në fushën e edukimit pasi ka qënë dhe vazhdon të jetë institucioni referent për studentët, tregun e punës, administratën publike etj. Programi Bachelor në Fizikë i ofruar nga FSHN, ndër vite ka qënë programi kryesor për formimin e specialistëve të lartënë fushën e Fizikës, dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj të cilët janë tashmë të njohur brenda dhe jashtë vendit. **Evidenca 1.1, 1.2, 1.5**<br>Programi është pikë reference për studentët që kanë pasion dhe duan të japin kontributin e tyre në fizikë. Ai i përgatit ata me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale mbi fizikën si dhe shkencat e jetës, si dhe i ofron atyre të gjithë njohuritë e nevojshme për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit. **Evidenca 1.2, Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin | Programi i studimit është i vetëm në vend i ofruar nga institucionet e arsimit të lartë. Si i tillë, GVJ konstaton se ai mbart vlera të rëndësishme përsa i përket kontributit që jep në formimin e fizikanëve në vend. Për |

| | |
|---|---|
| ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | shkak të rëndësisë që ai ka, jep kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. **Evidenca 1.1**<br>Programi ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e UT dhe është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përgatisë studentë të cilët më pas mund të orientohen në fushën e mësimdhënies, kërkimin shkencor apo në fusha të tjera, duke dhënë kontribut në zhvillimin ekonomik të vendit. **Evidence 1.2, 4, 10**<br>Megjithatë programi shihet nga maturantët si një program studimi që nuk ofron mundësi të mira punësimi e për rrjedhojë numri i studentëve dhe cilësia kanë ardhur në rënie. **Evidenca 1.3.** GVJ e konsideron mjaft problematike vijueshmërinë e programit nëse ai nuk i nënshtrohet politikave mbështetëse qoftë nga ana e institucionit apo nga politikat mbështetëse të qeverisë shqiptare. **Evidenca 11** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Universiteti i Tiranës ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e vet në përputhje me ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", me statutin dhe aktet rregullative të saj. **Evidenca 1.2**<br>UT është organizuar në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e vet. Në statut janë përcaktuar struktura të krijuara në përputhje me strategjinë e zhvillimit, misionin dhe veprimtaritë e institucionit.<br>Në këtë drejtim, edhe programi i studimit është në të njëjtën linjë me strategjinë institucionale në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.<br>Si një nga drejtimet kryesore të UT, shkencat natyrore zënë vend të rëndësishëm në formimin e studentëve të diplomuar nga UT. **Evidenca 1.4**<br>Në përmbushje të misionit, objektivave që ka institucioni dhe programi i studimit, janë hartuar aktet rregullatore të cilat garantojnë zbatimin e tyre. **Evidenca 1.1, Evidenca 1.6** |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Universiteti ka hartuar dhe miratuar Statutin e UT [**Evidenca 1.2**] me Vendim Senati Akademik nr.8 datë 3.11.2016 dhe me Urdhër nr. 90, datë 28.02.2017, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Rregulloren e Përgjithshme të institucionit si dhe në përputhje me to të gjitha aktet e tjera normative të Institucionit. **Evidenca 1.1, 1.3.** Bazuar në këtë statut, UT synon të ruajë profilizimin e tij kryesor në shkencat natyrore, ekonomike, financiare, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, por mbetet i hapur dhe ndaj diversifikimit të ofertës së tij akademike dhe shkencore dhe në drejtime të tjera që lidhen ngushtë me ato të sipërpërmendura, por që vlerësohen se kërkohen nga tregu i punës.<br>Gjithahtu në përputhje me këtë statut, institucioni ka riorganizuar programet e studimit duke reflektuar njëkohësisht detyrimet dhe përcaktimet ligjore të akteve nënligjore të miratuara me VKM ose nga ministria përgjegjëse për arsimin. **Evidenca 1.5**<br>**Evidenca 1.2** Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023, Hyrje. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Programi i studimit është një nga programet e para të hapura në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe ka patur riorganizime në përputhje me aktet ligjore në fuqi. **Evidenca 1.1, 1.3, 1.2**<br>Programi i studimit Bachelor në Fizikë, në emërtim dhe organizim, është në bazë të fushave akademike që mbulon Departamenti i Fizikës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Emërtimi i këtij programi studimi është i njëjtë me programe të ngjashme të ofruar në hapësirën europiane e më gjerë. Ai transmeton tek studentët njohuri themelore të fizikës së përgjithshme, asaj teorike si dhe elementë të fizikës së zbatuar. **Evidenca 1.5.** Organizimi dhe strukturimi i këtij programi studimi është realizuar sipas Statutit të UT dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës. **Evidenca 1.5, 5, 11** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Programi i studimit ka të përcaktuara në përmbajtjen e tij, [4] synimet dhe objektivat duke u fokusuar në formimin dhe kualifikimin shkencor të studentëve që e ndjekin atë në fushën e Fizikës. Qëllimi kryesor është përgatitja teorike me njohuritë e Fizikës së përgjithshme, teorike, aplikative etj. **Evidenca 1.3**<br>Detajet mbi njohuritë e fituara jepen në syllabyset e lëndëve. Programi është konceptuar të japë fillimisht njohuritë themeltare të Fizikës e mandej të thellohet në displina të veçanta të saj. **Evidenca 1.8**<br>Në këtë program përgatiten fizikanët dhe mësuesit e ardhshëm të fizikës për shkollat e mesme nëpërmjet realizimit të ciklit të dytë të studimeve. Bazat konceptuale u jepen studentëve duke integruar materialin teorik me atë eksperimental e praktik.<br>Programi i studimit në objektivat e përcaktuara, ka ofrimin e njohurive të nevojshme për vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë në të njëjtin drejtim ose të ndjekin drejtime të tjera të përafërta ku fizika gjen zbatim. **Evidenca, Tabela 10, Plani mësimor, Tabela 16** |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet | Sikundër përmendëm, programi i studimit ofrohet prej fillimit të veprimtarisë së FSHN dhe UT. Si program i vetëm, ai ka një rëndësi jetike për përgatitjen e studentëve në drejtimin e fizikës. Pavarësisht se tregu i punës nuk oforn mundësi të punësimit të studentëve në institute kërkimore e shkencore, ai konsiderohet i rëndësishëm për faktin se është programi i vetëm që mundëson njohuri të avancuara në fushën e fizikës. Në takimin me drejtuesin e departamentit, u deklarua se institucioni ka hartuar programin në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe programet e ofruara nga Institucione të tjera të Arsimit të Lartë. **Evidenca 1.9:**<br>Institucioni ka bashkëpunime me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit në vend, ku studentët e diplomuar kanë dëshmuar rezultate të larta në karrierë, studime dhe kërkime. Gjithsesi një informacion i plotë mbi këto arritje nuk është paraqitur në dokumentacionin mbështetës. **Evidenca 1.15** |

| | |
|---|---|
| e pritshme në sektorin përkatës. | Megjithatë, GVJ konstaton se pavarësisht politikave të deklaruara, që ndiqen në kuadër të studimit të programit dhe përputhshmërisë së tij me nevojat e tregut, duhet të rishihet mënyra se si programi duhet të ofrohet në të ardhmen. Programi aktualisht rezulton të mos jetë atraktiv për maturantët, ndërkohë nga ana tjetër ai ka rëndësi të madhe për nga natyra që ka në kontekstin kombëtar. **Evidenca 1.10**<br>GVJ rekomandon kryerjen e një analize të mirëfilltë mbi strategjinë e zhvillimit të programit për vitet në vijim. Nëse programi duhet të ruajë profilin e vet aktual, ai duhet të mbështetet me politika specifike nga vetë UT ose nga institucione të tjera të qeverisë dhe politikëbërjes. Nëse programi do të synojë tregun e punës, atëherë ai duhet t'i përshtatet kërkesave që ai ka në mënyrë që të përzgjidhet nga studentët dhe të garantojë punësimin e tyre pas diplomimit. **Evidenca 1.15**<br>Në të kundërt nëse programi është i një rëndësie të veçantë kombëtare ai duhet të mbështetet nga institucioni dhe buxheti i shtetit. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Institucioni deklaron se programi i studimit Bachelor në Fizikë, me objektivat dhe përmbajtjen e lëndëve që bëjnë pjesë në planin mësimor, është projektuar të adresojë nevoja specifike dhe prirje që i përmbushin nevojat e tashme dhe të ardhshme të tregut të punës në fushën e Fizikës, duke iu dhënë mundësi studentëve të punësohen si punonjës në administratë, punonjës në banka, punësim në firma të ndryshme, në varësi të nevojave specifike. **Evidenca 1.3, 7**<br>Megjithatë GVJ konstaton se mundësitë e punësimit pas përfundimit të programit të studimit, janë të limituara bazuar në përmbajtjen e tij. Fakti që tregu i punës është i limituar, programi ka qasje në formimin e avancuar teorik, bën që studenti pas përfundimit të mos jetë i pajisur me aftësi profesionale dhe kompetenca për ti zbatur në tregun e punës.<br>Sigurisht një student i diplomuar në fizikë ka njohuri të avancuara në shkencat natyrore dhe fizikë, cka e bën atë fleksibël të përshtetet shpejt në një drejtim të caktuar. **Evidenca. 1.3**<br>Vetë GVB deklaron se studentët, kryesisht, mund të punësohen me kohë të pjesshme, ose mund të punësoheshin me sukses me kohë të plotë. Për rritjen e pmundësive të punësimit, GVJ propozon përditësime në strukturën e punësimit aktual, ku aktualisht theksi kryesor i vihet diplomës së ciklit Master. **Evidenca 10; Plani mësimor**<br>Si përfundim, ne mendojmë se pas kryerjes së një analize të detajuar mbi mundësitë e zhvillimit të programit në të ardhmen, panorama do të jetë më e qartë nëse fokusi do të jetë punësimi i studentëve bachelor apo ofrimi i programit në përmbajtjen aktuale me formim të avancuar teorik. **Evidenca. 15** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.4**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në | GVJ bazuar në dokumentacionin mbështetës por edhe gjatë vizitës në institucion, konstaton që institucioni disponon infrastrukturën, kapacitetet optimale për të ofruar programin e studimit. Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga njësi mësimore shkencore, si dhe |

| | |
|---|---|
| fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | struktura ndihmëse akademike dhe administrative. Departamenti i Fizikës bashkëpunon me departamente të tjerë brenda FSHN në ofrimin e programit. **Evidenca 17.2**<br>Të gjitha departamentet e FSHN, përfshirë dhe atë të fizikës, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademik, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015. **Evidenca 6, 7.**<br>Departamenti i Fizikës dhe aktiviteti i tij akademik, kërkimor e shkencor, është mjaft i gjatë me eksperiencë, e cila është konsoliduar vit pas viti. Departamenti përbëhet nga 20 anëtarë, nga të cilët 2 me titullin Prof., 6 me titullin Prof. Asoc., 11 me gradën Dr. dhe 1 me gradën MSc. **Evidenca CV e Stafit**<br>Funksionojnë 4 grupe mësimore, me nga 5 anëtarë personel akademik me kohë të plotë. Stafi në fjalë është PAE. Ndërkohë DF gëzon edhe bashkëpunim me PAK me kualifikime të ndryshme shkencore. Gjithsesi ngarkesa akademike për këtë program studimi mbulohet në masën 90% nga PAE me kohë të plotë, nga 70 % që është detyrimi ligjor. **Evidenca 1.4, Ngarkesa e Personelit**<br>Sidoqoftë, meqë numri i pedagogëve që mbulojnë programin e studimit është i lartë, numri i orëve mbi normë nuk është i lartë, gjë që iu jep kohë të mjaftueshme stafit akademik për kërkim shkencor. **Evidenca 6, Tabela, Personeli Akademik**<br>Nga sa përshkruam më sipër, Departamenti i Fizikës demostron se ka përvojën, kapacitetin dhe burimet e duhura në fushën akademike, specifike për ofrimin e programit Bachelor në Fizikë. Ky program është ofruar pa ndërprerje që nga konceptimi i tij në kuadrin e reformave të ndërmarra për respektimin e marrëveshjes së Bolonjës.<br>Programi i studimit, Bachelor në Fizikë synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme, si dhe formimin e shprehive të veçanta në fushën e Fizikës. Ky program studimi realizohet me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja është 3 vite akademike. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diplomë universitare Bachelor në Fizikë. Evidenca 10, programi i studimit. **Evidenca 1.4, Plani strategjik i UT**<br>Gjatë vizitës në isntitucion u evidentua se personeli akademik i departamentit jep një kontribut të rëndësishëm në aktivitete shkencore, botime, pjesëmarrjet në konferenca shkencore, etj. **Evidenca 1.16** |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës përgatit specialistë në fushat e shkencave natyrore, shkencave kompjuterike dhe specialistë me karakter inxhinierik. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programeve të studimit që Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Fizikës ofron janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHN. Programet në tërësi si dhe ai i BSc. në Fizikë, janë organizuar duke patur në konsideratë mundësinë e klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. **Evidenca 1.1, 1.3.**<br>Programi mbështet formimin e përgjithshëm dhe specifik në fizikë, me fokus përgatitjen e specialistëve në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare. Referuar planit mesimor, ai organizohet në 180 kredite; përkatësisht 60 kredite në çdo vit akademik dhe kohëzgjatja normale e këtij programi studimi është tre vite akademike. **Evidenca Plani mësimor 1, 2, 3, 4**<br>Programi është në linjë me synimet dhe misionin e UT-së ashtu sikundër paraqitet në statutin e institucionit, mbi zhvillimin e aftësive, |

| | |
|---|---|
| | kompetencave dhe aftësive të studentëve, të nevojshme këto për t'u bërë ekspertë të denjë të fushës së mësimëdhënies. Edhe emërtimi i programit të studimit, Bachelor në Fizikë është i njëjtë me emërtimin e vetë Departamentit. **Evidenca 4** |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Fizikës, i cili mbulon numrin më të madh të lëndëve/moduleve si dhe ofron infrastrukturën kryesore laboratorike në funksion të programit të studimit. **Evidenca 10, Plani mësimor.**<br>Ndërkohë për lëndët e tjera të formimit të përgjithshëm, japin kontribut personel i angazhuar nga depratamentete të tjera të FSHN ose nga njësi të tjera të UT. **Evidencë, Aneks, Tabela 9**<br>Emërtimi, fusha e veprimtarisë së departamentit, personeli akademik i angazhuar dhe veprimtaritë që zhvillohen, janë në të njëjtën linjë me programin e studimit.<br>Programi ofron grupe lëndësh, modulesh të cilat grupohen sipas percaktimeve nga A-E të VKM 41, e ndryshuar. Programi reflekton eksperiencat më të mira të institucioneve perëndimore të cilat ofrojnë të njëjtën profil programi studimi. **Evidencë, Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive, Aneks, Tabela 10** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Departamenti i Fizikës për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda Fakultetit të Shekncave të Natyrës nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. **Evidenca 1.6, Regullore e brendshme e Departamentit.** Mbarëvajtja e programit të studimit garantohet nga një bashkëpunim i ngushtë me departamente të tjera brenda FSHN. **Evidenca, Tabela 9, Plani mësimor**. Për mbarëvajtjen e programit të studimit, marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së UT dhe janë në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë.<br>Siç pasqyrohet në planin mësimor, disa lëndë në program mbulohen me staf akademik të degëve Matematikë, Informatikë dhe Kimi. Përveç kësaj në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor, angazhohet edhe staf akademik me kohë të plotë i Qëndrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar, e cila është njësi bazë e UT. **Evidencam Tabela 12, Plani mësimor 1, 2, 3, 4.** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të | Referuar dokumentacionit mbështetës por edhe gjatë vizitës në institucion, është deklaruar se UT ka një veprimtari të lartë mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve, në zgjerimin e rrjeteve ndërkombëtare të |

| | |
|---|---|
| studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj. | kërkimit shkencor. **Evidencër Tabela 5, Institucionet bashkëpunuese 17.1, 17.2.** Në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruarar Departamenti i Fizikës ka patur bashkëpunime me Universitetet e Barit, Valladolid dhe Pavias, bashkëpunim shkencor me "International Center for Relativistic Astrophysics Netëork", bashkëpunim me Universitetin e Ferraras, Italy, marrëveshje për krijimin e një Dual Master's Degree në Fizikë, bashkëpunim me National Institute of Nuclear Physics, Italy, etj. **Evidenca 1.13, Marrëveshje Bashkëpunimi.** Këto bashkëpunime kanë ndihmuar në organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare si dhe për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, në përputhje me fushën e studimit dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kualifikimin e personelit akademik. **Evidenca 1.12, Raport vjetor**<br>Disa nga aktivitetet kryesore të organizuara janë: Konferenca Shkencore: "1st International Conference on Applied Physics (ICAP 2019), November 20-22, 2019", "The Third International Ëorkshop on recent LHC results and related topics in Tirana", etj. **Evidenca 1.12, Raport vjetor, Tabelat 19, 20.** |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Departamenti i Fizikës dhe fakulteti, hartojnë raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. **Evidenca 1.12, Raport vjetor i Departamentit.**<br>Gjithashtu departamenti kryen analiza mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit që janë pjesë e analizës vjetore të Departamentit të Fizikës, dhe konsistojnë në vlerësimin e mobiliteteve të stafit dhe pedagogëve dalës dhe hyrës, në komunikimin e eksperiencës së fituar tek anëtarët e tjerë të personelit akademik, dhe nxitjen e mobiliteteve të stafit dhe studentëve. Megjithatë GVJ indentifikoi se përvec analizave të ecurisë së veprimtarive akademike, institucioni duhet të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme edhe zhvillimet në tregun e punës dhe punësimin e studentëve. **Evidenca 1.14: Raport vjetor i FSHN 2019-2020, Evidenca 1.15: Raport vjetor i FSHN 2020-2021, Evidenca 1.16: Raport vjetor i FSHN 2018-2019** |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | Në programin e studimit BSc. Fizikë kryesisht studiojnë studentë të cilët më pas profilizohen në programin profesional të mësuesisë, referuar deklarimeve të përfaqësuesëve të departamentit. **Takimi me personelin akademik**<br>Nisuar nga fakti se cikli i parë i studimeve garantojnë punësim të studentëve pas përfundimit të tyre, GVJ nuk e vëren në këtë program studimi. Vërtet në program nuk mund të përfshihet praktika mësimore në mësimdhënie, por elementë të ndjekjes së procesit mësimor apo praktika në institucione, biznese është e mundur me qëllim që studentët që mund të mos duan të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë, të kënë mundësi të punësohen pas përfundmit të studimit. **Evidenca 1_12.**<br>Në këtë kontekst, GVJ evidenton si jo të plotë mospërfshirjen e orëve për praktikat profesionale në planin mësimor dhe sugjerojmë përfshirjen e praktikës profesionale në vitin e tretë të studimeve. Përsa i përket marrveshjeve për zhvillimn e tyre, GVJ evidenton se isntitucioni ka bashkëpunimet e nevojshme. **Evidenca, Tabela 12, Plani mësimor.** |
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të | Sikundër përmendëm, për këtë program nuk ofrohen trajnime profesionale cka konsiderohet e metë. Sipas deklarimeve, vetëm në përfundim të ciklit të dytë për studentët që mbrojnë temën e diplomës, |

| | |
|---|---|
| mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | ofrohen mundësi trajnimi në Qëndrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe veçanërisht së fundmi pranë disa qëndrave spitalore. Edhe njëherë ritheksojmë nevojën që kanë edhe studentët e programit bachelor. **Takimi me studentë, takimi me personelin akademik.** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Organizimi i programit bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e AI dhe reflekton të gjitha kërkesat e parashtruara në VKM Nr. 41. datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", e ndryshuar dhe shtesat e udhëzimit përkatës dhe praktikat më të mira evropiane. **Evidenca 1.5 Rregullore e UT**. Universiteti i Tiranës ofron programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi i ciklit të parë Bachelor në Fizikë realizohet me 180 kredite, cdo vit akademik përmban 60 kredite në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplonore dhe plotësuese. **Tabela 9, 10 Plani mësimor**. Ai, konform legjislacionit në fuqi, është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarive formuese, duke i ndarë ato. **Evidenca 111, syllabuset** |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Programi i studimit të ciklit të parë, BSc. Fizikë synon aftësimin teorik të studentëve në fushën e shkencës së fizikës. **Evidenca 1_3.** Njohuritë që studentët marrin janë të fushave të ndryshme që shkojnë nga matematika, fizikë e përgjithshme, fizikë teorike, fizikë kompjuterike, etj. **Tabela 9, 10 Plani mësimor.** Kategorizimi i lëndëve në lëndë të kulturës së përgjithshme, përgatitje për disiplinën shkencore, nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje si dhe lëndë plotësuese, lejon që studentët gjatë ciklit të studimeve të fitojë njohuri mbi një shumëllojshmëri displinash bazë dhe atyre të specializuara. **Evidenca Plani mësimor**<br>Njohuritë e tyre, siç është e natyrshme, janë në pjesën më të madhe nga shkencat e natyrës dhe kryesisht në displina të Fizikës dhe Matematikës. Gjithashtu ata marrin njohuri gjuhe si dhe studiojnë gjuhën angleze. **Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të | Referuar dokumentacionit mbështetës, programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor në Fizikë" përmban të gjithë elementët që përbëjnë |

| | |
|---|---|
| përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar si dhe aktet nënligjore. **Plani mësimor** Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS dhe mbështetet në traditën shumëvjecare, duke i pajisur studentët me njohuri bazë dhe të avancuara në drejtimet e fizikës së përgjithshme (Fizika I, II, III, IV dhe V) dhe në disiplinave teorike bazë (Mekanika Analitike, Bazat e Elektrodinamikës Klasike, Bazat e Mekanikës Kuantike, Mekanikë Statistike, Fizikë Atomike, Strukturë e Lëndës, Fizikë Bërthamore). **Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve**<br>Përveç këtyre lëndëve bazë, studentët përfitojnë nga kurrikula, njohuri mbi grimcat elementare që konsiderohet si një prej drejtimeve bazë të fizikës moderne sot. Gjithashtu ata marrin njohuri mbi Elektronikën, Fizikën e Zbatuar (e cila mbështetet mbi baza bashkëkohore), Fizikën e Lazerave si dhe Fizikën e Mjedisit, Biofizikën si dhe Energjinë e Rinovueshme. **Evidenca, Tabela 9 Plani mësimor, Aneks Tabela 10 Plani mësimor.** Provimi përfundimtar kryhet pas përfundimit të studimeve dhe studenti diplomohet vetëm kur janë shlyer të gjitha detyrimet akademike. Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës. **Evidenca, Rregullore FSHN**. **Evidenca 10 -suplementi** |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Përveç zhvillimit të njohurive dhe aftësive bazë, studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Fizikë, studentët fitojnë njohuri të avancuara si p.sh. sistemet komplekse, të realizojnë simulime të sistemeve reale apo modelime të tyre si psh në fushën e Biofizikës së zbatuar. **Syllabuset e lëndëve.**<br>Studentët marrin bazat e nevojshme për simulime të ndryshme në Fizkë duke përdorur teknikat moderne të programimit. **Evidenca 1, 2, 3, 4 Plani mësimor.**<br>Ata marrin informacion mbi shkencat klimaterike, shkenca mjedisore, metoda të dedektimit të rrezatimeve, njohuri në kryerjen e analizës së të dhënave, njohuri që përdoren sot në fusha si ekonomia, parashikimi i motit, fizika e atmosferës si dhe përgatiten për vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë master profesional ose shkencor. **Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve.** |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Struktura e programit të studimit Bachelor në Fizikë është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 3 vite studimi / 6 semestra, me 180 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup lëndë sipas kategorive të formimit. **Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve.**<br>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale i atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, si dhe programit të studimit në tërësi.<br>Veprimtaritë si: mësimi në auditor, leksionet, seminaret, laboratorë, vlerësimi i vazhdueshëm në detyra kursi etj, përgatit studentit me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme. Megjithatë nga diskutimi me studentët e programit u evidentua fakti i ngarkesës së madhe në lëndë dhe në orë mësimore. **Evidenca 1,2,3,4 plani mësimor.**<br>Programi përmban 22 lëndë (173 kredite ECTS), dhe provim diplome me 7 kredite). Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe.<br>të programit të studimit Bachelor në Fizikë (Dosje e Programit të Studimit). **Evidenca Tabela 9, Plani mësimor (tabela përmbledhëse)** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Në strukturën e vet, programi i studimit është organizuar në përputhje me bazën aktuale ligjore në fuqi si dhe në praktikat më të mira të universiteteve perëndimore. **Plani mësimor (tabela përmbledhëse)**<br>Shpërndarja e lëndëve/moduleve në përmbajtje të programit është organizuar sipas kategorive (A-E) në bazë të VKM nr 41 të ndryshuar. Konkretisht 32 kredite kanë në 3 lëndë që përbëjnë 18% të numrit të plotë të krediteve të ciklit të studimit dhe i përkasin kategorisë A, 99 kredite tek B ose 55% të shpërndara në 12 lëndë, 24 kredite ose 13% tek kategoria C, të shpërndara në 3 lëndë, 18 kredite ose 10% në kategorinë D në 4 lëndë, dhe së fundmi 7 kredite ose 4% i përkasin detyrimeve përmbyllëse të kategorisë E/ provim diplome. **Plani mësimor**<br>Çdo vit përmban 60 kredite, një kredit është i barazvlefshëm me 25 orë totale nga të cilat gjysma është në auditor. Ekuivalenca në orë e vitit akademik është 1500 orë. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Fizikës, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. **Evidenca 6**<br>Kjo njësi zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe Rregulloren e UT, Rregulloren e FSHN. **Evidenca 1_1, 1_3, 1_6**<br>Departamenti ka një eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve të fizikës nga kua kanë dalë breza të diplomuarisht, personalitete të njohur brenda dhe jashtë vendit. Në përmbushjen e detyrimeve ligjore, departamenti rezulton të jetë ndër më të konsoliduarit përsa i përket numirt të stafit në raport me nr. e programeve që ofron dhe kualifikimet resektive të stafit. **Evidenca Lista e Stafit**<br>Pjesë e personelit akademik që ka në dispozicion departamenti, zhvillojnë veprimtarinë e tyre mësimore dhe personeli i Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar, duke rritur në këtë mënyrë kapacitetet akademike e shkencore të departamentit. **(tabela përmbledhëse) Evidenca lista e stafit të IFZ**<br>Ndërkohë ndryshimet në tregun e punës dhe orientimi i studentëve drejt programeve inovative dhe teknologjisë së informacionit, ka bërë që programi të ketë sfidë numrin e studentëve. **Evidenca 1.4 Plani strategjik i zhvillimit të departamentit të Fizikës, FSHN UT, 2017-2027.**<br>Duke marrë në konsideratë numrin e ulët të rpogrameve që ofron departamenti, numrin e ulët të studentëve, raportet e përcaktuara në standartet e Kodit të Cilësisë përmbushen plotësisht. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e | GVJ evidenton se në kuadër të organizimit dhe mirëfunksionimit të veprimtarisë brenda Departamentit të Fizikës, dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore, personeli akademik i Departamentit ka si person përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit, drejtuesin e njësisë bazë. **Evidenca 19** |

| | |
|---|---|
| koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | Janë emëruar koordinatorët e marrëdhënieve me studentët për çdo vit të ciklit të studimeve, të cilësuar "Tutorë" të cilët janë përgjegjës për koordinimin e marrëdhënieve të departamentit me studentët. **Evidenca 1.3 Rregullore e programit.**<br>Koordinatori programit të është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon Përgjegjësin e departamentit, personelin e departamentit dhe përgatit informacione të tjera të nevojshme për procese të ndryshme. **Evidenca 6** |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës, si pjesë integrale e strukturës akademike të Universitetit të Tiranës, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Nga minimumi 3 departamente, që është detyrimi ligjor, njësia kryesore është përbërë nga 8 departamente: **Evidenca 4.2**<br>Departamenti i Biologjisë, Departamenti i Bioteknologjisë, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Informatikës, Departamenti i Kimisë, Departamenti i Kimisë Industriale, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Matematikës së Aplikuar dhe një qendër kërkimore, Qendra Kërkimore e Florës dhe e Faunës. **Evidenca Struktura e FSHN. Evidenca Tabelat 1dhe 2: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë, FSHN.**<br><br>Departamenti i Fizikës në përbërje të vet ka 20 personel akademik me kohë të plotë prej të cilëve 2 PAE me titullin Profesor, 6 me titullin Profesor i Asociuar, 11 Doktor dhe 1 PAE Master i Shkencave. **Cv e stafit**<br>Personeli i angazhuar ka eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe m ekontribute të cmuara në jetën akadmeike e shkencore të vendit. **Evidenca Tabelat 6.1,6.2,6.3 Stafi mësimdhënës. Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës.** |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Personeli akadmeik i Departamentit të Fizikës përbëhet nga 20 personel akademik efektiv. Nga këta, 2 janë me titullin Profesor, 6 me titullin Prof. As. 11 kanë gradën Dr dhe 1 PAE është MSc. **Tabelat përmbledhëse (tabela 1)**<br>Përveç stafit të Departamentit të Fizikës, në programin e studimit Bachelor në Fizikë, janë angazhuar edhe staf akademik nga Qëndra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, Departamente të tjera të FSHN si dhe staf jashtë njësisë kryesore. **Aneks Tabelat 1 dhe 2 "Numri i personelit akademik, Tabelat 6.1,6.2,6.3 "Cilësia e stafit mësimdhënës.**<br>Ndërkohë pranë departamentit angazhohet dhe personel i jashtëm ose i ftuar nga institucionet partnere brenda vendit.<br>Nga sa më sipër rezulton se Departamenti i Fizikës përmbush detyrimin për kulaifikimin e personelit akademik dhe në gjykimin e GVJ plotësimi i këtij kriteri është një nga pikat më të forta të departamentit. **Evidenca Tabelat 6.1,6.2,6.3 Stafi mësimdhënës. Tabelat 12**<br>Në përbërje të Departamentit të Fizikës funksionojnë grupet kërkimore të Fizikës së përgjithshme dhe didaktikë (5 anëtarë), Fizikë e Materies së Kondensuar (5 anëtarë), Fizikë e Grimcave Elementare dhe Astrofizika (4 anëtarë), Biofizika, Fizika Mjekësore dhe Mjedisi (6 |

| | |
|---|---|
| | anëtarë). **Anex Tabelat 12 Plani mësimor, Aneks Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik.** |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Shkencave të Natyrës një nga fakultetet më të vjetra të UT. FSHN është i përbërë nga 9 njësi bazë si vijon: **(Evidenca 4.2)**<br>- Departamenti i Biologjisë<br>- Departamenti i Bioteknologjisë<br>- Departamenti i Fizikës<br>- Departamenti i Informatikës<br>- Departamenti i Kimisë<br>- Departamenti i Kimisë Industriale<br>- Departamenti i Matematikës<br>- Departamenti i Matematikës së Aplikuar<br>- Qendra Kërkimore e Florës dhe e Faunës.<br>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion, GVJ konkludon se FSHN dhe Departamenti i Fizikës janë të konsoliduar përmbushin detyrimet ligjore dhe kriteret e cilësisë për organizimin dhe strukturën akademike. **Evidenca Aneks, Tabelat 6.1, 6.2, 6.3** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Departamenti i Fizikës është përgjegjës për organizimin e tre programeve të studimit Bachelor në Fizikë, Master Profesional në Mësuesi dhe Master Shkencor në Fizikë. **Evidenca 18.1, 18.2**<br>Departamenti disponon dokumentacionin e plotë lidhur me programet e studimit si dosjet e programeve të studimit, cv e personelit akademik të Departamentit të Fizikës që japin mësim në programin e studimit, planet mësimore, syllabuset e lëndëve. **Evidenca Aneks Tabela 10 Plani mësimor**<br>Ndërkohë bazuar në rregulloren fakultetit dhe departamentit, Departamenti i Fizikës mban informacione dhe të dhëna që lidhen edhe me veprimtaritë akademike që departamenti zhvillon. Këtu përfshihet ngritja e komisioneve të provimeve, diplomimeve, komisioneve ad-hoc. **Evidenca 7** |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | Ndarja e lëndëve/moduleve bazohet në karakteristikat specifike të veprimtarive formuese: **Evidenca 1, 2, 3, 4, (plani mësimor)**<br>- -A. Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme(32 kredite – 18%).<br>- B. Lëndë të formimit karakterizues: përgatitje për disiplinën shkencore: (99 kredite – 55%).<br>- C. Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese: Lëndë të formimit të ngjashëm ose/dhe integruese me lëndët karakterizuese si dhe lëndë formuese të zgjedhura nga studentët: (24 kredite – 13%).<br>- D. Lëndë Plotësuese: Lëndë formuese dhe aktivitete që lidhen me përftimin e aftësive për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës si: për njohje të gjuhës së huaj, informatikës, (18 kredite –10%). |

| | |
|---|---|
| | - E. Detyrime Përmbyllëse: provimi i formimit: (7 kredite – 4%).<br>Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit. Ai paraqet informacionin e nevojshëm dhe sqaron të gjitha aspektet e rëndësishme. Plani mësimor pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilës prej lëndëve të programit të studimit përgjatë vitit akademik. Në planin mësimor të programit të studimit Bachelor në Fizikë paraqiten: **(Evidenca syllabuset e lëndëve)**<br>- Emërtimi i lëndëve të grupuara dhe të renditura në semestra;<br>- Numri i krediteve për çdo lëndë dhe raporti i orëve (leksione, seminare, laboratore, detyra praktike, etj.);<br>- Detyrimet sipas lëndëve (pjesëmarrja në seminare, vlerësime të ushtrimeve, vlerësim i aktivizimit në klasë, detyra kursi, detyra kontrolli të ndërmjetme, dorëzim i punëve të laboratorit, etj.);<br>- Periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve të çdo lënde (provim i pjesshëm, provim final, detyra kursi);<br>- Mënyra e zhvillimit të provimit final e cila për çdo lëndë që parashikon provim final është me shkrim dhe me zë. Për lëndët me vlerësim të vazhduar, për të cilat nuk parashikohet provim final, mënyra e vlerësimit specifikohet në syllabus.<br>Plani mësimor miratohet nga Përgjegjësi i njësisë bazë, Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UT-së. **Aneks Tabela 10 (Plani mësimor i programit të ciklit të parë në Fizikë), Evidenca 11.** |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Programi i studimit Bachelor në Fizikë është i strukturuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, njëkohësisht në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së. **Evidenca 11.**<br>Në këtë program studimi, lëndët grupohen sipas kategorive të përcaktuara duke pasur të specifikuar ngarkesën përkatëse në kredite. Për të përfunduar studimet dhe fituar diplomën e programit, studentit i nevojiten 180 kredite (ECTS). Një vit akademik i studimeve përmban 60 kredite (ECTS).Programi i studimit Bachelor në Fizikështrihet përgjatë 3 (tre) viteve akademike. Secili prej tyre organizohet në 2 semestra ku secili zgjat 14-15 javë mësimore, në përputhje me planin mësimor. **Evidenca 1.8 Suplementi i diplomës (dosja e programit të studimit)**<br>**Aneks Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E); Evidenca 1.4.** |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: **(Evidenca tabela përmbledhëse Tabela 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)**<br>- mësim në auditor në formën e seancave të zhvilluara në auditor ku përfshihen: leksionet, seancat e seminareve,seancat laboratorike;<br>- ngarkesën në kredite për seilën lëndë;<br>- tipologjia e lëndës;<br>- mënyra e shlyerjes së saj.<br>- përgatitje për provime të ndërmjetme dhe përfundimtare;<br>- përgatitje për provimin e formimit;<br>- përgatitje për detyra kursi në lëndë apo module specifike, etj.<br>Ndarja e ngarkesës mësimore në auditor në orë fizike sipas zërave përkatës (leksione, seminare/ushtrime e laboratorë), për secilën lëndë apo modul përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit. Sasia |

| | |
|---|---|
| | e orëve që përcaktohet për secilën lëndë apo modul kryhet në bazë të krediteve përkatëse. **Aneks Tabela 9**<br>Sasia mesatare e punës e parashikuar për një student gjatë një viti akademik në këtë program studimi është 60(gjashtëdhjetë) kredite ose 60×25= 1500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e numrit të përgjithshëm, pra jo më pak se 750 orë mësimore vjetore. **Evidenca 1_3**<br>Studenti konsiderohet se i fiton kreditet e lëndës apo modulit vetëm nëse ky i fundit merr vlerësim kalues. Vlerësimi kalues bëhet sipas syllabusit të lëndës ku parashikohen: kontroll i vazhdueshëm përfundimtar i dijeve, zërat e vlerësimit, pesha e secilit zë, etj. **Aneks Tabela 10, Evidenca 2.2 Syllabuset e lëndëve.** |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Programi i studimit Bachelor në Fizikë ofron të gjithë informacionin e nevojshëm, ku përfshihen kriteret e përgjithshme dhe specifike, të cilat lidhen me pranimin apo ripranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, për studentët e interesuar.Pranimi i studentëve në programin e ciklit të parë në Fizikë kryhet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1,të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, Udhëzim i MASR, Nr.10, datë15.05.2019, Udhëzim i MASR Nr.19, datë 10.09.2019, për vitin akademik 2021–2022.<br>Pranimi i studentëve në programin e studimit është i përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit. **Evidenca 1_3, 1_6**<br>Transferimi i studimeve po ashtu parashikohet dhe mbështetet në Rregulloren e FSHN-së ku parashikohen dhe rregullohen procedurat për:<br>- transferimi i studimeve;<br>- transferimi i studimeve në të njëjtin cikël studimi;<br>- transferimi dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen drejt Unversiteti të Tiranës;<br>- transferimi dhe ekuvalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen drejt universiteteve të tjera.<br>**Evidenca 1.5, Evidenca 2.6, www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Liria akademike në hartimin dhe përditësimin e syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të programit të studimit është pjesë e veprimtarisë së departamentit. **Evidenca 1_6.** Cdo ndryshim apo reflektim në syllabuse hartohen nga titullari i lëndës në përputhje me formatet e miratuara dhe përmbajnë: **Evidenca: syllabuset e lëndëve**<br>- Titullari/pedagogu i lëndës;<br>- ngarkesa (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminare,praktika etj.);<br>- tipologjia e lëndës (përfshirë nëse lënda është e detyrueshme ose me zgjedhje)<br>- viti akademik/semestri kurzhvillohet;<br>- programi i studimit ku ofrohet kjo lëndë;<br>- mënyra ekontrollit të dijes (frekuentimi dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve),<br>- zërat e vlerësimit (në përqindje) dhe notat sipas intervaleve të pikëve;<br>- kodi i lëndës dhe adresa elektronikee titullarit/e pedagogut të lëndës<br>- parqaqitje e detajuar e temat që diskutohen në leksione, seminare apo laboratore;<br>- literatura bazë e detyrueshme dhe e rekomanduar. |

| | |
|---|---|
| | Sipas deklarimeve në takimin me personelin akademik, cdo pedagog depoziton në fillim të vitit akademik në njësinë përkatëse programin lëndor (syllabusin) e lëndës. Syllabuset e moduleve dorëzohen te titullari përkatës i cili i depoziton më pas në njësinë përkatëse. Në fillim tëlëndës/modulit çdo pedagog ju paraqet dhe sqaron studentët rreth syllabusin të lëndës së bashku me modalitetet e parashikuara në të për zhvillimin e mësimit. **Evidenca: syllabuset e lëndëve**<br>Në dosjen e programit të studimit Bachelor në Fizikë është prezantuar i gjithë informacioni i nevojshëm, ku përfshihen të gjitha Syllabuset e lëndëve të strukturuara sipas legjislacionit në fuqi. **Evidenca 1.3 Rregullore e programit** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | GVJ konstaton se Departamenti i Fizikës përpiqet në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë programin e studimit duke stimuluar personelin akademik që të përditësojë programet lëndore me literaturën dhe botimet e viteve të fundit. **Evidenca 1, 2,3,4 Planet mësimore**<br>Në kontekstin e përmirësimit të rezultateve të mësimdhënies, stafi akademik është në kontakt me raportin e analizës vjetore të Fakultetit ku një prej treguesve të marrë në konsideratë është mendimi i studentëve përmes pyetësorëve të mbledhur në procesin e vlerësimit të kurseve në fundin e vitit akademik paraardhës. **Evidenca 1.12**<br>Stafi akademik i cili jep mësim në Programin e studimit Bachelor në Fizikë shqyrton rregullisht nevojën për përditësim të materialit lëndor në lëndët apo modulet përkatëse. Ndryshimet, të cilat duhet të ilustrohen në syllabus, nuk e tejkalojnë masën 20 % krahasuar me vitin e mëparshëm akademik. Ndryshimet zyrtarizohen nëpërmjet miratimit nga ana e senatit akademit të UT-së. **Evidenca 1.14 (raporte), 1.6, 2.2, 2.7** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Viti akademik është njësia kohore bazë e studimeve. Një vit akademik përbëhet nga 2 semestra dhe shtrihet në intervalin 29-30 javë mësimore, sipas udhëzimeve MAS (29-30 javë mësim dhe 6-8 javë provime dhe provim formimi/mbrojtje teme diplome). **Evidenca 5.1, 5.2**<br>Fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me Udhëzim të MAS në çdo fillim viti akademik. **Evidenca 1.5.**<br>Çdo semestër zgjat 14-15 javë për mësim dhe mesatarisht 3-4 javë për provime. Organizimi i vitit akademik, datat e fillimit të semestrave dhe sezoni i provimeve, shpallen nga rektori në fillim të vitit akademik. Më pas detajet mbi ditët e mësimit, ditët e pushimeve zyrtare apo detaje të tjera të lidhura me procesin mësimor detajohen në Strukturën Akademike e cila miratohet në fillim të çdo viti akademik. **Evidenca 2.8, 2.9.** Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare e laboratore, pasqyrohen në tabelën online të orarit mësimor. Sasia e këtyre orëve nuk tejkalon kuotën e 25 orëve mësimore 50-minutëshe. **Evidenca 1.3, Evidenca 1.6** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në Fizikë, janë ndërtuar në mënyrë të tillë që ti ofrojë studentëve një formim të plotë dhe solid përsa i përket bazave teorike, konceptuale dhe eksperimentale në Fizikë. **Evidenca 1, 2, 3, 4, (Aneks Tabela 10 plani mësimor)**<br>Qëllimi është që studentët në vijim të kenë mundësi të profilizohen në drejtimet master qoftë në mësuesi, ashtu edhe në drejtimin shkencor. Elementët përbërës si mësimi në auditor (leksione, ushtrime apo laboratorë), kontrollet e vazhdueshme apo detyrat e kursit, kanë dy qëllime bazë. Ato janë në funksion të rritjes së efektshmërisë së mësimdhënies dhe përcjelljes së dijes nga pedagogu i lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit krijues dhe kritik të studentëve.<br>Suplementi i diplomës parashikon edhe punësim potencial për studentët të cilët përfundojnë ciklin Bachelor. **Evidenca 1.8, Evidenca 2.2** |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare,laboratorë, etj, për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë **Evidenca 1_3**. Në programin e studimit Bachelor në Fizikë lëndët kanë raportin leksion:seminar:laborator si në vijim: 4:2:0, 3:2:0, 3:3:3, 2:2:0 ose1:1:0. Lëndë të caktuara, varësisht nga specifikat, mund të parashikojnë detyra kursi apo projekte të tjera specifike me studentët për të nxitur punën e pavarur të tyre. Kështu mundësohet realizimi i pritshmërive të të nxënit dhe familjarizimit me disiplina të ndryshme të Fizikës. **Evidenca Tabela 10, Evidenca 2.2** |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Organizimi i programit të studimit realizohet nëpërmjet moduleve dhe sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve. Lëndët nëprogramin e studimeve Bachelor në Fizikë, janë organizuar nëformë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë pothuaj të njëjtë përgjatë semestrave. **Evidenca 1, 2, 3,4 (plani mësimor)**<br>Raporti i orëve është në varësi të specifikës së lëndës dhe kreditet përlëndë/modul varion nga 2 deri në 14 kredite. Shpërndarja e ndryshme e ngarkesës lidhet me arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Programi i studimit ka ndjekur përgjithësisht përvojën e programeve të ngjashme ndërkombëtare, duke bërë përshtatje sipas nevojave përkatëse. **Evidenca syllabuset**<br>Departamenti i Fizikës është orientuar gjithmonë në procesin e rishikimit dhepërmirësimit të kurrikulës së studimit duke konsideruar në mënyrë tëveçantë orientimin edhe nga kurrikulat e ofruara nga universitete analoge. **Evidenca Aneks Tabela 10, 13** |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Natyra e moduleve të ofruara në programin studimeve Bachelor në Fizikë dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike të informacionit që jep një lëndë apo modul dhe aplikimeve të mundshme praktike. **Evidenca Aneks Tabela 10,** Për ngritjen e këtij programi studimi dhe përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës kurrikulare janë shfrytëzuar eksperienca ndërkombëtare nga vende të zhvilluara dukerritur kështu mundësinë e transferimit apo mobilitetit të studentëve. Kjo rrit ndjeshëm mundësitë për ndjekjen e një programi master në institucione arsimore të tjera dhe pse jo edhe mundësinë e punësimit në ato vende pune që mjafon edukimi **Bachelor.Evidenca 15.** Suplementi i diplomës është bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni Europian, Këshilli i Europës dhe UNESCO/CEPES. |

| | |
|---|---|
| | **Evidenca 14.2.** Qëllimi i suplementit është të ofrojë të dhëna objektive të mjaftueshme për të përmirësuar "transparencën" në shkallë ndërkombëtare dhe njohjen akademike e profesionale te kualifikimeve (diplomave, çertifikatave, niveleve universitare, etj.).Suplementi është konceptuar në mënyrë të tillë që ai të përshkruajë natyrën, nivelin, kontekstin, përmbajtjen dhe statusin e studimeve qëka ndjekur dhe përfunduar me sukses një individ i caktuar. Studentët të ciklit të parë në Fizikë kanë qenë të përfshirë në programin "Erasmus +". **Evidenca 1.8** |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Fakulteti i shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Fizikës analizojnë mbi bazë fakulteti dhe departamenti, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimindhe opinionin e lektorëve por edhe të studentëve lidhur dhe me programin e çdo moduli. **Evidenca 3_5, 3_6**<br>Më pas ndërmerren masa për zhvillimin e mëtejshëm të lëndëve apo moduleve të programit të studimit ku kryesisht parashikohen ndryshime të mundëshme të syllabuseve apo dhe riorganizim i strukturës lëndore. Sikurse është përmëndur edhe më lart, modeli i përdorur për hartimin e syllabuseve, në programin e studimit Bachelor në Fizikë përmban të gjithë elementet sipas përcaktimeve VKM nr. 41. **Evidenca syllabuset** Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë konform këtyre përcaktimeve duke filluar me pasqyrën informative të lëndës,rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli ivazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë ndihmëse. Literatura përzgjidhet duke pasur parasysh tipologjinë e secilës lëndë. Lëndët bazë teorike, të cilat edhe në universitete ndërkombëtare zhvillohen me teskte klasike, kanë një literaturë të përcaktuar. Ndërkohë lëndët apo modulet me karakter më praktik kanë literaturë moderne e cila përditësohet vazhdimisht. **Evidenca 2.2, (tabela përmbledhëse) Aneks Tabela 15** |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. | Programi Bachelor në Fizikë ka disa drejtime klryesore ku më të rëndësishëm janë: **Evidenca 1_3, 1_6**<br>- marrja e njohurive bazë mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme por dhe për formimin e shprehive të veçanta në fushën e Fizikës;<br>- aftësimi në displina të ndryshme bazë të Fizikës me qëllimin për të mundësuar orientimin sa më të lehtë në ciklet pasardhëse;<br>- nxitja e mendimit kritik dhe krijues të studentëve, potencialisht për ti aftësuar ata për kërkim shkencor në të ardhmen;<br>- ambjentimi dhe rritja e vetëbesimit në lidhje me metodat eksperimentale (të cilat janë baza e avancimit në Fizikë) nëpërmjet seancave të shumta laboratorike;<br>- aftësimi me metodat moderne të kërkimit shkencor ku një zë të veçantë zënë metodat numerike.<br>Duhet të theksojmë se përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përftimin e dijeve, aftësive dhekompetencave të synuara të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e çdo lënde në këtë program. **Evidenca 1.2**, 1_4, **Evidenca 2.2, Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve | Përmbajtja e programit Bachelor në Fizikë mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklin Master i Shkencave ose Master i Shkencave në drejtimin "Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë". Përveç kritereve akademike, zgjedhja është në varësi të studentëve të |

| | |
|---|---|
| dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | cilët adresojnë investimin e tyre në dije sipas perspektivës për t`u punësuar në sektorin publik ose privat. **Evidenca 3_12**<br>Stafi Departamentit rregullisht japin mbështetje nëpërmjet letrave të rekomandimit për studentët e tyre për punësim të mundshëm. Studentët që mbarojnë ciklin Bachelor, pothuaj të tërë vazhdojnë studimet Master, ndërkohë që një pakicë punësohen kryesisht në biznese private. **Evidenca 15, Evidenca1.12, 1.13, Evidenca 1.3 Evidenca 5.** |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës organizon Panairet e Karrierës për të ndihmuar studentët në një përqasje më të mirë ndaj tregut të punës si dhe për mundësi punësimi dhe internshipi. Në këto panaire marrin pjesë subjekte publike dhe kompani private të cilat ofrojnë ndaj studentëve pozicionet e tyre vakante. **Evidenca 1_10, Evidenca 2.10**<br>Së fundmi kompania kompjuterike "Division 5" ka shprehur interesin për të bashkëpunuar me Departamentin e Fizikës në lidhje me një angazhim të mundshëm të studentëve të Fizikës për të realizuar internshipe apo për tu punësuar pas diplomimit. Angazhimi qëndron kryesisht në analizë të dhënash, data analysis dhe data science. Bashkëpunimi është listuar në marrëveshjet e FSHN nga viti 2016-2021. **Evidenca 1.9, Evidenca Tabela permbledhese, Aneks Tabela 5** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | x |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshshme, që angazhohet në mësimdhënie në ciklin Bachelor, ka së paku kualifikimin Master Shkencor (MSc.).Ai përmbush në veprimtarinë e tij të gjitha rregullat e parashikuara në rregulloret përkatëse. **Evidenca 1.1.** Ngarkesa e plotë mësimore për personelin akademik në IAL rregullohet sipas Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë dhe udhëzimeve nr. 36, date 23.11.2018 dhe udhëzimit nr.37, datë 04.12.2018 për "Një ndryshim në udhëzimin nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të larte", i ndryshuar. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë "Asistentë Lektorë" punësohen në UT me një kontratë me kohëzgjatje të caktuar. Stafi akademik i angazhuar në programin Bachelor në Fizikë është i përbërë nga personel me titujt Profesor, Profesor i Asociur dhe me gradat Doktor dhe Master i Shkencave. **Evidenca 2.14**, **Evidenca 1.6** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e | Personeli akademik me kohë të plotë qe angazhohet në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Fizikë i plotëson të gjitha kërkesat ligjore në fuqi. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore. **Evidenca 2.14: CV**<br>Në programin e studimit Bachelor në Fizikë, aktualisht, japin mësim: |

| | |
|---|---|
| programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | - **2** Profesorë<br>- **6** Profesorë të Asociuar<br>- **13** Doktorë shkencash<br>- **1** Master i Shkencave<br>**Evidenca Aneks, Tabelat 6.1,6.2,6.3, Aneks Tabela 7, Aneks Tabelat 1dhe 2** |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Në programin e studimit, personeli akademik me kohë të plotë që angazhohet në mësimdhënie ka kualifikimet dhe kompetencën për të zhvilluar me cilësi të lartë programin e lëndës. **Evidenca Aneks Tabela 4** Në CV-të e stafit gjen fushat e tyre të interesit dhe kërkimit që përputhen tërësisht me natyrën e lëndëve apo moduleve që mbulojnë në këtë program studimi. **Evidenca 2.14:** CV |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | Në planin mësimor nuk janë parashikuar praktika profesionale në kuadër të programit Bachelor në Fizikë cka është evidentuar si mangësi nga GVJ. **Evidenca 1,2,3,4**<br>Megjithatë praktika profesionale parashikohet në ciklin Master, për mësuesi të arsimit të mesëm të larte dhe atë shkencor. Praktikat profesionale zhvillohen në institucione, shkolla të mesme, nën drejtimin e pedagogëve të caktuar nga departamenti. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e institucionit ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, personeli akademik që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me qëndrën ku kryhet praktika. Në përfundim të praktikës profesionale, pedagogu i lëndës jep një vlerësim përfundimtar për studentin. Pedagogu që e drejton praktikën merr edhe mendimin e qendrës ku është kryer ajo. Vlerësimi bëhet me notë. **Evidenca 1_3**<br>Përsa i përket punimit të diplomës gjithashtu dhe ajo nuk është e aplikueshme në Ciklin e parë të studimeve Bachelor por aplikohet vetëm në përfundim të ciklit të dytë të studimeve Master. **Evidenca Aneks Tabela 5** |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | GVJ identifikoi se për Programin e studimit Bachelor në DF përdoren laboratorë të cilët mundësojnë formimin praktik të studentëve. **Evidenca 4.13. Evidenca 2.14 CV**. Gjatë këtyre orëve krahas pedagogut të lëndës asistojnë edhe stafi ndihmës akademik që janë përgjegjës për këto laboratore. Në funksion të programit Bachelor në Fizikë, janë të angazhuar 4 staf ndihmës akademik asistojnë pedagogët për një mbarëvajtje të orës së mësimit. Laboratoret zhvillohen në 4 prej lëndëve të Fizikave të Përgjithshme, për lëndën e Elektronikës dhe per lëndën e programimit (informatikes). **Evidenca 2.2, Evidenca 1_6.** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1<br>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | Universiteti i Tiranës në nivel institucional ka ndërtuar një strategji të aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies, veçanërisht e rëndësishme gjatë pandemisë Covid 19. **Evidenca 22.** Çdo njësi kryesore aplikon gjithashtu metoda të tjera në përputhje me specifikën që kanë programet e ndryshme të studimit. Për të patur një rezultat sa më të mirë, institucioni organizon trajnime të stafit akademik kryesisht me qëllime didaktike, për ta orientuar stafin drejt mënyrave sa më efikase të mësimdhënies. **Evidenca 3.1.**<br>Në takimin me stafin akademik, u deklarua se institucioni arriti të menaxhojë mësimin online gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, periudhë e cila kapi dy vite akademike: 2019-2020 dhe 2020-2021.<br>Në platformën Teams, u zhvillua mësimi online me përkushtimin maksimal të institucionit dhe të të gjithë stafit akademik. **Evidenca 4.12.** Institucioni emetoi "Udhëzues bazik Microsoft Teams për stafin akademik", "Microsoft office 365 Teams për staf i detajuar sipas rubrikave", "Microsoft office 365 për studentët", "Manual përdorimi Microsoft teams për stafin akademik". Stafi u trajnua gjithashtu për Clean Score për mënyrën e menaxhimit të një provimi online. **Evidenca 3.3** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies është proces i vazhdueshëm i strukturave të UT në Rektorat dhe në njësitë kryesore. **Evidenca 1.2.** Komisioni për sigurimin e cilësisë, Drejtoria e Kurrikulave dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierrës e ngritur pranë FSHN. Njësia e fakultetit është e përbërë nga dy anëtarë dhe përfaqëson një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ që ka autonomi operative.<br>UT ka në zbatim "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë për institucionin. Gjatë vitit akademik 2020-2021 nga DSBCK janë organizuar me studentë të fakultetit disa vlerësime nëpërmjet pyetësorëve. **Evidenca 3.10**<br>Referuar RVB deklarohet se janë hartuar disa dokumente si statistika, raporte etj. **Evidenca 3.5, Evidenca 3.6, 3.7**<br>Rezultatet përpunohen nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës dhe më tej analizohen e shpërndahen në Fakultet e departamente. Rezultatet e këtij pyetësori janë pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Departamentet e Fakultetit organizojnë në mënyrë periodike diskutime dhe kontrolle në lidhje me aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik duke promovuar eksperiencat më të mira. Në mënyrë të vazhdueshme përpilohet Raporti Vjetor i Departamentit, ku stafi akademik dokumenton ngarkesën mësimore, performancën akademike në kërkimin shkencor dhe botime. **Evidenca 3.8** |

| | |
|---|---|
| | Në këtë mënyrë vlerësohet angazhimi sasior dhe cilësor i secilit në aktivitete që kanë të bëjnë si me veprimtarinë mësimdhënëse ashtu dhe atë shkencore. Një tjetër mënyrë vlerësimi ka qënë dhe ai i vlerësimit të lëndëve nga pedagogu, viti akademik 2020-2021. Një tjetër instrument për tu përmendur është dhe ai i vetëvlerësimit, i cili realizohet në intervale kohe jo të përcaktuara, por sipas vendimit të institucionit. **Evidenca 1.12, 1.13, 1.14, 1.15, 1.16, Raporte vjetore FSHN, Evidenca 3.12** |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Studentët janë pjesë integrale e institucionit dhe përfshihen në veprimtari të ndryshme, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik, të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. **Evidenca 1.2, Evidenca 5.** Studentët kryejnë vlerësimin, duke ruajtur anonimatin e tyre si dhe nëpërmjet fokus grupeve. **Evidenca 3.10**<br>Pyetsorët zhvillohen duke ruajtur anonimatin në mënyrë që të reflektohen rezultate sa më objektive. Struktura e pyetsorit përmban zakonisht këto komponente për të cilat studentët duhet të shprehen: për pedagogun, për programin e studimit në përgjithësi, gjë që përfshin pyetje të natyrave të ndryshme mbi lëndët e zhvilluara, nëse kurrikula siguron lidhje të praktikës me teorinë, për infrastrukturën që ofron departamenti etj. **Evidenca 3.11**<br>Kështu merret mendimi i studentëve mbi programin e studimit në tërësi, mbi lëndët në veçanti, mbi pedagogët që mobilizohen në auditor, mbi sillabusin, literaturën, vlerësimin e dijeve etj.<br>**Evidenca 3.12.Evidenca 23,24** |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Në nivel institucional ose fakulteti rezultatet e vlerësimit pasi përpunohen u dërgohen autoriteteve drejtuese të FSHN, anëtarëve të personelit akademik dhe publikohen në faqen zyrtare të FSHN. **Evidenca 3.9 Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit.**<br>Përveç vlerësimeve të kryera në nivel institucional, vet Departamenti i Fizikës kryen vlerësime periodike dhe takime mes personelit akademik dhe studentëve. Numri i ulët i studentëve mundëson informim në kohë reale të tyre nga vetë personeli akademik. **Evidenca 3.10: Evidenca 3.12** |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | GVJ, në bazë të dokumenteve konstaton se rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmblidhen në një raport. **Evidenca 6.1.** Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. **Evidenca 3_5, 3_6**<br>Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për përmirësimin e mësimdhënies në auditor të personelit akademik, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme ku promovohen shembuj të praktikave të mira. UT është angazhuar në disa projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marre pjese në programe shkëmbimi, siç janë Erasmus+, KA1 dhe KA2, ku një nga përfitimet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.<br>DCBCK në bashkëpunim me struktura të tjera përgjegjëse (Komisioni për Vlerësimin e Standarteve të Cilësisë), mund të organizojnë trajtime tematike në lidhje me metodat e mësimdhënies në funksion të përmirësimit të cilësisë së saj.<br>**Evidenca 3.7**, **Evidence 1.1, Evidenca 1.12**: |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | x |

| Standardi III.2<br>**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale. **Evidenca 3_2**<br>Sillabuset e lëndëve miratohen në departament. Gjithashtu, plani mësimor është në përputhje me Rregulloren e programit. Procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, vlerësime të vazhduara, provime përfundimtare, provim diplome, projekte etj. Një kredit përfaqësohet nga 25 orë duke përfshirë si orët në auditor (leksione, seminare, laboratore) ashtu dhe orët për studim individual. **Evidenca 7**<br>Në programin e studimit "Bachelor në Fizikë", numri total i orëve të leksioneve është 903 orë numri i orëve të seminareve 804 orë i laboratoreve është 326 orë.<br>Numri i orëve në auditor, përfshirë leksione, seminare dhe laboratore varion ndër semestrat e tre viteve, nga 22 deri në 24 orë në javë, duke qenë në përputhje me rregulloren e Universitetit të Tiranës. **Evidenca 1.5, Evidenca 2.2, Aneks Tabela 13** |
| **Kriteri 2**. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për të gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. **Evidenca 3.1.** Në bazë të fushës dhe natyrës së programit të studimit, si dhe *feedback*-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies përveç atyre klasike, si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studime në grupe, mjete audio-vizive etj. **Evidenca 2.2.** Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies, personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie sa më të mirë. **Evidenca 5**<br>Një mënyre alternative ka qenë edhe mësimi online i diktuar edhe nga kushtet e pandemisë, për të cilën personeli akademik ka qenë i mire përgatitur dhe ka përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit të lëndëve. Disa nga metodat e përdoruar gjatë mësimdhënies janë: simulimi, video, përdorimi softëare-ve të caktuar për të kryer detyra të pavarura etj. **Evidenca 3.2.** Në Departamentin e Fizikës vijnë herë pas here lektorë të huaj të ftuar të cilët japin njohuri mjaft interesante dhe bashkëkohore, të vlefshme si për stafin akademik ashtu dhe për studentët, të cilët iu hapen horizonte të reja.<br>Personeli akademik tregon gadishmëri për të realizuar ndryshime rrënjësore në mënyrën e tij të mësimdhënies, atëherë kur nevojat kritike të studentëve e kërkojnë një gjë të tillë. Mjafton të përmendim mënyrën krejtësisht inovative gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, me aplikimin e mësimdhënies dhe marrjes në provim online. **Evidence 3.3, Aneks Tabela 20** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës angazhohet për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit të tij akademik. Ai ka hartuar një udhëzues për këtë qëllim dhe zhvillon trajnime me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. **Evidenca 22**<br>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit,Universiteti i Tiranës mbështet personelin akademik në aspektin didaktik dhe për teknologjinë e cila thjeshton procesin mësimor. Çdo vit kalendarik, çdo department paraqet projekt buxhetin brenda të cilit stafi akademik paraqet kërkesa të cilat kanë të bëjnë me elementë të bazës laboratorike në të cilën mbështetet mësimdhënia, punë laboratorike të kompletuara, bazë kompjuterike që përmban PC apo pjesë të tij si dhe projektorë. **Evidenca 25**<br>Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes. **Evidenca 1_12. Evidenca 3.13, Evidenca 1.12** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Personeli i Departamentit të Fizikës ka në përbërje të tij pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë që përdorin metoda mësimdhënie duke shfrytëzuar trashëgiminë Akademike të Fakultetit tonë, të kombinuar me materiale dhe eksperienca didaktike të sjella nga vendeve të ndryshme, ku pedagogët tanë kanë pasur benefitin të kenë vizituar. **Evidenca Stafi CV**<br>Për pjesën më të madhe të lëndëve që stafi i departamentit zhvillon, ekzistojnë tekste dhe materiale të tjera ndihmëse. Rol thelbësor luajnë leksionet e shkruara nga pedagogët, të cilat prej vitesh depozitohen në departament dhe të cilat janë përditësuar gjatë mësimit online. Kjo ka qenë një nga prioritetet tona kryesore dhe vërejmë se është bërë një punë mjaft e madhe në këtë drejtim. Metodat e mësimdhënies dhe kontrollit të dijeve janë të detajuara në Syllabuset e lëndëve që bëjnë pjesë në programin e studimit "Bachelor në Fizikë". **Evidenca 2.2 (syllabuse)**<br>Stafi akademik titullar i Departamentit të Fizikës i angazhuar në programin e studimit është i përbërë nga 2 PA me titullin Profesor, 6 me titullin Prof. Asc, 9 kanë gradën doktor, 2 janë Dr në proces dhe 1 PAE është MSC.<br>Kontribut jep angazhimi i përvitshëm i stafit të Qëndrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar, që është një benefit i madh për programin e studimit sepse ata sjellin eksperiencën e tyre të lidhur ngushtësisht me aparatet shkencore dhe metodologjinë e kërkimit shkencor. Nga sa më sipër dhe pas analizimit të CV-ve të personelit akademik GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve. **Evidenca 2.2, Aneks Tabelat 1 dhe 2, Aneks Tabelat 12, Aneks Tabela 4, Evidenca 2.14 CV** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjate vizitës në institucion e FSHN, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyre të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vene në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjate zhvillimit të lëndëve në komunikim dhe konsultim direket me pedagogun e lëndës në platformat inovative të përdorura në procesin e vlerësimit të mësimdhënies. **Evidenca 3.9**<br>Gjatë vizitës në FSHN, në takimin me studentët pjesëmarrës nga viti I, II, III i programit të studimit mësuam se ishin të kënaqur nga infrastruktura |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | e vënë në dispozicion nga FSHN dhe metodat e përdorura në mësimdhënie nga personeli akademik në sistemin online. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies. Studentët konfirmuan plotësimin e pyetësorëve në sistemin online dhe atë të shkruar ne letër në formë anonime. Raporti i analizës së pyetësorëve, i përpiluar prej DSBCK, ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.<br>Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë për përmirësimin e **Evidenca 3.10**<br>mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ku shihet e nevojshme. Ky raport, përcillet tek secili prej anëtarëve të personelit akademik.<br>Mbështetur në të dhënat e këtij raporti, rezulton se Personeli Akademik i Departamentit të Fizikës, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke reflektuar mendimet dhe sugjerimet e studentëve. **Evidenca 3.11, Evidenca 3.12** | | | |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion. takimi me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Këto metoda përfshijnë simulime, video, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj **Evidenca 1_3, takimi me stafin.** Përdorimi i sistemit online të mësimdhënies e ka bërë të domosdoshme përdorimin e teknikave dhe metodave interaktive me qëllim rritjen e fokusit dhe interesit të studentëve, me anë të aktivizimit e të gjithë studenteve në pune praktike, projekte, përfshirjen në punën në grup dhe projekte nën udhëheqjen e personelit akademik të fushës. **Evidenca 1_12_B**<br>Përdorimi i infrastrukturës inovative në mësimdhënie të vënë në dispozicion nga FSHN dhe demonstrimet në laborator e kane rritur efektivitetit e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie.<br>**Evidenca 2.2, Evidenca 3.10** | | | |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Personeli akademik është inkurajuar nga UT/FSHN të zbatojë mësimdhënien me në qendër studentin, e cila krijon mundësi që studentët të ndërtojnë vetë dijet duke ndërvepruar dhe punuar në mënyrë të pavarur, ndërsa pedagogët e programit të shndërrohen në mbështetës të procesit mësimor. Stafi akademik nxit në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore në varësi të specifikave të lëndës. **Evidenca 1.1**<br>Nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. Për këtë dëshmon dhe numri i bollshëm i orëve individuale të studimit në Syllabuset e çdo lënde. Ky numër, për çdo kredit, zë të paktën 10 orë studimi individual.<br>Pedagogët përpiqen që me ane të leksioneve të hapura të zhvilluara në mënyre të përvitshme të ndihmojnë studentët dhe të diplomuarit në zhvillimin e karrierës se tyre, nxisin realizimin e detyrave nga ana e studentëve, gjatë orëve të seminarit, si një mënyrë për të nxitur punën e pavarur. **Evidenca 2.2 (Syllabuse)** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave të hapësirave vlerëson se procesi mësimor e shkencor i programit të studimit, realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të bollshme dhe mirëmbahen rregullisht. Godinat janë të pajisura me sistem ngrohje totale si në korridore dhe në zyra apo auditorë. **Evidenca 25**<br>Auditorët janë të pastra dhe me të gjitha kushtet për një zhvillim normal e dinjitoz të të gjithë aktiviteteve didaktike. Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor janë të përshtatshme për zhvillimin e tij dhe mirëmbahen rregullisht. Këto ambiente janë rikonstruktuar rregullisht duke plotësuar kërkesat e departamenteve për çdo program studimi. Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të vëna në dispozicion, FSHN ka 4 godina. Sipërfaqja totale e shfrytëzueshme në funksion të programit të studimit "Bachelor në Fizikë", pra sipërfaqja që zënë në to sallat e leksioneve dhe seminareve, është 2595.2 $m^2$ dhe kanë 2176 poste studenti. Këto sipërfaqe janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 12 salla me sipërfaqe totale 1731$m^2$ me mbi 72 poste studenti secila, me 1302 poste në total. Salla seminari janë gjithsej 16, me sipërfaqe në total 864.2 $m^2$ me mbi 48poste studenti secila. **Vizita në infrastrukturë/ institucion**<br>Siperfaqja e plotë e 7 sallave të laboratorëve në godinën B, si dhe e laboratorit të kimisë se pergjithsme, salla 211 A, me sipërfaqe 47 $m^2$, të cilat shfrytëzohen vetëm nga studentët e programit të studimit "Bachelor në Fizikë", është 395.5 $m^2$. **Aneks, Tabela 16; Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë** |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratoreve janë të rikonstruktuara dhe kanë logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë, ekrane projektimi, gjë që jep mundësi që mënyra e realizimit të mësimdhënies të bëhet me metoda e teknologji bashkëkohore. **Vizita në infrastrukturë/ institucion**<br>Në përputhje me specifikat e lëndëve teorike të programit të studimit, mënyra tradicionale e shkrimit të ekuacioneve në tabelë, lë gjithmonë shumë të kënaqur studentin, i cili ndjek hap pas hapi mënyrën e nxjerrjes së tyre. Infrastruktura në dispozicion, si sallat e leksioneve dhe seminareve, zyrat e stafit akademik dhe ndihmës, laboratoret e Fizikës, kanë pajisjet e nevojshme për zhvillimin e mësimit. Çdo anëtar i stafit akademik ka në dispozicion një post pune dhe një kompjuter. **Evidenca 3.13, Evidence 1.1;** |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | GVJ nga vizita në vend në UT/FSHN konstaton se ambientet e dedikuara për procesin mësimor në godinë, janë funksionale, me hapësira të mjaftueshme për studentët dhe stafin akademik për të zhvilluar veprimtarinë mësimore. **Vizita në infrastrukturë/ institucion.**<br>Auditorët janë të pajisur me PC, video projektor dhe me internet (ëireless). Në kushtet e zhvillimit të mësimit onlinë për dy vite, stafi i IT ka garantuar akses të personelit akademik dhe të studentëve për të zhvilluar mësimin në platformën Teams.Në UT është hartuar "Udhezues bazik Microsoft Teams për stafin akademik", "Microsoft office 365 Teams për staf i detajuar sipas rubrikave", "Microsoft office 365 për studentët", "Manual përdorimi Microsoft teams për stafin akademik". |

| | |
|---|---|
| | Stafi u trajnua gjithashtu nga Clean Score për mënyrën e menaxhimit të një provimi online. Gjatë vizitës, GVJ konstatoi se në FSHN ishte duke u vënë në përdorim një sistem kompjuterik, i cili do të jetë në shërbim të personelit akademik, ndihmës mësimor, administrativ dhe studentëve të UT. Sistemi Informatik prodhon, ruan, përpunon, shpërndan ose transmeton informacione të ndryshme përmes implementimit të sistemeve menaxhuese të informacionit arsimor, rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit të Universitetit. **Evidenca 3.2, Evidence 3.3, Evidenca 3.14** |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Literatura bazë dhe e rekomanduar mbi të cilat organizohet dhe mbështetet programi i studimit, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme në fushën e fizikës teorike dhe të aplikuar Literatura është e ruajtur fizikisht në bibliotekë. **Evidenca 2.2.** Literatura në gjuhën angleze është në formë elektronike, ku gjithashtu ofrohen në mbështetje të programit të studimit edhe burime të tjera elektronike të informacionit, të cilën FSHN e ofron në lidhje direkt prej faqes ëeb në burimet Edëard Elgar Journals, IOP, MSP dhe Cobiss. **www.fshn.edu.al** Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar. Literatura e programit është në gjuhën shqipe, si gjuhë e programit, ndërsa në literaturën e rekomanduar vihen re dhe tituj në anglisht apo në ndonjë gjuhë tjetër. Prej vitesh në Departament përdoret praktika e depozitimit të leksioneve të shkruara nga ana e stafit akademik. **Evidenca 1,2,3,4** |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Literatura e programit të studimit ruhet kryesisht fizikisht në bibliotekë. Biblioteka pasurohet në fillim të çdo viti akademik. Të gjithë lektorët mund të propozojnë titujt, që mund të shtohen në bibliotekë. **Evidenca 28.2, 28.1** Në FSHN, në godinën B ndodhet biblioteka me sipërfaqe 561.1 $m^2$, ndër më të mëdhatë dhe më të rëndësishmet në Universitetin e Tiranës. Në kushtet normale të punës, në bibliotekë ofrohet shërbim me dy turne, në tre ambjente studimi e shërbimi, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit Bachelor në Fizikë. **Evidenca 28.1** Numri total i titujve shkencorë 36520 njësi, nga të cilët 24335 janë libra, 719 në shqip dhe 23616 në gjuhë të huaj. Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në shqip e gjuhë të huaj është 24441 njësi nga të cilët 64 janë në shqip dhe 24377 në gjuhë e huaj. Në mënyrë që të plotësohen kërkesat e përdoruesve me standarte bashkëkohore është parashikuar pasurimi i bibliotekës me libra fondamentalë cilësorë (fjalorë, enciklopedi, manuale) si dhe tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, botime të huaja dhe shqiptare. **Evidenca 1.14, Evidenca 1.15, Evidenca 1.16** |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me AADF ka akses për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR. JSTOR ofron më shumë se 12 milion artikuj të revistave akademike, 85000 libra dhe 2 milion dokumente në 75 disiplina. **Evidenca 17.1, 17.2.** Falë marrëveshjes së finalizuar, biblioteka digjitale JSTOR u jep mundësi stafit akademik të FSHN dhe studentëve të hulumtojnë në shumë fusha studimore. Stafi akademik i Departamentit dhe studentët kanë akses në U-Library (https://ulibrary.rash.al/), biblioteka digjitale, që u ofrohet universiteteve publike nga MAS nëpërmjet Rrjetit Akademik Shqiptar. **Evidenca 28.2, 28.1** Gjithashtu, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka abonime në disa periodikë si: ASTM International, ASTM Compass abstract; Edëard |

| | |
|---|---|
| | Elgar Journals; IOP Science; MSP Journals. Fondi i bibliotekës online është i aksesueshëm edhe për studentët e programit të studimit "Bachelor në Fizikë". Gjithashtu ata mund të shfrytëzojnë burimet online, në të cilat, FSHN është e regjistruar në Konsorciumin Ndërkombetar EIFL. **Evidenca 3.15**, **Evidenca 3.16** https://unitir.edu.al/biblioteka-online/, https://fshn.edu.al/; |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Gjatë vizitës në mjediset e departamentit GVJ konstatoi se në shërbim të programit të studimit BSc. Fizikë, janë 7 salla laboratori në godinën B, të cilat janë gjithnjë e më shumë të pajisura me mjete të reja. Nuk duhet përjashtuar dhe prania e punëve të vjetra të laboratorit të cilat kanë funksionin e tyre në metodikën e laboratoreve specifike. **(Vizita në institucion)**<br>Sallat e laboratoreve kanë infrastrukturën e nevojshme. Laboratorët e ndryshëm të Fizikës janë plotësisht funksionale, laboratoret e Fizikës llogaritëse janë në dispozicion të studentëve gjatë mësimdhënies në lëndën e programimit. Pedagogët angazhojnë studentët në vënien në punë për herë të parë të një pune laboratori që vjen si prurje e re në laborator, për kalibrimin e aparateve matës etj. **Evidenca 25**<br>GVJ konsideron infrastrukturën laborastorike mjaft të përshtatshme dhe në fusnkion të programit të studimit. Megjithatë sugjeron se aplikimi i këtyre njohurive edhe në orët e praktikës profesionale është avantazh për studentët<br>**Evidenca, (tabela përmbledhëse) Aneks Tabela 16** |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik dhe studentët në Universitetin i Tiranës përdorin platformat Microsoft Teams dhe e-Studenti. Kjo platformë është konfiguruar dhe përshtatur në vitin akademik 2018-2019 dhe është shfrytëzuar dhe gjate viteve akademik 2019- 2020/2020-2021. Gjithashtu në vitin akademik 2020-2021 u zhvilluan online si provimet e sezonit të dimrit, të verës dhe ai i vjeshtës. **Evidenca 3.14**<br>Stafi akademik dhe studentët vazhdojnë edhe tani të kenë akses në platformën Teams. Pedagogët hedhin materialet e leksioneve në platformë si dhe e shfrytëzojnë atë për ndonjë kontroll online si dhe për depozitimin e detyrave të kursit dhe projekteve të ndryshme. **Evidenca 3_1**<br>Së shpejti në Universitetin e Tiranës do të vihet në përdorim një sistem kompjuterik i cili do të jetë në shërbim të personelit akademik, ndihmës mësimor, administrativ dhe studentëve të UT. **(Vizita në sekretarinë mësimore)**<br>Sistemi Informatik prodhon, ruan, përpunon, shpërndan ose transmeton informacione të ndryshme përmes implementimit të sistemeve menaxhuese të informacionit arsimor, rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit të Universitetit.<br>**Evidenca 3.2, Evidenca 3.3** |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | Universiteti i Tiranës ka vënë në dispozicion llogari Office 365 për personelin akademik dhe studentët. Office 365 i ofron studentëve dhe personelit akademik hapësirë vetjake të dedikuar në të cilën mund të ruhet dokumentacioni elektronik si dhe mundësinë e komunikimit elektronik nëpërmjet postës elektronike. "UT Tiranës -SharePoint", i shërben gjithashtu UT për menaxhimin e dokumentacionit. **Evidenca 29.1, 29.2**<br>Gjithashtu UT është në proces të ndërtimit edhe sistemin e-për student i cili shërben për komunikimin e brendshëm dhe menaxhimin e informacionit. Ndërkohë, personeli akademik dhe studentët kanë |

| | |
|---|---|
| | përdorur komunikimin elektronik dhe platformën Teams që mundëson dhe komunikim më të shpejtë midis tyre. Ky komunikim shërben dhe për efekt të njoftimeve të ndryshme, notave, vlerësimeve të detyrave etj. Gjithashtu përmes këtij sistemi dhe adresave të tyre, studentët e UT kanë mundësi të aksesojnë forumet e faqes zyrtare të internetit të UT. **Evidenca 3_14**<br>GVJ ka shqyrtuar faqen zyrtare të FSHN e cila funksionon në dy gjuhë, në anglisht dhe në shqip. Ajo përmban informacione të përgjithshme mbi fakultetin, historikun e tij, departamentet, stafin, organigramën.<br>Aktualisht në Universitetin e Tiranës funksionon sistemi kompjuterik i cili është në shërbim të personelit akademik, ndihmës mësimor, administrativ dhe studentëve të UT. Sistemi Informatik prodhon, ruan, përpunon, shpërndan ose transmeton informacione të ndryshme përmes implementimit të sistemeve menaxhuese të informacionit arsimor, rrjeteve informatike, mjeteve dhe pajisjeve të transmetimit të Universitetit. **Evidenca 1.7**, , http://fshn.edu.al;, **Evidence 1.1** |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Bazuar në rregulloren e UT, përmbyllja e studimeve realizohet me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në programin e studimit "Bachelor në Fizikë" nuk është e aplikueshme përmbyllja përfundimtare me anë të një punimi diplome. **Evidenca 5.** Në fund të vitit të tretë studentët japin një provim përmbyllës, i cili ka 7 kredite dhe përmban njohuri nga të gjitha disiplinat e zhvilluar gjate gjithë viteve të programit të studimit. **Aneks Tabela 9.** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1**. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Universiteti i Tiranës në statutin e tij ka përcaktuar Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore. **Aneks Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJBSC.** KPSSC planifikon dhe organizon Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë, në kuadër të Universitetit të Tiranës", në dy aspekte kryesore:<br>Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë të programeve të studimit;<br>Vlerësimin e Brendshëm Institucional; **Evidenca 3.5; Evidenca 3.6**<br>Mënyra e funksionimit të sistemit të sigurimit të cilësisë përcaktohet në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucioni dhe në rregulloret e sigurimit të cilësisë së secilës njësi kryesore. KPSSC bashkëpunon me Dekanët e Fakulteteve dhe me Degën e Sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN, për çdo vlerësim të brendshëm të cilësisë që organizon. Rezultatet e Raporteve të vlerësimit të KPSSC shërbejnë si bazë për zyrën e kërkimit shkencor për të hartuar dhe zbatuar programe të zhvillimit pedagogjik dhe didaktik të personelit akademik. Në veprimtarinë e saj, njësia zbaton "*Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës*", mbështetur njëkohësisht në "*Manualin e Cilësisë*" dhe "*Paketën e Instrumentave të Cilësisë*", miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23 Dhjetor 2020. **Evidenca 3.7; Aneks Tabela 24** |

| | |
|---|---|
| | DSBCK për çdo vlerësim që organizon, ngre Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, ku marrin pjesë, përveç pedagogëve, edhe një student. **Evidenca 3.17** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | Departamenti i Fizikës është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e vet universitetit. **Evidenca 6**<br>Duke pasur parasysh që kërkesat për cilësi janë gjithmonë në rritje dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhornime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat kombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marrë pjesë në leksionet e mbajtur nga aplikantët. **Evidenca 1.3**<br>Departamenti bën analiza periodike, mbi bazën e të cilave shqyrton situatën e përmbushjes së standardeve të cilësisë së mësimdhënies, duke lënë detyra për zgjidhjen e problematikave të mundshme. Bazuar në raportimet e vlerësimit të cilësisë dhe udhëzuesit strategjik të metodave inovative, hartohen dhe zbatohen module trajnimi. Ai përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie mbi bazën e konkurseve. Vendet e lira të punës shpallen në APP. Komisioni *ad hoc* i ngritur nga dekanati, përbëhet nga 5 anëtarë të kategorisë Profesor. **Evidence 1.1** |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Universiteti i Tiranës ka një udhëzues strategjik për periudhën 2018-2023 për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë strategji, departamenti luan një rol të rëndësishëm duke kontribuar në ndërtimin e platformave të reja mësimdhënie. **Evidenca 3_1**<br>UT në funksion të cilësisë së programit të studimit ka miratuar "Qendrën virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit". Strukturat drejtuese të UT, Fakultetit dhe Departamenti mbështesin metodat e reja dhe inovative në mësimdhënie. Pedagogët e programit të studimit përdorin metoda mësimdhënieje sa më atraktive për studentët dhe këtu ju vjen në ndihmë dhe teknologjia. Evidenca 3_14. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 mësimi u zhvillua online. **Evidenca 3.2, Evidence 3.3** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës mbështet kualifikimin në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor. Për këtë qëllim, personeli akademik, ai mbështetës dhe administrativ, mbështetet financiarisht në pjesëmarrjet në veprimtari ndërkombëtare të zhvilluara këto në Shqipëri dhe jashtë saj. Ndërkohë nga ana tjetër, personeli akademik bën përpjekje për të rritur nivelin e tij të kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Krahas mësimdhënies, një komponent i rëndësishëm i punës së stafit akademik është kërkimi shkencor i cili i shërben rritjes së cilësisë së mësimdhënies përmes kualifikimit akademik të stafit. **Evidenca. 6.17. Evidenca 4.11**<br>Në procesin e thellimit dhe të evidentimit të kërkimit shkencor, në Departamentin e Fizikës, më 20.11.2019 u organizuar Konferenca Shkencore Ndërkomëtare e Fizikës, ICAP 2019. Buletini shkencor i FSHN botohet nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me ISSN dhe që prej vitit 2013 botohet edhe online. **Evidenca 3.19** Ai synon ti japë mundësi stafit të institucionit për të botuar. Qëllimi i kësaj reviste është nxitja e debatit shkencor si dhe promovimi i punës shkencore të stafit akademik. **Evidenca 3.18.** Mbi bazën e analizave vjetore, departamentet në FSHN bëjnë vlerësimin e punës së personelit akademik, të grupeve mësimore-kërkimore si dhe të departamentit në tërësi dhe nxjerrin |

| | |
|---|---|
| | rekomandimet përkatëse për orientimin me të mirë të kërkimit shkencor. **Evidenca 3.13;** Projekt Buxhet i Departamentit të Fizikës për vitin 2020-2021. Revista periodike e "Buletinit të Shkencave të Natyrës", ISSN 2305-882X.**Evidenca Aneks Tabela 19, Aneks Tabela 20, Evidenca 3.20, Evidenca 3.21** |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Bazuar në dokumentacionin mbështetës dhe vizitën në institucion rezulton se stafi akademik i FSHN dhe Departamenti i Fizikës, është përfshire në mënyrë të drejtpërdrejte në organizimin dhe realizimin e trajnimeve, ëorkshope-ve dhe projekteve të ndryshme, të gjitha në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe të implementimit të metodave të reja. **Evidenca 3.2;** Në funksion edhe të përmirësimit të aftësive të mësimdhënies, UT ka realizuar disa marrëveshje të ndryshme në kuadër të programeve Erasmus. Kështu stafi i FSHN/DF në bashkëpunim me koordinatorin lokal ka aplikuar dhe realizuar mjaft mobilitete në Universitete të ndryshme në Evropë. Institucioni organizon trajnime në bashkëpunim me Departamentin dhe strukturat përgjegjëse. Trajnimet e ndryshme tematike, tryezat e rrumbullakta kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nga ana e stafit akademik. **Evidenca 3.5;** Një proces i tillë është kryer në kuadrin e mësimit online me focus përdorimin e platformës Microsoft Teams. Po ashtu mund të përmendim leksione nga profesorë të huaj të ftuar në Departamentin e Fizikës (Standarti III.2 kriteri 2). **Evidenca 3.6;**<br>Gjithashtu në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë parashikohen procedura standarte për vlerësimin dhe për përmbushjen e nevojave për trajnime të stafit akademik. Po ashtu, institucioni motivon dhe mbështet trajnimin e stafit në universitete perendimore dhe të projekteve si Erazmus+ etj. **Evidenca 3.7;** |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i njësisë bazë, përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin përzgjedhjen e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje më të mirë nga stafi me ekspert. **Evidenca 1.5;** Personeli akademik ka realizuar me sukses programin e studimit. Ata angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies duke marrë pjesë në trajnime të organizuar nga institucioni dhe marrë në konsideratë rekomandimet e studentëve. **Evidence 1.1;** Aktiviteti vjetor i departamentit i cili përfshin edhe evidentimin e punës individuale të stafit, pikat e forta në programet e studimit, mangësitë e hasura përgjatë vitit dhe objektivat për vitin e ardhshëm dokumentohet në raportin vjetor të njësisë bazë. **Evidenca 1.6;** |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | GVJ pas shqyrtimit të dokumentacioneve dhe takimit me personelin akademik konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmërinë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. **Evidenca 6.14, 6.15, 6.22.** Departamenti ka vendosur si një nga objektivat e tij strategjik "Zbatimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies bashkëkohore". **Evidenca 1.12:** Personeli akademik aplikon metoda bashkëkohore në mësimdhënie duke përdorur teknologjinë e informacionit që ofron institucioni. **Evidenca 1.14**: Sallat e leksioneve janë të pajisura me projektorë çka lejon një mënyrë atraktive të të shpjeguarit për studentët. Kjo lehtëson mësimdhënien, veçanërisht kur lëndë specifike kërkojnë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | paraqitjen e figurave të cilat nuk mund të paraqiten nga vetë pedagogu si dhe ndihmon në paraqitjen e grafikëve. **Evidenca 1.15**: Këto element të mësimdhënies bëhen pjesë e analizës së punës së departamentit apo dhe pjesë e raporteve institucionale. **Evidenca 1.16** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e programit. Mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve, të cilat së bashku me rregulloren, u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. **Evidenca 2.2;** Vlerësimi i dijeve bëhet në disa forma: nëpërmjet testimeve me shkrim dhe me gojë, detyrave të kursit, prezantimeve të projekteve, plotësimit të detyrimeve të seancave laboratorike, etj. Njohuritë e studentit kontrollohen dhe vlerësohen edhe përmes kombinimit të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë procesit mësimor. **Evidenca 7, Aneks Tabela 15.** Në programin e studimit Bachelor në Fizikë, në Syllabuset e lëndëve, gjejmë se vlerësimi i dijeve përbëhet nga katër komponentë: "Ndjekje e lëndës dhe pjesëmarrje aktive, "Plotësim i detyrimeve laboratorike dhe i detyrave të kursit", "Testimet gjatë vitit, kontrolle të ndërmjetme" dhe "Provimi përfundimtar". **Evidenca 1.3**: Rregullore e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Fizikë.<br>Lëndët, në syllabuset e të cilave përfshihen punë laboratori, e kanë provimin përfundimtar me më pak pikë, për shkak se një përqindje e zënë laboratoret. Gjithashtu, në vitet e fundit vihet re një tendencë në rritje e përqindjes së tre rubrikave të para të vlerësimit. **Evidenca 1.5** |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se studentët informoheshin mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe dijeve, format e kontrollit ishin të ndryshme bazuar në specifikat e secilës lëndë. Ato ishin të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditur studentëve në javën e parë të procesit mësimor. **Evidenca 7.** Studentët informoheshin rregullisht edhe mbi planet mësimore dhe kurrikulën e programit të studimit. Këtu një rol të rëndësishëm luajnë edhe kujdestarët e grupeve si dhe koordinatori i programit të studimit. Informacion të hollësishëm studentët përveç informimit nga pedagogu i lëndës gjejnë edhe në syllabuset e lëndëve, ku në varësi të natyrës se lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar, të cilat i bëhen të ditura studentit. **Evidenca 2.2;**<br>Java e parë e semestrit shërben si javë orientimi për studentët mbi të gjithë elementët që sapo përmendëm. Padyshim ata mund të marrin informacion mbi lëndën gjatë gjithë përiudhës kur shtrihet lënda, përmes kontakteve me pedagogët e departamentit, të cilët janë përherë të gatshëm. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit të një lënde janë: **Evidenca 7**<br>Frekuentimi i lëndës dhe pjesëmarrja aktive vlerësohet me 5% deri në 10 %.<br>Plotësim i detyrimeve laboratorike dhe detyrave të kursit vlerësohet me 10-42%.<br>Testimet gjatë vitit vlerësohet me 5-30% .<br>Provimi përfundimtar" vlerësohet me 40% deri në 100 % (intervali 40-100% domethënë që: ka lëndë ku provimi përfundimtar zë 40% të vlerësimit total, ka lëndë ku provimi përfundimtar zë 100% dhe në lëndët e tjera provimi përfundimtar zë një përqindje midis këtyre dy vlerave kufij). **Evidenca 2.2**<br>Lëndët, në syllabuset e të cilave përfshihen punë laboratori, e kanë provimin përfundimtar me më pak pikë për shkak se një përqindje e zënë laboratoret. Gjithashtu në vitet e fundit vihet re një tendencë në rritje e përqindjes së tre rubrikave të para të vlerësimit. **Aneks, Tabela 15** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Bazuar në dokumentacionin mbështetës, sylabuset e lëndëve, vlerësimi i dijeve të studentëve bëhet duke u bazuar në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas formës së vlerësimit të vazhduar gjatë semestrit, pjesëmarrjes dhe diskutimeve në seminare dhe laboratorë, detyrave të kursit etj. sipas komponentëve të përcaktuar në sylabusin e lëndës, ku pesha në % dhe mënyrat e vlerësimit janë specifike sipas llojit të lëndës. **Evidenca 1.5** Kryesisht kontrollet dhe provimet e ndërmjetme realizoheshin pas mesit të secilit semestër. Testimi dhe vlerësimi në lëndë shtrihet gjatë gjithë semestrit dhe përbëhet nga katër komponentë. Ai realizohet gjatë gjithë vitit akademik duke dhënë në fund rezultatin, pra notën përfundimtare. Vlerësimi i vazhduar përgjatë gjithë vitit akademik gjejmë në të gjitha lëndët, por mund të veçojmë në planin mësimor të programit të studimit "Bachelor në Fizikë" dy lëndë: Gjuhë e huaj dhe Fizikë e zbatuar, të cilat janë me vlerësim të vazhduar (VLV), ku vlerësimi përfundimtar nuk mbështetet në një provim final, por vetëm në pikët e akumuluara nga studenti gjatë lëndës, në komponentet e ndryshme të vlerësimit të parashikuar në Syllabus. **Evidenca 2.2;** Për shkak të specifikave që ka programi i cili ka një formim të thelluar teorik, vlerësimi në seminare dhe përgatitja e detyrave është e rëndësishme për studentët. **Evidenca 3.22** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Testimi dhe vlerësimi në FSHN është realizuar kryesisht duke kombinuar metodat tradicionale ("pencil and paper", vlerësimin me gojë) me mjetet elektronike (hartimi, postimi dhe prezantimi i detyrave të kursit/projekteve). Sipas RVB, në disa lëndë është aplikuar testimi online duke përdorur Office 365, nisur edhe ka kushtet prej pandemisë. Nga takimi me studentët testimi online është realizuar në platformën Teams, me kamera hapur. **Evidenca 1.5;** |

| | |
|---|---|
| | Në kushtet e mësimit online, UT ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams e cila garanton transparencë, objektivitet dhe një vlerësim të menjëhershëm të studentit, i cili merr në kohë reale vlerësimin e provimit të tij. **Evidenca 3.1, 3.15** |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se FSHN/UT ka përcaktuar në rregulloren e UT se Dekani miraton komisionet e provimeve dhe të mbrojtjes së diplomave dhe Përgjegjësi i Departamentit miraton modalitete të vlerësimit dhe ngre komisionet e provimeve të cikleve përkatëse të studimeve në lëndët që mbulon departamenti. **Evidenca 7**. Testimi dhe vlerësimi i njohurive realizohet nga komisioni i përbërë të paktën nga dy anëtarë. Komisioni përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit, i cili përgjigjet dhe ndjek zhvillimin e provimit. **Evidenca 1.5. Evidenca 1.3. Evidenca 3.23. Evidenca 1.6** |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | GVJ identifikoi se procedura e provimit është si vijon: Teza firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit së paku një ditë para ditës së provimit. Vlerësimi i provimeve bëhet i sekretuar për të garantuar objektivitetin në vlerësim dhe për të rritur transparencën. Emri i studentit mbahet i fshehtë gjatë korigjimit dhe zbulohet pas tij, në prani të studentit. **Evidenca 11.** Zhvillimi i provimeve në auditor monitorohet nga pedagogët e lëndës, anëtarë të komisionit të provimit. Titullari i lëndës është përgjegjës për vlerësimin dhe notën përfundimtare të studentit, por pa dyshim në vlerësim angazhohet dhe asistenti apo anëtari i dytë i komisionit. Teza hartohet nga titullari i lëndës sipas formatit të miratuar në departament. Titullari i lëndës harton tezën e provimit, e cila çdo vit duhet të jetë e përditësuar dhe gjithëpërfshirëse. **Evidenca 3.1**: **Evidenca 1.5** |
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive bëhet sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e universitetit UT. GVJ nga dokumentacioni dhe takimi me studentët konstaton se në kontrollin e dijeve vlerësohen dijet dhe puna individuale e studentit. **Evidenca 11.** Nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. **Evidenca 3.1**: **Evidenca 1.5.** Vlerësimi i njohurive mund të shoqërohet nga pedagogu me komente në fletoren e provimit për të sqaruar studentin për vlerësimin dhe për ta ndihmuar atë për t'u përmirësuar në të ardhmen. Shpesh, veçanërisht kur numri i studentëve është i lartë, komunikimi i vlerësimeve bëhet me gojë nga pedagogu në një sallë ku janë mbledhur studentët. Në këtë formë komunikimi, pedagogu jep dhe këshilla për temat të cilat kanë paraqitur më tepër vështirësi për studentët. Studenti ka të drejtë të marrë informacion mbi korigjimin e provimit të tij dhe ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit. Gjithashtu studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit.<br>**Evidenca 1.5, Evidenca 1.3** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Departamenti dhe personeli akademik bazohen në rregulloren e provimit dhe të etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes, dhe të masave ndëshkuese në rast plagjiaturë gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit dhe kryesisht të punimeve të diplomave, personeli akademik dhe drejtuesit e departamentit dhe Fakultetit, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren (kryesisht te punimet e diplomave) të jenë autentike. **Evidenca 11, 1_3**<br>Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik sipas detyrave të ngarkuara është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë dhe rrethanë, referuar draft kontratës se pedagogut dhe Rregullores së Etikës. Para fillimit të provimit me shkrim, anëtarët e komisionit sensibilizojnë studentët se provimi është individual dhe secili duhet të vlerësohet vetëm për aq sa janë aftësitë e tij në provim. Për këtë, çdo student duhet të përpiqet të sillet në provim si një individ i qytetëruar dhe me integritet moral ashtu siç e kërkon Kodi i Etikës. Gjithashtu studentët informohen se në rast kopje dhe komunikimi me shokët, ata do të kenë penalizime. **Evidenca 3.24.** |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem prej 10 notash. Nota me e ulet kaluese është 5. **Evidenca 9.** Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga sistemi informatik në rast të zhvillimit të tyre në platformën Teams, ose edhe me komunikim verbal dhe individual, në departament. **Evidenca 3.24.** Në raste kur provimet zhvillohen me shkrim, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes. Teza korrigjohet nga komisioni dhe brenda 15 ditëve, studenteve ju komunikohen rezultatet paraprake nëpërmjet sistemit ose verbalisht në mënyre individuale në auditor. Mbas përfundimit të procesit të vlerësimit teza depozitohet në departament. Rezultatet e kontrollit të dijeve bazohen mbi meritën dhe aftësitë e studentit. Pedagogu, me integritetin e tij, ruan të njëtën masë të vlerësimit për të gjithë studentët e paraqitur në provim. Ai vlerëson me pikë pyetjet e ndryshme të tezës, të cilat së bashku duhet të japin një total pikësh aq sa ç'parashikon Syllabusi i lëndës për provimin përfundimtar. **Evidenca 3_22, 3_23**<br>Komisioni i bën me dije studentëve rezultatet e provimit me gojë në përfundim të tij dhe për provimet me shkrim, brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Në këtë rast rezultatet e provimit afishohen në stendat e departamentit. Pas korrigjimit të provimeve, proçesverbalet dorëzohen në sekretarinë mësimore brenda 5 ditëve nga data e afishimit të rezultateve përfundimtare. **Evidenca 1.5. Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Pas shqyrtimit të dokumentacionit GVJ, konstaton se në Rregulloren e Universitetit përcaktohet e drejta e studentit për animimin e rezultateve të provimit. **Evidenca 1_3**<br>Pas shpalljes së rezultatit studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim nga komisioni për vlerësimin e bërë. Ai ka të drejtë të njihet si me pikët totale që ka marrë në provim ashtu dhe me pikët për çdo komponente të tezës së provimit. **Evidenca 1.5, Evidenca 1.3, Evidenca 1.6** |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. | Rregullorja e UT, ka të përcaktuar të gjitha detajet mbi ankimin e vlerësimit. **Evidenca 1_3.** Studenti ka të drejte të ankohet për mos plotësimin e rregullave të provimit dhe të vlerësimit të tij. Kërkesa për ankimi note shqyrtohet nga komisioni fillestar apo komisionet e tjera të |

| | |
|---|---|
| Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | ngritura, duke respektuar rregulloren e provimeve dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UT/FSHN (referuar takimit me stafin akademik dhe studentët).<br>Nëse studenti ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit, ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja në dijeni e rezultatit të provimit. Ai bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni dekanin e fakultetit. **Evidenca 7.** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | GVJ pas shqyrtimit te dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lende teorike dhe praktike ne fushën e Fizikës. **Evidenca 1,2,3,4 (plani mësimor)**<br>Ai hartohet nga Departamenti dhe i paraqitet për miratim Senatit Akademik. Programi i studimit përmban të gjithë elementët e pritshëm dhe është i njëjtë, në vija të trasha, me programet analoge jashtë vendi. Studimet në Programin e Studimit "Bachelor në Fizikë" synojnë pajisjen me dijet bazë shkencore në fushën e Fizikës. Studentët pajisen në vitet më të larta me dije të thelluara në disiplina të caktuara të Fizikës, me qëllim aftësimin e tyre paraprak profesional për kërkim shkencor në ciklin Master Shkencor. Syllabuset e lëndës/modulit paraqesin objektivat, aftësitë dhe kompetencat që fiton studenti në lëndën përkatëse. **Evidenca (syllabuse).** Departamenti ofron shërbime shtese krahas procesit mësimor, te tilla si konsultime apo leksione te hapura. Stafi akademik përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. Gjithashtu, shkëmbimet e studenteve ndihmojnë ne përthithjen e aftësive. **Evidenca 3.22, Evidenca 2.2, Aneks Tabela 15.** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Lidhur me këtë kriter, referuar dosjes së plotë të programit të studimit të paraqitur në DVV si dhe nga takimet e zhvilluara me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se syllabuset e lëndeve paraqesin në përmbajtjen e tyre ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse, objektivat, aftësitë dhe kompetencat qe priten të fitojë studenti. **Evidenca 1,2,3,4 (plani mësimor).** Këto elemente që detajohen në çdo lëndë, janë pjese integrale e objektivave te përgjithshme te programit. Programi synon gjithashtu zhvillimin e aftësive të respektimit të parimeve etike dhe humane të zbatimit të teknologjisë së informacionit dhe inovacionit. **Evidenca (syllabuse).** Programi Bachelor në Fizikë garanton një ndërthurrje të balancuar të lëndëve bazë në Fizikë, lëndëve bazë në Matematikë, lëndëve karakterizuese dhe ndërdisiplinore, lëndëve plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse. **Evidenca 3.22, Evidenca 2.2** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe | Departamenti i Fizikës analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në: Analizën vjetore të tij, mbi arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të pritshme të nxënit dhe aftësimit profesional në programin e studimit. **Evidenca 35.** Në javën |

| | |
|---|---|
| syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | e fundit të semestrit, pedagogët e lëndëve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të lëndës. **Evidenca 7. Takimi me studentë.** Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studentëve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim. Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim si edhe për peshën që do të ketë ai në notën përfundimtare. **Evidenca 2.2, Aneks, Tabela 15.** |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | Bazuar në RVB dhe në informacionin e marrë gjatë vizitës, në javën përpara testit ndërmjetës dhe në javën e 15 përpara provimit përfundimtar pedagoget bëjnë një përmbledhje të njohurive kryesore të trajtuara dhe orientojnë studentët mbi strukturën e testit ndërmjetës dhe atij final.<br>Pedagogët përfshijnë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Vlerësimi i studentëve bëhet sipas formave të përcaktuara ligjore të cilat janë pjesë e Statutit, Rregullores së Përgjithshme dhe Programeve të Studimit. **Evidenca 1.1, 5.** Të gjitha këto janë pjesë e dokumentacionit mësimor në formën e proces-verbaleve, të cilat janë në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore. Testimet, Seminaret, Detyrat e Kursit, Projektet, Prezantimet në Poëer Point, etj., janë pjesë e vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve dhe kryhen siç janë parashikuar në syllabuse. **Evidenca 2.2, Aneksi I, Tabela 15.** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik i Departamentit të Fizikës angazhohet në kërkim shkencor, sipas fushave të interesit dhe veprimtarisë individuale. **Evidenca tabela permbledhese.** Përsa i përket personelit të ftuar, DF ka një eksperiencë shumë të mirë në këtë drejtim. **Evidenca 1.12;** Lektorë të huaj janë angazhuar në dhënien e leksioneve të hapura apo e cikleve të leksioneve me tema të caktuara. Pjesë e këtyre veprimatrive është dhe personeli i departamentit që angazhohet në institucione të tjera si i ftuar. **Evidenca 1.14, Evidenca 1.15, Evidenca 1.16.** |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer ekspertiza laboratorike dhe praktikat profesionale së bashku me studentët. **Evidenca 2.2.** Gjatë zhvillimit të orëve mësimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte laboratorike. Mësimdhënia me lëndët e planit mësimor për programin e studimit të ciklit Bachelor në Fizikë realizohet prej stafit akademik mbi bazë kompetencash individuale, për lëndë të caktuara. **Evidenca 2.2.** Përgjithësisht, pas dhënies së informacionit teorik, studentët duhet të testohen t'i aplikojnë kompetencat teorike të fituara në laboratorë fizikë ose kompjuterikë. Pjesëmarrja në laboratore është e detyrueshme në masën 100% dhe vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë shumë rigoroze. **Evidenca tabela përmbledhëse, Aneks Tabela 15** |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Mbështetur në të dhënat e deklaruara dhe të mbledhura gjatë vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. **Evidenca 7.** Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup. Në mjaft prej lëndëve të ciklit Bachelor në Fizikë, parashikohen punë apo detyra kursi ku |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | inkurajohet puna në grup. **Evidenca 2.2.** Studentët i materializojnë dijet e fitura në detyra apo projekt kursi, të cilat i depozitojnë në departament, ku testohen kompetencat e fituara. | | | |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukton studentët në realizimin e detyrave të caktuara, pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Departamenti i Fizikës mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore te suksesshme. **Aneks Tabela 19;** Nga ana tjetër, personeli akademik i Departamentit të Fizikës, krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve nëpërmjet përfshirjes se tyre në projekte kërkimore dhe studimore.<br>Stafi asiston në zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara të hasura gjatë implementimit të programit mësimor inkurajon dhe mbështet studentët për të qenë aktivë dhe të hapur në diskutime. Studentët përfshihen në veprimtari me personelin akademik, ëorkshope, konferenca dhe projekte. **Evidenca 26** | | | |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | GVJ konstaton se në Departament ka klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore, në bashkëpunim me studentët. Kërkimi shkencor në FSHN aplikohet përmes stimulimit të inovacionit në projekte shkencore dhe projekte të shoqërisë civile.<br>Puna me projektet kërkimore në FSHN, ka si fokus bashkëpunimet në fushën kërkimore, mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, mundësinë e realizimit të programeve të përbashkëta të studimit, si dhe marrjen e përvojave të reja kërkimore. **Evidenca 26.** Kështu, studentët inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre shkencore në seminare dhe aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Në kuadër të mjaft marrëveshjeve të bashkëpunimit "Erasmus +", mjaft studentë janë inkurajuar dhe kanë përfituar nga lëvizjet drejt universiteteve partnere, për të ndjekur dhe shfaqur ambicjet e tyre në zhvillimin e studimeve të avancuara kërkimore.**Evidenca Aneks, Tabela 19** | | | |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | GVJ konstaton se Universiteti i Tiranës ka marrë pjesë në disa projekte Erasmus. **Evidenca 1_12.** Nëpërmjet tyre institucionin mundëson rritjen e shkëmbimit te eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira të institucioneve bashkëpunuese perëndimore, njohuri te cilat më pas aplikohen në auditor apo transferohen tek anëtare te tjerë të personelit akademik. DF realizon mobilitete studentësh me universitetet partnere. Bashkëpunimet janë kryesisht në nivelin Master, por edhe në nivelin Bachelor nuk mungojnë vizitat e suksesshme të studentëve të DF-së. **Aneks, Tabela 20, www.unitir.edu.al, www.fshn.edu.al** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Në rregulloren e përgjithshme të UT është përcaktuara se diplomimi i studentëve në përfundim të ciklit të parë behet me provim formimi. **Evidenca 5.** Ngritja e komisionit të provimit është e përcaktuar në rregullore, ai propozohet nga drejtuesi i departamentit dhe miratohet nga Dekani, përbërja është me 5 anëtarë nga DF. Për përgatitjen e provimit përfundimtar DF ka përcaktuar rregullat dhe mënyrën se si do të zhvillohet. Në çdo rast studentët komunikojnë me kujdestaret e grupeve dhe me koordinatorin e programit të studimit. Departamenti i Fizikës organizon dy sesione për provimin përfundimtar; në muajt Korrik dhe Shtator pas përfundimit të sesioneve të tjerë të provimeve. Gjithashtu departamenti organizon edhe një sesion të posaçëm në muajin Mars. Datat e zhvillimit të provimeve sipas sezoneve përkatëse, përcaktohen nga Dekani i Fakultetit. **Evidenca 2.8, Evidenca 1.6. www.fshn.edu.al.** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | Gjatë takimit me studentët u evidentua se ata asistohen nga kujdestarët e grupeve, koordinatori i programit të studimit dhe nga përgjegjësi i DF në takime informuese që zhvillohen përgjatë vitit të 3-të. **Takimi me studentë.** Provimi final për studentët, të cilët ndjekin programin e ciklit të parë Bachelor në Fizikë, realizohet sipas një procedure të posaçme. Sekretaria mësimore dhe pedagogët, të cilët janë titullar të pesë lëndëve të Fizikës së Përgjithshme, të cilët hartojnë bankën e pyetjeve, asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final. **Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Provimi final realizohet nga një komision i përbërë nga pedagogët e DF-së, të cilët janë titullarët e 5 (pesë) lëndëve të Fizikave të Përgjithshme. Kësisoj anëtarët e komisionit janë të përcaktuar automatikisht. Kryetari i komisionit është drejtuesi i njësisë. Ai respekton në çdo rast, për secilin student, procedurën dhe rregullat përkatëse të vendosura nga Dekanati. Ky i fundit miraton formalisht edhe komisionin e provimit. **Evidenca 2.2**<br>Në provimin final parashikohet të përfshihen 5 (pesë) lëndët e Fizikave të Përgjithshme (Mekanika, Termodinamika, Elektromagnetizmi, Valët dhe Optika, Fizika Moderne). Njohuritë, të cilat studenti i përfton në këto lëndë, konsiderohen si bazë dhe të domosdoshme të njihen nga studentët që të konsiderohen të diplomuar nga programi Bachelor në Fizikë. **Evidenca Aneks, Tabela 9** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | Nga takimet e zhvilluara u evidentua se në bashkëpunim me stafin akademik, hartohet programi orientues për provimin e diplomës. Studentët në prag të diplomimit marrin sqarimet e nevojshme sa i takon temave për të cilat do të pyeten dhe literaturës së domosdoshme për konsultim. **(Takimi me stafin, takimi me studentë).** Ndërkohë në Sekretarinë Mësimore, në formatin fotokopje lihet materiali i sipërpërmendur. Pedagogët të cilët kanë hartuar bankën e pyetjeve asistojnë studentët përmes një komunikimi të vazhdueshëm, duke vënë në dispozicion tekste teorike, informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme për ta lehtësuar sa më shumë këtë proces. Ndërkohë sesione konsultimi zhvillohen me studentë që kanë nevojë për sqarime apo informacione shtesë. **Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo | Programi i studimit mbyllet me provim përfundimtar. Teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit. **Evidenca 7.** Tezat e provimit të formimit kompozohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe, firmosen nga Drejtuesi i |

| | |
|---|---|
| jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Departamentit dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. **Evidenca 3.25, Evidenca 1.3** |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Programi nuk parashikon mbrojtjen e diplomës në përfundim të studimeve. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Vlerësimi i provimin përfundimtar behet me notë, bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse të diplomimit. **Evidenca 1.3.** Provimi organizohet me shkrim. Rezultatet e provimit të formimit u jepen studentëve brenda 48 orëve qe është zhvilluar provimi. Komisioni i provimit merr në shqyrtim çdo ankesë të studentëve përpara se të marrë vendimin përfundimtar. **Evidenca 3.1;** Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit. Në përfundim të procesit të provimit, studenti vlerësohet me notë. Komisioni plotëson procesverbalin e vlerësimit dhe ku më pas firmosin të tërë anëtarët e komisionit. **Evidenca 3.22, Evidenca 3.26** |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Studentët të cilët kanë përfunduar të gjitha detyrimet e programit të studimit Bachelor në Fizikë dhe kanë plotësuar kërkesat e plota për procedurën e diplomimit, si kërkesa për fitimin e të gjitha krediteve notën kaluese në provimin përfundimtar, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Në përfundim të gjithë studentët pajisen me diplomën përkatëse. **Evidenca 1.3;** Diploma e lëshuar është miratuar nga Senati i UT-së dhe ministria përkatëse. Diploma shoqërohet me listën e notave dhe suplementin e diplomës, sipas modelit të miratuar. Emërtimi i diplomës Bachelor në Fizikë bëhet në përputhje me programin e studimit të ndjekur nga studenti. **Evidenca 1.8. Vizita në sekretarinë mësimore** |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studentët pajisen me listën e notave dhe suplementin e diplomës. Nëse kërkohet, ata pajisen me programin e plotë të studimit, e firmosur dhe e vulosur. **Evidenca 1.1.**<br>Tarifa e këtij shërbimi është përcaktuar me Vendim senati. **Evidenca 1.8** |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | Të gjitha dokumentet e studentëve gjatë ciklit të studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave ligjore, një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentore në të njëjtën mënyrë siç ishte gjatë periudhës së studimit. **Evidenca 9**<br>Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga institucione të tjera. Gjithashtu ka kërkesë të veçantë të studentëve për lloje të ndryshme të dokumenteve që konsiderohen si raste ose kërkesa të veçanta. **Evidence 1.1.** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Departamenti i Fizikës ruan dokumentacionin e lidhur me aktivitetin akademik të studentit si provime të kryera prej tij, detyra kursi apo vlerësime të tjera të kryera ndaj tij. Provimet e studentëve ruhen deri në fund të semestrit pasardhës e më pas ato asgjesohen. Afati shtyhet në një vit për detyrat e kursit, projektet, fletoret e laboratorit, etj. **Vizita në sekretarinë mësimore.** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Në bazë të organigramës së FSHN, dy njësitë përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programet e studimit është Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës. **Evidenca 4.2**<br>Gjatë vizitës në Institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi që disponohet dosje e plotë për çdo personel akademik të brendshëm (fleta prezantuese e dosjes teknike, CV, kontratë pune, diplomat e arsimimit të të gjithë cikleve, lista e notave, dëshmitë e gjuhëve të huaja, librezë e punës, shkresa e emërimit, librezë pune etj). **Evidenca 2.14; CV**<br>Në çdo fillim viti hartohet tabela e ngarkesës individuale për çdo semestër dhe vjetore, e detajuar me të gjithë elementet e udhëzimit 29, datë 10.09.2018 lidhur me orët brenda dhe jashtë auditorit (udhëheqje diplomash, doktoratash, juri etj.) Hartohen tabelat e realizimit të ngarkesës mësimore brenda dhe jashtë programit bachelor, nga personeli akademik i brendshëm efektiv (PAE) dhe të pjesshëm/ftuar (PAK) të detajuara me lëndët/modulet dhe orët për çdo semestër. Çdo element i përmendur për këtë kriter është i shoqëruar me evidencën përkatëse dhe të plotësuara në mënyrë korrekte. **Evidenca 1.15; tabela përmbledhëse, Aneks, Tabela 4, Aneks, Tabela 12**<br>Çdo fillim viti akademik përcaktohet stafi akademik dhe ngarkesa individuale semestrale dhe vjetore e çdo personeli akademik të angazhuar në mësimdhënien e programit Bachelor në "Fizikë". Organizimi i kohës vjetore të punës dhe programimi i saj në veprimtaritë e ndryshme përbërëse, për çdo anëtar të personelit akademik, formalizohet ndërmjet Përgjegjësit të Departamentit dhe anëtarëve të personelit akademik, **Evidenca 5.16, 6.11, 6.12** |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura | Nga evidencat e paraqitura dhe verifikimi në Institucion, Departamenti zbaton procedura të përcaktuara qartë për rekrutimin e personelit |

| | |
|---|---|
| për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | akademik, të cilat janë të sanksionuara në Statut, Rregullore të UT dhe në kornizën ligjore në fuqi. Procedurat dhe kriteret e përgjithshme për punësim në Universitetin e Tiranës/Fakultetin e Shkencave të Natyrës, për çdo kategori të personelit akademik, përcaktohen në statutin e UT si edhe në rregulloren e UT. Ato janë të mbështetura në Kodin e Punës dhe në Statusin e personelit akademik. **Evidenca 1.1; Evidenca 1.5;**<br>DF në fillim të çdo viti akademik analizon nevojat dhe kërkesat për stafin akademik, për mbulimin e lëndëve të ofruara në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Fizikë, duke përpiluar një dokument të planit të ngarkesave mësimore për stafin aktual. Me hartimin e këtij dokumenti, departamenti parashikon se cilat janë nevojat për staf PAE dhe PAK. Këto nevoja për staf i përcillen Dekanit/Rektorit në zbatim të Statutit të Universitetit. Dega e Burimeve Njerëzore ndjek të gjitha procedurat në lidhje me rekrutimet e reja, në koordinim me Departamentin e Fizikës. **Proçedurë punësimi PAE &PAK, Vendim Nr. 329, datë 12.4.2017, Evidenca 1.15** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Universiteti i Tiranës/Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka përcaktuar në dokumentacionin bazë (Statut, Rregullore UT) kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. **Evidenca 1.1, Evidenca 1.5.** Kriteret shpallen publikisht dhe përgjedhja bëhet me konkurs. Konkretisht, për rekrutimin e personelit akademik pranë Departamentit të Fizikës, procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik (duke specifikuar kategorinë) prej vetë njësisë bazë dhe propozimin për kritere specifike në përputhje me nevojat konkrete për staf, të cilat miratohen në mbledhje departamenti, e më pas përcillen prej dekanit për miratim tek rektori. Së bashku me kriteret e përgjithshme të diktuara nga baza ligjore në fuqi, këto kritere publikohen në faqen Ëeb të FSHN si dhe në Buletinin e Prokurimit Publik **www.fshn.edu.al.** Duke respektuar të gjitha afatet e përcaktuara e të bëra publike, ndiqen hapat e plotë për të përfunduar procedurën e rekrutimit. Çdo hap i kësaj procedure fillon me identifikimin e nevojës për staf prej Njësisë Bazë, miratimin e kritereve, publikimin, procesin e vlerësimit të kandidatit dhe vendimin e marrjes në punë janë të dokumentuara në dosjen e personelit në Degën e Burimeve Njerëzore të FSHN. **Evidenca 4.5** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori Protokoll-Arshivës në bashkëpunim me zyrën përkatëse në njësinë kryesore (Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës janë përgjegjës për ndjekjen e gjithë procedurës në lidhje me rekrutimet e reja. **Evidenca 4.2.** Për vlerësimin e kandidatëve aplikantë, ngrihet komisionin *Ad-hoc.* Ky i fundit, në bazë të dokumentacionit të paraqitur bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vlerësimi i kandidaturave përfshin dy faza të njëpasnjëshme: vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Komisioni, brenda afateve të përcaktuara, shpall kandidatin/kandidatët fitues. Konkurrimi zhvillohet në mjediset e njësisë kryesore dhe fituesi i konkursit publikohet në faqen zyrtare të njësisë kryesore). **Evidenca 1.1, www.fshn.edua.l** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, duke shqyrtuar infrastrukturën ekzistuese në të cilën kryen veprimtarinë e vet Departamenti i Fizikës, konstatoi një infrastrukturë të përshtatshme për çdo personel akademik duke siguruar barazi por edhe kushte të mjaftueshme që do të garantonin plotësisht cilësinë dhe performancën në kryerjen e veprimtarisë akademiko-shkencore të çdo anëtari të departamentit. **Evidenca 1.1.** Departamenti i Fizikës aktivitetin mësimor e ushtron në 4 godinat e fakultetit, ndërsa zyrat e personelit dhe laboratoret e Fizikës ndodhen në Godinën B të Fakultetit të Shkencave të Natyrës. **Evidenca 4.13.** Godinat janë të rikonstruktuara dhe infrastruktura në dispozicion është shumë e mirë: sallat e leksioneve dhe seminareve, zyrat e stafit akademik dhe ndihmës, laboratoret e Fizikës kanë pajisje të nevojshme për zhvillimin e mësimit dhe kërkimit shkencor. Laboratoret e Fizikës kanë të siguruar lidhjen në internet dhe në laboratorin e Programimit dhe Fizikës Llogaritëse çdo post pune ka akses në internet. Çdo anëtar i stafit akademik dhe ndihmës akademik ka në dispozicion një post pune, kompjuter të lidhur në internet dhe me printerin, etj. **Evidenca 1.2. Evidenca tabela përbledhëse Aneks, Tabela 16.** |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Nga evidencat e paraqitura, rezulton se Departamenti Fizikës ka në përbërjen e vet personel akademik me nivel të lartë kualifikimi shkencor e profesional. **Evidenca 6,7, Evidenca CV e perosnelit.**<br>Njëkohësisht ata janë pjesë e politikave mbështetëse të UT që mbështesin kualifikimin e vazhdueshëm të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. Ai mbështet mobilitetet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor shumëpalësh të nënshkruara nga qeveria shqiptare me Bashkimin Evropian (ERASMUS) si dhe nga ato dypalëshe. **Evidenca 1_12_B**<br>Në kuadër të marrëveshjeve të nënshkruara Departamenti i Fizikës ka patur bashkëpunime me disa institucione të cilat japin kontributin e tyre në organizimin e konferencave shkencore ndërkombëtare. Mbështetja e personelit akademik për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, në përputhje me fushën e studimit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kualifikimin e personelit akademik. **(Takimi me stafin akademik).**<br>Angazhimi i Personelit akademik të Departamentit të Fizikës në kualifikimin e tij pasqyrohet në gradat shkencore dhe titujt akademik që ata zotërojnë. **Evidenca, tabela përmbledhëse, Takim me drejtuesin e depoartamentit** |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Departamenti i Fizikës si pjesë integrale e UT, rezulton efecient në përdorimin e metodave inovatore të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e reja, siç ishte rasti i përdorimit të tyre gjatë mësimdhënies dhe kryerjes së provimeve “on-line” në distancë gjatë kohës së pandemisë të Covid-19. **Evidenca 3_2.** Ky proces është i sanksionuar dhe i inkuadruar në Udhëzues dhe Rregullore zyrtare të miratuar të UT. Gjithashtu UT mbështet iniciativat kërkimore-shkencore të personelit nëpërmjet financimit të projekteve konkurruese të personelit akademik. **Evidenca 1.2.** Në mbështetje të përdorimit të metodave të ndryshme inovatore të mësimdhënies është laboratori i Inxhinierisë Matematike dhe Informatike i kompletuar, Laboratori i Programimit dhe Fizikës llogaritëse i rinovuar plotësisht në vitin 2018, etj. |

| | |
|---|---|
| | Gjatë periudhës së pandemisë Covid 19, në mbështetje të personelit akademik u hartua "Udhëzuesi i Universitetit të Tiranës për përdorimin e sistemit të mësimit në distancë", për përdorimin e unifikuar të sistemit digjital të mësimit në distancë, platformës Microsoft Teams. **Evidenca 4.12** |
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Për të përmbushur objektivat e programit të studimit, Departamenti i Fizikës kryen një organizim dhe shpërndarje të ekuilibruar të ngarkesës mësimore në auditor dhe asaj kërkimore sipas kualifikimit të çdo personeli akademik, duke shmangur mbingarkesat. Respektohet korniza ligjore në fuqi që ngarkesa të jetë deri në 200 +100 orë mbi normën vjetore sipas kualifikimit përkatës. **Evidenca 1.1.** Ndarja e lëndëve bëhet duke respektuar përvojën mësimore dhe kërkimore të personelit në fushën përkatëse si dhe gradën apo titullin akademik. Personeli ndihmësakademik me karakter mësimor-shkencor (laborantët) ndihmon në realizimin e mësimdhënies, kryesisht në mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e laboratoreve mësimor dhe shkencor. **Evidenca 1.5.** Personeli akademik harton programet e lëndëve, shfrytëzon me efektivitet orët mësimore, kryen kontrollin e dijeve, kryen veprimtari kërkimore, etj., me qëllim përmbushjen e objektivave të programit të studimit Bachelor në Fizikë. Në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Fizikë janë përfshirë edhe personel akademik nga Departamentet e Matematikës, Informatikës, Kimisë, nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare si dhe personeli kërkimor i Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ).**Evidenca 1.16. Evidenca 1.15, Aneks; Tabela 12.** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3** <br> **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Si pjesë integrale e FSHN, Departamenti i Fizikës zhvillon procesin mësimor në 4 godina që disponon ky fakultet. Duke parë evidencën e shpërndarjes, rezulton se hapësirat në dispozicion të realizimit të procesit mësimor (leksione dhe seminare) janë të mjaftueshme dhe të pajisura mjaftueshëm nga pikëpamja infrastrukturore në dispozicion të studentëve sipas natyrës së moduleve respektive. <br> Gjatë vizitës në institucion, u vu re se ambientet laboratorike të përfshira brenda godinës B janë të pajisura mirë me mjetet e nevojshme për zhvillimin e punëve laboratorike. Sipas deklarimeve sipërfaqja e përgjithshme është rreth 12845.36 $m^2$, e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të zhvilluar në mënyrë cilësore veprimtarinë mësimdhënëse teorike dhe praktike të programit të studimit Bachelor në "Fizikë". **Evidenca 25. Vizita në mjediset e institucionit** <br> Bazuar në dokumentet e vlerësimit dhe RVB, ndarja është si vijon: Sallat e leksioneve dhe seminareve kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2571.5 $m^2$. Ndër të cilat 731.52 $m^2$ ndodhen në godinën A (11 salla), 288.6 $m^2$ në godinën B (4 salla), 371.8 $m^2$ në godinën C (6 salla) dhe 1107.3$m^2$ ndodhen në godinën D (6 salla). Laboratorët kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 3475.5 $m^2$, të shpërndara në 4 godinat e |

| | |
|---|---|
| | FSHN ku Departamenti i Fizikës, disponon 16 mjedise laboratoresh, të pozicionuara në godinat B dhe C me një sipërfaqe prej 716.9 $m^2$, nga të cilat programi i studimit Bachelor në "Fizikë" shfrytëzon 8 prej tyre, përfshirë edhe laboratorin e Kimisë, në godinënë A, me një sipërqafe prej 395.5 $m^2$ **Evidenca 2.9**. Organizimi dhe ndarja e këtyre mjediseve është realizuar në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit. Mjediset e leksionit kanë një kapacitet që varion nga 48 në 120 poste studenti, ndërsa laboratoret rreth 15 poste studenti. Të gjitha grupet mësimore të Bachelor në "Fizikë"e kanë numrin e studentëve brenda kapacitetit të klasave ku janë caktuar të zhvillojnë veprimtarinë mësimore. **Evidenca Tabela përmbledhëse Aneks; Tabela 16,** |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Grupi i vlerësimit gjatë vizitës në Institucion dhe bazuar në evidencat e infrastrukturës reale në dispozicion të procesit mësimor teorik dhe praktik, konstatoi mjaftueshmërinë e hapësirës fizike në varësi të numrit të studentëve dhe natyrës së aktivitetit mësimor që zhvillohet në to, por edhe pajisjen e tyre me mjetet e nevojshme bazë elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që sigurojnë kryerjen me efektivitet të llojeve të aktivitete mësimore që parashikohen sipas natyrës së moduleve. Njëkohësisht edhe hapësira në dispozicion të personelit akademik është mëse e mjaftueshme qoftë nga pikëpamja fizike ashtu dhe ajo infrastrukturore. **Evidenca 18.1, 18.2, 18.3**<br>Ambientet për zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës janë funksionale dhe të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik.<br>Mjetet audio-vizuale, janë të instaluara në mënyrë permanente në një pjesë të auditoreve (kryesisht salla leksionesh dhe laboratore). Laboratori i informatikës (programimit dhe Fizikës Llogaritëse)i pajisuar me kompjutera, projektor dhe akses të përhershëm në internet ka qënë gjithmonë funksional dhe së fundmi është rinorvuar totalisht me kompjutera e softe të përditësuar. Godinat e FSHN-së ka mundësi për të aksesuar rrjet fiks të internetit, që mund të nevojiten për realizimin e proçesit mësimor. Edhe në klasat e seminareve mund të përdoren mjetet audiovizuale që janë të depozituara në departament për të realizuar prezantime, detyra, projekte kursi. **Evidenca 18.1, 18.2, 18.3. Evidenca laboratorët e fizikës** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Departamenti i Fizikës ka në dispozicion 16 laboratorë që përdoren për programin e studimit Bachelor në "Fizikë" që janë të pajisura me pajisjet, aparaturat dhe mjetet për realizimin e procesit mësimor sipas programeve lëndore. **Evidenca 4.13.** Në FSHN, sipas deklarimeve të drejtuesit të departamentit, janë bërë vazhdimisht investime në drejtim të përmirësimit dhe përditësimit të mjeteve dhe elementevë të punëve të laboratorit. Laboratori i elektronikës dhe informatikës janë përditësuar së fundmi pothuaj totalisht, ndërkohë që në laboratorët e tjera rinovohen aparaturat dhe mjetet për punë të veçanta laboratori herë pas here, si dhe janë ngritur punë të reja laboratori. Të gjitha punët laboratorike, janë ngritur për të ndihmuar studentët në aftësimin e tyre teorik e praktik dhe për të arritur objektivat formues të programit të studimit në tërësi. **Evidenca 32.1, 32.2, 32.3, 32.4** |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së | Në strukturën e FSHN si njësi bazë është dhe departamenti i informatikës i cili jep kontributin e vet në informatizimin dhe zhvillimin e laboratorëve të teknologjisë së informacionit në fakultet. |

| | |
|---|---|
| informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Fakulteti i Shkencave të Natyrës disponon 12 laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programeve të studimit që ofron. **Evidenca 4.3.** Laboratori i Informatikës për programin BSc. Fizikë (laboratori i programimit dhe Fizikës Llogaritëse), është i pozicionuar në godinën B, **(Evidenca 4.20)** Salla Nr 413, ka 19 kompjutera (18 + 1 qëndror), të pajisuar me dy sisteme operimi: LINUX dhe ËINDOËS, si dhe programet e nevojshme për lëndët që zhvillohen: C, C++, Octave/Matlab, Office, etj. Cdo post pune ka akses në internet. **Evidenca 32.1, 32.2, 32.3, 32.4, Evidenca tabela përmbledhëse.** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Programi i studimit nuk parashikon praktikë profesionale të mirëfilltë, por në këtë program kryehen një numër i konsiderueshëm orësh laboratori. **Evidenca 4.13.** Mjediset për zhvillimin e veprimtarive të tjera praktike (kryesisht laboratore) në Departamentin e Fizikës janë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tyre. Sikundër kemi theksuar, nisur nga niveli i programit të studimit, ne sugjerojmë që Deparatamenti të rishikojë shpërndarjen e krediteve për praktikën profesionale sipas VKM 41, të ndryshuar. **Evidenca 1,2 (planimësimor).** Pavarësisht orientimit të studentëve drejt mësuesisë apo studimeve të avancuara në ciklin e dytë dhe të tretë, studentët duhet të kryejnë dhe aftësimin praktik. **Evidenca tabela përmbledhëse Tabela 5, Tabela 12, Tabela 16** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Në FSHN, në godinën B ndodhet biblioteka e fakultetit. Gjatë vizitës në Institucion, u konstatua se kjo bibliotekë ofron ambientet e nevojshme fizike për të përballuar një frekuentim mesatar ditor rreth 140 studentë e pedagogë. **Evidenca 4.35.** Gjithashtu ajo ofron komoditet në ajrim dhe ngrohje. Është e pajisur me fond të pasur zërash, duke ofruar literature hardcopy dhe online.<br>Kjo bibliotekë funksionon me dy turne dhe në mbështetje të saj ka një numër stafi të mjaftueshëm për të përballuar frekuentimin ditor. Në tërësi, biblioteka e FSHN ofron 92 poste studimi në fondin e hapur të librit, 4 vende në ambjentin e shërbimit të fondit kryesor, 44 vende në fondin e hapur të periodikut. Evidenca 28.1, 28.2<br>**Evidenca, tabela përmbledhëse, Tabela 16** |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e | Në fondin e bibliotekës gjenden libra, monografi, revista dhe periodikë shkencorë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj.<br>Numri total i titujve shkencorë sipas deklarimeve (libra e monografi shkencore) është rreth 36520 njësi, nga të cilët 24335 janë libra, 719 në shqip dhe 23616 në gjuhë të huaj.<br>Numri total i revistave dhe periodikëve shkencorë në shqip e gjuhë të huaj është 24441 njësi nga të cilët 64 janë në shqip dhe 24377 në gjuhë e huaj. **Evidenca 28.1.** |

| | |
|---|---|
| përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Duhet theksuar edhe aksesi që garanton biblioteka në revistat online që UT ka akses përfshirë dhe Jstore mundësuar nga RASH. **Evidenca 1.14, Evidenca 1.15, Evidenca 3.19** |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Konstatohet që studentëve iu sigurohet qasje e barabartë dhe pa pagesë në bibliotekat online, siç është ajo U-library dhe disa të tjera biblioteka digjitale dhe platformë online që ofrojnë literaturë në gjuhë të huaj, JSTOR, EDGAR, IOP, ASTM, MSP. në të cilat mundësohet qasje elektronike e studentëve dhe pedagogëve nëpërmjet llogarive personale. Edhe nga biseda e GVJ me studentët u konstatua ky fakt. **Evidenca 3.16**<br>Studentët dhe personeli i UT kanë mundësisë për akses pa pagesë në bibliotekën "online" Ulibrary. UT në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ka finalizuar marrëveshjen për abonimin në bibliotekën digjitale JSTOR, e cila ofron artikuj të revistave akademike dhe libra në 75 disiplina. Gjithashtu studentët e Programit të studimit Bachelor në Fizikë mund të shfrytëzojnë burimet onlinë në të cilat FSHN është e regjistruar në Konsorciumin Ndërkombëtar EIFL. **Evidenca 1.14** |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | Biblioteka është në proces digjitalizimi dhe përmirësim të rrjetit të brendshëm. **Evidenca 4.35.** Nuk ka program specifik por si anëtare në rrjetin e sistemeve bibliotekare COBISS.NET, kërkimi në katalogun e përbashket të bibliotekave realizohet nëpërmjet këtyre sistemeve. Departamenti i Fizikës u ofron studentëve mudësinë të përdorin edhe kompjuterat e laboratorit të Programimit dhe Fizikës Llogaritëse, të cilët kanë të gjithë programet e nevojshme kompjuterike për shfrytëzimin nga ana e studentëve. **Evidenca 1.14, Tabela përmbledhëse, Tabela 17,** |
| **Kriteri 5**. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Nga kontrolli i GVJ rezulton se UT/FSHN aplikon për çdo vit një procedurë duke filluar nga propozimi i njësisë bazë për pasurimin e fondit ekzistues me tituj të rinj: libra, abonime online etj., e deri në miratimin dhe shtimin e tyre në fondin e bibliotekës. **Evidenca 32.1, Evidenca 32.2, Evidenca 32.3, Evidenca 32.4**<br>Në buxhetet e viteve 2019, 2020, 2021, FSHN në zërat blerje fond libri, libra, abonime në bibliotekat elektronike, dhe revistat periodike ka përcaktuar financimet e nevojshme për blerjen e literaturës së nevojshme bashkëkohore dhe specifike për programet e studimit. **Evidenca 1.14, Evidenca 1.15** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Rezulton që biblioteka është në dispozicion të studentëve në një orar të gjerë, 8.00-20.00 nga e hëna në të enjte dhe 8:00-18:00 ditën e premte, mbështetur edhe nga staf administrativ përkatës. **Evidenca 28.2.**<br>Në kushtet normale të punës, në bibliotekë ofrohet shërbim me dy turne ndërsa në kushtet e pandemisë është zbatuar rregullorja përkatëse. **Evidenca 28.1. Evidenca 4.35** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Nga evidencat dhe vizita në Institucion, rezulton që Sekretaria Mësimore e FSHN si detyrim ligjor të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe rregullores së UT, administron gjithë informacionin që lidhet me studentët: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të studentëve, të cilat arkivohen në arkivat e shtetit dhe në funksion të këtyre administron: dosjet e regjistrimit të studentëve, procesverbalet e provimeve dhe detyrimeve, dosjet e transferimit të studentëve, statistika të frekuentimit të studentëve, të studentëve që çregjistrohen, dosjet e diplomimit etj. Të gjitha këto arkivohen në arkivin e sekretarisë mësimore dhe shërbejnë si bazë për dhënien e informacioneve zyrtare nga sekretaria. **Evidenca; Regjistri themeltar i studentëve (vizita në sekretari)**<br>Është në proces ndërtimi i sistemit te ri elektronik për administrimin e të dhënave për studentët dhe lidhjen e tij me sistemin qeveritar e-albania. Gjatë periudhës së diktuar nga përhapja e virusit Sars-Cov.2 (Covid-19), institucioni ka përdorur me sukses edhe sisteme të tjera informatike në funksion të aktiviteteve didaktike, sikurse është paketa Microsoft Office 365, ku në të përfshihet edhe moduli i komunikimit online Microsoft Teams. Në këtë platformë, studentët, pedagogët dhe stafi ndihmës akademik kanë qasje bazuar me kredencialet institucionale në domain @unitir.edu.al. Studentët kanë adresa të postës elektronike në formatin: **Emër.mbiemër@fshnstudent.info; Emër_mbiemër.fshnstudent@unitir.edu.al**; **Evidenca 3_14, Evidenca 22, 29.1, 29.2** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Nga evidencat e paraqitura dhe vizita në Institucion, rezulton që Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arshivës, janë sektorët që administrojnë gjithë informacionin e duhur për personelin akademik (efektiv dhe me kontratë), ndihmës akademik dhe administrativ, informacion ky që konsiston nga i gjithë dokumentacioni lidhur me arsimimin, përparimin akademik, procedurat e punësimit dhe kontratat e punës së secilit. **Evidenca 4.13.** Këto të dhëna përditësohen vazhdimisht në varësi të përparimit të secilit, sipas aktivitetit përkatës. Gjatë vizitës në institucion, gjatë shqyrtimit rastësor të disa prej dokumentacionit të stafit akademik PAE dhe atij PAK, u vu re së në disa prej tyre kishte mangësi informacioni, apo informacion jo të azhornuar.**(Vizita në burimet njerëzore)** |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sipas evidencës së paraqitistemi i menaxhimit siguron akses studentëve dhe personelit akademik, i cili është konfidencial në respekt të ruajtjes së të dhënave personale dhe mundësohet nëpërmjet llogarive personale. Studentët kanë në dispozicion portal elektronik nëpërmjet aksesit individual në të cilin ai kryen regjistrimin për kurset që do të frekuentojë, njohjen me rezultatet në provime etj. Gjithashtu në faqen zyrtare elektronike, studenti nëpërmjet aksesit individual mund të sigurojë faturat për tarifat e studimit, listë notash, certifikata apo dhe programet mësimore. Akses elektronik i sigurohet edhe personelit |

| | |
|---|---|
| | akademik, ndihmës akademik dhe sekretarisë mësimore. **Evidenca 3_14.** Sistemi i menaxhimit të institucionit dhe sekretarisë mësimore, nuk parashikon mundësinë e hedhjes dhe ruajtjes së detyrimeve lëndore të studentëve. Detyrime që janë parakusht për të lejuar pjesëmarrjen në provim. Detyrime si frekuentimi, shlyerja e laboratorëve apo e projekteve dhe detyrave të kursit. Ky detyrim mirëmbahet vetëm nga pedagogu i lëndës, i cili, edhe pse ka në dispozicion listën e studentëve të grupit që ka provim, të hartuar nga sekretaria mësimore, mund të mos lejojë studentë të zhvillojnë provimin, pasi ka detyrime lëndore të pa shlyera. Mbajta e informacionit rreth shlyerjes së detyrimeve të lëndës nga pedagogu për secilin student, mund të paraqesin vështirësi në transmetimin e këtij informacioni në rast të ndërrimit të pedagogut të lëndës, apo në rast të studentëve që frekuentojnë lëndën në një vit akademik, por për motive nga më të ndryshme, zhvillojnë provimin e saj, në vitet pasardhëse akademike. Gjithashtu në faqen zyrtare elektronike të FSHN studentët mund të printojnë fatura në lidhje me tarifat e studimit, vërtetim studenti, listë notash, çertifikatë notash, programi studimi shqip dhe anglisht, etj. **www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Nga GVJ u konstatua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimit, ashtu edhe jashtë saj. **(Takimi me studente).** Komunikimi mes studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ zhvillohet edhe nëpërmjet postës elektronike zyrtare në domain të institucionit, ashtu edhe në modulet e përdorura për komunikim online si Microsoft Teams. Institucioni përdor edhe faqen online institucionale të FSHN lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit, informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj. **www.fshn.edu.al.** Njëkohësisht, komunikim kryhet edhe nëpërmjet faqes së Departamentit, në të cilën janë të detajuara edhe të dhënat për secilin nga personeli akademik. Në përgjithësi, i gjithë personeli ka paraqitur të dhëna lidhur me arsimimin, titujt, botimet dhe disiplinat që mbulon. **Evidenca 26** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është platforma TEAMS, faqet zyrtare të UT dhe FSHN ku informacioni është i drejtpërdrejte në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. **Evidenca 3.14**<br>Nëpërmjet sistemit të menaxhimit, llogarive personale emer.mbiemer@fshn.edu.al dhe emer.mbiemer@unitir.edu.al dhe emer.mbiemer@fshnstudent.info. emer_mbiemer.fshnstudent@unitir.edu.al), platformës dixhitale MS Teams, faqeve zyrtare të IAL (www.unitir.edu.al dhe www.fshn.edu.al) garantohet në kohë reale aktiviteti akademik dhe adminstrativ i personelit akademik, ndihmës akademik, raportimet individuale të dhënat mbi organet drejtuese etj..<br>**www.unitir.edu.al; http://fshn.edu.al;** |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në | Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të UT, faqes elektronike të FSHN si dhe asaj të departamentit, të cilat rezultojnë të përditësuara. www.fshn.edu.al. Në këtë faqe gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor |

| | |
|---|---|
| faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | dhe syllabuset e çdo disiplinë. Konstatojmë që syllabuset e shkurtuara janë të paraqitura në faqe të departamentit. Ato japin informacion lidhur me objektivat e lëndës, konceptet themelore, strukturën e disiplinës si dhe mënyrën e vlerësimit. akademike shkencore, udhëzues dhe manuale për studentët etj. Të gjitha informacionet e publikuara respektojnë politikat institucionale të publikimit të informacionit për të drejtën e informimit. Në Faqen e ëeb-it, një hapësirë e veçantë i është dedikuar edhe Programit të Transparencës. **Evidenca 31.**<br>Informacion i plotë jepet edhe nëpërmjet guidave dhe broshurave informuese. **Evidenca 58, 5.11, 5.12** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ konstatoi edhe nga biseda me grupet përkatëse se ekziston një procedurë plotësisht e përcaktuar e propozimit dhe miratimit të buxhetit vjetor dhe afatmesëm të institucionit ku përfshihet edhe ajo e departamentit, e cila mbulon kostot e programit të studimit dhe nevojave për mbështetje financiare për aktivitete botuese. **Evidenca 32.1, 32.2, 32.3, 32.4.** Kjo procedurë fillon që nga njësia bazë dhe në mënyrë progresive në nivelet më lart, si Fakulteti dhe gjithë universiteti dhe është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Informacionet/raportet për buxhetin publikohen nga FSHN.<br>Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore.<br>Hartimi i buxhetit të Universitetit fillon nga njësitë bazë, departamentet; Departamenti i Fizikës harton çdo vit plan buxhetin në funksion të mbështetjes së programeve të studimit, laboratoreve, kërkimit shkencor etj. **Evidenca 33.** Tarifa e rregjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të UT në çdo vit akademik vendoset nga Bordi i Administrimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.**Evidenca 3.13** |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, | Plani i financimit rezulton të përfshijë gjithë financimet e burimeve njerëzore që i shërbejnë realizimit të programit, si ato për shpenzime operative, edhe ato për abonimet online, pasurimin e bibliotekës, mbështetje për botimet shkencore etj. Plani financiar është i detajuar sipas gjithë zërave në mbështetje të shpenzimeve operative infrastrukturore dhe ato të mbështetjes së veprimtarive mësimore-shkencore. **Evidenca 32.1, 32.2, 32.3, 32.4**<br>Në buxhetin e UT/FSHN përcaktohen: detajimi i kuotave të buxhetit të konsoliduar (grant mësimdhënie, të ardhura UT); detajimi i shpenzimeve operative; detajimi i investimeve; numri i planifikuar i punonjësve.<br>Në zërat e buxhetit përfshihen: mbështetje e stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe rimbursim publikimesh, shpenzime operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse (pajisje laboratorike, kompjutera etj.) shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, |

| | |
|---|---|
| grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | etj., për të cilat specifikohen edhe burimet e financimit. **Evidenca 47-48, 18.1, 18.2, 18.3** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Auditimi i gjendjes së financimit dhe efektiviteti financiar të institucionit përveç organizmave të auditit të KLSH dhe MAS, ka dhe sektorin e auditit të brendshëm nën varësinë e Bordit të Administrimit i cili kryen në mënyrë periodike auditimin dhe raporton përpara Bordit të Administrimit.<br>Raportet financiare përmbajnë në mënyrë të hollësishme situatën financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare sipas zërave të aktiviteteve dhe sipas departamenteve. Auditimet zhvillohen në përputhje me Programin e Transparencës së Universitetit të Tiranës. **Evidenca 47-48, 18.1, 18.2, 18.3** |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Rezulton që raportet dhe analizat financiare të hartuara nga universiteti në fund të çdo viti dhe për vitet akademike paraardhëse, ruhen në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore për arkivë-protokollin. Planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme parashikohen në buxhetet afatmesme për të garantuar mbarëvajtjen normale të programeve të studimeve. **Evidenca 5** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Me miratimin e buxhetit nga Bordi i Administrimit, si një përmbledhje e harmonizuar e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e të gjithë strukturave të universitetit në mbështetje të plotë të nevojave të gjithanshme për realizimin e misionit dhe objektivave të universitetit në tërësi dhe programeve të studimit në veçanti, garantohet qëndrueshmëria financiare e gjithë periudhës së zhvillimit të programit të studimit. UT rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare (grantet e MAS, të ardhurat nga studentët dhe të ardhura nga shërbime për të tretë etj.) ekzistuese për të realizuar objektivat e tij. **Evidenca 4.34,**<br>**Evidenca 32.1, 32.2, 32,3, 32.4** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1<br>Instituciоni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Universiteti i Tiranës harton dhe zbaton politika dhe procedura që rregullojnë veprimtarinë e institucionit dhe studentëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor në Fizikë. **Evidenca 1.1, Evidenca 1.2**<br>Rezulton që pranimi i studentëve kryhet mbi bazën e procedurave të parashikuara nga korniza ligjore në fuqi dhe mbi bazën e kuotave të miratuara nga MAS. E gjithë procedura e propozimit të kuotave, miratimit të tyre, procedurat e përzgjedhjes së tyre, rregullat e vlerësimit dhe frekuentimit, rregullat e kalimit nga një vit në tjetrin, të transferimit të tyre, ndjekja e një program të dytë studimit, të diplomimit të tyre, janë të sanksionuara në Statutin e UT, Rregulloret e UT, FSHN, DI dhe programit të studimit. **Evidenca 1.5**<br>Pranimi i studentëve në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke synuar të përzgjidhen për të vazhduar studimet kandidatët me rezultate më të larta. UT dhe Departamenti i Fizikës kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentëve duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse. Studentët në këtë program diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. **Evidenca 1.3; Evidenca tabela përmbledhëse, Tabela 21** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Politikat dhe procedurat e pranimit në programin e studimit "Bachelor në Fizikë" janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kuotat dhe kriteret pasi janë hartuar dhe miratuar në njësinë bazë, dhe miratuar nga të gjitha hallkat brenda UT, miratohen edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin duke u bërë publike edhe në portalin U-Albania për të gjithë kandidatët studentë në të gjithë vendin. Mënyra e pranimit dhe regjistrimit kryhet në përputhje me aktet ligjore të lëshuara nga MAS për të gjithë kandidatët-studentë të vendit në çdo vit akademik, duke respektuar gjithë instancat e përfshira në të që nga njësia bazë derisa shpallen fituesit nga FSHN pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit përkatës. **Evidenca 1.1**<br>Politikat dhe procedurat që kanë të bëjnë me përparimin e studentëve, frekuentimin e tyre, përfaqësimin e tyre në organet drejtuese etj., janë të rregulluara nëpërmjet dokumenteve zyrtare të UT, Statutit të UT, rregullores së UT, dhe rregullores së programit të studimit. Në to janë të pasqyruara qartë të drejtat dhe detyrat e studentëve, të cilat garantojnë barazinë ndërmjet tyre.<br>Gjithashtu barazia dhe të drejta të njëjta për të gjithë studentët, garantohet edhe nga elemente të tjerë të rëndësishëm informimi siç janë: faqja elektronike e FSHN, e departamentit, informimi nëpërmjet adresave personale elektronike për çdo student, pjesëmarrja e studentëve në këshillat studentore, në senat, në Bordin e Administrimit, në Komisionet e ndryshme të UT. Garantohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitete shkencore dhe sociale. **Evidenca 5.11, 5.12** |

| | |
|---|---|
| | Ata informohen për mundësitë e reduktimit të tarifave të studimit sipas akteve ligjore, informohen në mënyrë të barabartë për mundësitë e mobiliteteve në programe të ndryshme europiane, kanë mundësi këshillimi me psikologun e FSHN; kanë të përcaktuar për çdo vit studimi një Kujdestar Akademik dhe pjesëmarrja në veprimtari të tjera akademike dhe sportive apo dhe pjesëmarrje në mobilitete Erasmus. Në nivel institucional është ngritur Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Gjithashtu, informacione të mjaftueshme për veprimtaritë e mësipërme gjenden në faqen ëeb të UT, FSHN dhe Departamentit. **Evidenca 30** |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, që nga përcaktimi dhe miratimi i kuotave dhe kritereve për një program studimi, UT/FSHN përveç procedurave të unifikuara dhe të sanksionuara në aktet ligjore të Qeverisë dhe MAS të Republikës së Shqipërisë, të cilat bëhen transparente për publikun nga QASH dhe të cilat janë të pasqyruara edhe në dokumentet zyrtare ligjore të tij: Statuti, Rregulloret etj, kryen edhe procedura të tjera në shërbim të aksesimit sa më të gjerë për publikun. **Evidenca 1.1.** Merret pjesë në ditët e informimit të maturantëve ku pedagogë të Departamentit të Fizikës marrin pjesë për të informuar maturantët me procedurat, kriteret dhe informacione të tjera që lidhen me programin e studimit Bachelor në Fizikë; shpërndahen fizikisht dhe në faqen ëeb (FSHN) udhëzuesin dhe fletëpalosjen e përgatitur me gjithë informacionet e nevojshme për maturantët. **Evidenca 1.5. Evidenca 1.3.** Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës pranë FSHN jep informacion mbi programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Kjo zyrë mbështet studentët për orientimin dhe këshillimin gjatë gjithë cikleve të studimit. Kjo degë, organizon "Javën orientuese" në javën e parë të vitit akademik si një javë orientuese dhe informuese për studentët e vitit të parë, ku studentët njihen me elementet e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij, me kurrikulën mësimore që ata do të zhvillojnë gjatë ciklit të tyre të studimit, me organizimin e institucionit, me të drejtat dhe detyrat e tyre, me jetën studentore etj. **Evidenca 5.11, 5.12.** Për çdo vit akademik, Departamenti cakton dhe Kujdestarin Akademik si këshillues permanent i studentëve të vitit përkatës. Informimi kryhet edhe nga çdo personel akademik përkatës i disiplinës përkatëse. Njëkohësisht studentët e marrin këtë informacion edhe ndërmjet dokumenteve zyrtare në faqen ëeb të FSHN dhe Departamentit. **Evidenca 3.22, Evidenca 1.10** |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | Çdo vit akademik vendosen kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit "Bachelor në Fizikë". **Evidenca 1.1.** Kjo realizohet në bazë të procedurës së përcaktuar në Statutin e UT, në përgjigje të kërkesës së MAS, me propozim të Departamentit të Fizikës, miratim të senatit të UT dhe vendim të MAS. Këto kritere të pranimit publikohen në faqen zyrtare të UT, FSHN dhe Departamentit të Fizikës, si dhe shpërndahen nëpërmjet broshurës "Mbi programet e studimit dhe kriteret e pranimit" si dhe fletëpalosjes. tek maturantët. Përzgjedhja e kandidatëve për programin e studimit "Bachelor në Fizikë" bëhet përmes aplikimit nga ana e kandidatëve të interesuar, sipas kritereve të vendosura dhe brenda afatit të përcaktuar, në përputhje me aktet e nxjera nga MASR për këtë qëllim. Për të ndjekur programin e studimit Bachelor në Fizikë studenti duhet të ketë një diplomë të arsimit të mesëm që plotëson kriterin e notës |

| | |
|---|---|
| | mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. **Evidenca 30.**<br><br>**www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Çdo departament në FSHN/UT propozon kuotat e pranimit, kriteret e pranimit dhe të përzgjedhjes së aplikantëve fitues jo më vonë se data 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron. Këtu përfshihet edhe programi i studimit Bachelor në Fizikë, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë me notë mesatare minimalisht 7.5 (shtatë pikë pesë), ndërsa për vitin akademik 2021–2022 dhe në vijim, kanë të drejtë të aplikojnë kandidatë me notë mesatare minimalisht 8 (tetë). Kandidatët janë të detyruar të plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga Departamenti i Fizikës/FSHN. Këto kritere shpallen nga FSHN jo më vonë se data 20 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron. Kriteret i përcillen rektoratit, i cili ka për detyrë t'ia përcjellë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Brenda datës 20 Dhjetor të çdo viti, Senati Akademik i UT-së përfundon propozimin e tij për kuotat e pranimit në secilin fakultet. Gjithashtu në kuotat e përcaktuara parashikohen dhe ato për shtetasit e huaj. **Evidenca 30**. Sikundër kemi konstatuar edhe më lart, në programin BSc. në Fizikë, ka rënie të theksuar të numrit të studentëve nga viti në vit çka e bën të vështirë përzgjedhjen e studentëve më të mirë. Për këtë arsye, departamenti dhe strukturat e tjera të institucionit duhet të iniciojnë politika promovuese në funksion të programit të studimit. Nga ana tjetër, niveli i ulët i maturantëve në hyrje, nuk garanton cilësi të programit të studimit dhe studentëve gjatë studimeve universitare. **Evidenca 11** |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Në bashkëpunim me DRAP dhe ZVA, FSHN dhe Departamenti i Fizikës, organizojnë me nxënësit – maturantë të shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë takime informuese në "javën e informimit". Përpara fillimit të vitit akademik, UT/FSHN, organizon ditët e informimit me maturantët sipas një kalendari të përcaktuar dhe vë në dispozicion materiale dhe broshura informuese për t'i informuar dhe njohur ata me programet e studimit, organzimin e institucionit, të drejtat dhe detyrat e studentit, jetën studentore, etj. **Evidenca 1_10**<br>Informacion i plotë mbi Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Departamentin e Fizikës dhe konkretisht mbi programin e studimit Bachelor në Fizikë gjendet në ëebsite: Në këto takime merr pjesë personeli akademik, të cilët informojnë në detaje dhe qartësojnë nxënësit – maturantë mbi të gjitha programet e studimit që FSHN ofron, si dhe mbi procedurat dhe kriteret për t'u regjistruar si student në secilin program studimi. Informacionet për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit publikohen në ëebsite-in e FSHN.<br>Në fillim të çdo viti akademik studentët e vitit të parë të programit Bachelor në Fizikë prezantohen me përgjegjësin e Departamentit të Fizikës dhe pedagogët, të cilët i orientojnë në lidhje me kërkesat e programit të studimit si dhe i udhëzojnë si të përdorin burime të ndryshme informacioni. **Evidenca 5.8, 5.11** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.2**

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Nga vizita në institucion rezulton se Departamenti i Fizikës ofron informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informacion gjendet i pasqyruar në rregulloren e programit të studimit, i cili është dhe i publikuar në faqen ëeb. **Evidenca 1.3**, **www.fshn.edu.al**. Gjithashtu, ky informacion jepet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet javës orientuese në fillim të studimeve. Informacioni jepet edhe nëpërmjet vetë personelit akademik për çdo disiplinë bazuar tek syllabusi i saj apo dhe nga Kujdestari Akademik i çdo viti që caktohet çdo fillim viti akademik për çdo vit studimi. **Evidenca 3.22;** Njëkohësisht, këto informacione që studenti i merr drejtpërsëdrejti apo dhe të tjera shtesë që lidhen dhe me infrastrukturën e FSHN, studenti mund t'i marrë edhe nëpërmjet faqes ëeb të FSHN dhe Departamentit. **Evidenca 1.10**<br>Metodat e monitorimit dhe ndjekjes së studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit të ofruar nga Departamenti i Fizikës. Informacioni është publikuar edhe në faqen elektronike të FSHN. **Evidenca 7** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Në bazë të evidencave të paraqitura, rezulton që ekziston një procedurë e lidhur me kriteret dhe procedurat e transferimeve të studentëve dhe ekuivalentimeve të mundshme pas transferimit. I gjithë ky informacion gjendet në Statutin dhe Rregulloren e UT. **Evidence 1.1, Evidenca 1.3** Duke u mbështetur në këto dokumente ligjore, Departamenti i Fizikës, informon studentët mbi programin e studimit "Bachelor në Fizikë": përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në këtë program dhe afatin e përfundimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme që ata mund të kenë kryer, sezonet e provimeve etj. Kriteret dhe procedurat në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, të realizuara nëpërmjet komisioneve të ekuivalentimit të lëndëve, janë parashikuar në aktet e brendshme të institucionit. **Evidenca 1.7** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Institucioni informon studentët në mënyrë të detajuar lidhur të gjithë elementët dhe procedurat e vlerësimit të tyre në çdo disiplinë si nga personeli akademik përkatës ashtu edhe nga koordinatori i programit në mënyrë të drejtpërdrejtë, por këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga Rregullorja e UT, e Programit të Studimit, apo syllabuset e disiplinave që gjendet në faqen ëeb. **Evidenca 2.2**<br>Informohen në afatet e duhura në ambiente publike lidhur me kohën dhe oraret e provimeve. Për të vlerësuar studentin me pikë, përdoren kryesisht aktivizimi dhe frekuentimi në auditor, testimi me shkrim apo dhe me gojë. Pikët konvertohen në notë mbi bazën e intervaleve plotësisht të përcaktuara në syllabusin e lëndëve. Studentit i jepet mundësia të njihet me testin që ka shkruar, me pikët e çdo elementi në vlerësim dhe gjithashtu ka dhe të drejtën e ankimimit në rast se lind nevoja në afatet kohore dhe me mënyrën e përcaktuar në Rregullore.**Evidenca 25**. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe | Rezulton që studentët e vitit të tretë informohen që në fillim të vitit akademik dhe gjatë tij, nga Kujdestari Akademik dhe sekretaria mësimore për rregullat dhe programin e diplomimit. Gjithashtu ky informacion merret edhe nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UT, Rregulloren e Programit të Studimit si dhe ekziston dhe Rregullorja e Diplomimit. |

| | |
|---|---|
| diplomimit në programin e studimit. | Departamenti, edhe nëpërmjet koordinatorit të programit i informon ata rreth procedurës dhe llojit të provimit të formimit të parashikuar. Informacion që gjendet edhe në rregulloren e vet programit të studimit. Kriteret dhe procedurat e diplomimit gjenden në Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloren e Programit **Evidenca 1.1, 5, www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Institucioni, fakultetet dhe departamentet publikojnë udhëzues të posaçëm, si broshura dhe fletëpalosje mbi kriteret e pranimit dhe informacione në lidhje me programet e studimit të ofruara. **Evidenca 5.11, 512.** Njëkohësisht, Universiteti i Tiranës, FSHN, në bashkëpunim me drejtoritë vendore rajonale të arsimit para-universitar, dhe përfaqësues të departamentit të Fizikës, organizojnë takime me maturantët në shkollat e mesme, kryesisht në periudhën Mars-Maj, që është periudha para plotësimit të formularëve të aplikimit të maturantëve. Kjo gjë bëhet edhe në panairin e universiteteve apo Ditët e Hapura të informimit të maturantëve të organizuara në rrethe të ndryshme. Gjithashtu, gjithë ky informacion publikohet edhe në faqen e interentit. Stafi i departamentit dhe studentë kryejnë takime me gjimnazistë dhe prindër të interesuar për të vazhduar studimet në programet e studimit dhe i informojnë ata mbi natyrën dhe kërkesat e programeve të studimit, mundësitë e punësimit. **Evidenca 1.10,** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Rezulton që studentët informohen që në javën e parë të vitit akademik në javën orientuese në mënyrë të hollësishme lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Këtë informacion e marrin edhe në vijim të vitit nëpërmjet zyrës së këshillimit dhe karrierës edhe nga personel akademik. **Evidenca 5.11, 5.12**<br><br>Njëkohësisht këtë informacion ata mund ta marrin edhe nga faqja ëeb e FSHN dhe e Departamentit, ku ata mund të njihen gjithashtu edhe për infrastrukturën e ambienteve dhe shërbimet që merren prej tyre. Në mbështetje të studentëve për informacion është dhe sekretaria mësimore dhe dega e IT së FSHN. GVJ konstatoi nga biseda me ta, që studentët ishin të informuar për këto elemente. **www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Personeli akademik i Departamentit të Fizikës në çdo fillim viti/semestri, japin informacion në lidhje me lëndët /modulet, kreditet, syllabusin përkatës, ngarkesën mësimore, frekuentimin dhe orët në auditor, mënyrën e vlerësimit, etj.. Syllabuset (të cilat gjenden në ëebsite-n e Departamentit të Fizikës) japin gjithashtu informacionin e nevojshëm në lidhje me lëndët **Evidenca 2.2, Evidenca tabela përmbledhëse, Tabela 9, Tabela14** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi | Informacioni rezulton të merret në Javën Orientuese në javën e parë të vitit akademik, merret nga çdo titullar i lëndëve, i cili informon në detaje |

| | |
|---|---|
| mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | strukturën, përmbajtjen, frekuentimin, vlerësimin, kreditet, objektivat, veprimtaritë formuese dhe qëllimet e lëndës. Studentët këto informacione mund t'i marrin edhe nëpërmjet faqes ëeb, nëpërmjet sistemit elektronik, ndërmjet sekretarisë mësimore dhe bibliotekës së FSHN. **Evidenca 5.15**<br>Megjithatë, referuar takimeve të zhvilluara rezulton se informacionet për mundësitë e punësimit të studentëve të diplomuara, janë të limituara. Vetë natyra dhe profili i programit të studimit rezulton se kanë hapësirë në tregun e punës. Megjithatë, bazuar në deklarimet e stafit, rezulton se për studentët që përfundojnë studimet në FSHN, sektori privat mbetet më tërheqës me rreth 43% të të punësuarve, por një përqindje të konsiderueshme zë edhe sektori shtetëror me 22%. **Evidenca 5.11, 5.12** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentët në çdo fillim viti akademik, marrin informacion mbi institucionin dhe programet e studimit që ofrohen, akreditimin e tyre dhe të institucionit, vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor. www.unitir.edu.al<br>Ka disa forma nëpërmjet të cilave studentët informohen për procesin mësimor dhe elementët e tij apo infrastrukturën dhe shërbimet prej saj që lidhen me procesin mësimor: nëpërmjet kujdestarit akademik, faqes ëeb të fakultetit dhe departamentit, stendës informative në hollin e departamentit, platformave online të mësimdhënies. Gjithashtu, nëpërmjet faqes së internetit të FSHN dhe UT studentët marrin informacion të përditësuar në lidhje me procesin mësimor si: orarin mësimor, sallat e leksioneve, seminareve dhe laboratoreve, si dhe për aktivitete të ndryshme, konferenca shkencore, workshop-e etj. **Evidenca 1.7** |
| **Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | Konstatohet se përdoren disa forma të informimit të studentëve për programin e studimit: nëpërmjet kujdestarit akademik, personelit akademik përkatës të çdo disipline, faqes ëeb të fakultetit dhe departamentit, nga komunikimi elektronik nëpërmjet adresave e-mail me domain institucional dhe platformave online. Nëpërmjet faqes ëeb të FSHN dhe UT, si dhe nëpërmjet e-mail-it studentët marrin informacion në lidhje me programin e studimit Bachelor në Fizikë. https://fshn.edu.al/, ; https://unitir.edu.al/. Në kushtet e zhvillimit të mësimit online për 3 semestra, stafi i IT-së ka mundësuar akses të plotë të studentëve për të zhvilluar mësimin në mënyrë online, për të aksesuar platformën Microsoft Teams dhe për të lehtësuar përdorimin e saj nga studentët në funksion të realizimit të programit të studimit. Në këtë platformë studentët gjejnë materialet e nevojshme si leksione, ushtrime, udhëzues për laboratoret, etj, të cilat janë lehtësisht të arritshme edhe në distancë si dhe mund të komunikojnë me pedagogët përkatës. **Evidenca 3.14, Evidenca 3.2, 4.12** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | Gjithë baza e të dhënave dhe statistikat përkatëse lidhur me studentët deri në diplomim, administrohen nga Sekretaria mësimore për të gjitha vitet. Dokumentacioni bazë konsiston në regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistri i lëshimit të diplomës. **Evidenca 9.** Këto të dhëna arkivohen mbi bazën e ligjit mbi arkivimin e dokumentacionit zyrtar. Sekretaria mësimore administron të gjithë dokumentacionin për çdo student të regjistruar të çregjistruar, të transferuar, të diplomuar, në program të dytë studimi, gjithë vlerësimet akademike të tyre, dhe mbi bazën e të cilave prodhohen statistikat apo dokumentacionet zyrtare për studentin, institucionin apo MAS. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Një sërë dokumentesh mbahen në sekretarinë mësimore dhe janë materiali origjinal, nga i cili lëshohen tërë vërtetimet e kërkuara nga studentët, administrata e UT dhe MAS. **Vizita në sekretarinë mësimore.** Bazuar në këto statistika:<br>Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 51 studentë në programin e studimit "Bachelor në Fizikë".<br>Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 57 studentë në programin e studimit "Bachelor në Fizikë" .<br>Për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 38 studentë në programin e studimit "Bachelor në Fizikë". |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. | Sekretaria mësimore e FSHN mban në formë të shkruar: Regjistrin themeltar të studentëve, Rregjistrin e rezultateve akademike të studentit, Rregjistrin e lëshimit të diplomave, Të gjitha të dhënat e paraqitura në këto regjistra arkivohen në arkivat e shtetit. **Vizita në sekretarinë mësimore.**<br>Sekretaria mësimore arkivon: Dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacion sipas udhëzimeve të përvitshme të MAS, Procesverbalet e provimeve, Dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor, Dosjet e programeve të dyta të studimit, Statistikat e studentëve frekuentues, Statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit, Statistikat e studentëve që ç'rregjistrohen, etj.. **Evidenca, tabela përmbledhëse' Tabela 21, Tabela 23** |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Rezultatet e studentëve pasqyrohen në proces verbalet e provimeve të secilës lëndë nga pedagoget e tyre dhe njëkohësisht ato pasqyrohen edhe në bazën e të dhënave të sekretarisë mësimore si edhe në regjistrin themeltar. Rezultatin në provim studenti e merr nga pedagogu i lëndës përkatëse. Gjithashtu, i mundësohet në çdo moment aplikimi pranë sekretarisë mësimore për vërtetim notash.<br>Të dhënat në "Regjistrin themeltar", në "Regjistrin e arritjeve akademike të studentëve" dhe në "Regjistrin e Diplomave" janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Të dhënat statistikore mbi procesin mësimor të studentëve të përmendura me lart menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit duke ruajtur konfidencialitetin. **Evidenca 9.** Sekretaria mësimore e FSHN mban të dhënat për ecurinë akademike të studentëve, të cilat ruhen korrektësisht. Këto të dhëna përputhen me dokumentacionin tjetër të disponueshëm (p.sh. procesverbale provimesh, riprovimesh, etj.) dhe janë të sigurta dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar, si edhe garantohet siguria e tyre përmes platformave mbrojtëse (fireëall, etj.). |

| | |
|---|---|
| | Sekretaria mësimore menaxhon të dhënat e studentëve për programin e studimit dhe informacioni ruhet në "database"-in e sekretarisë. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale, të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion të pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat në përfundim depozitohen dhe ruhen sërish në sekretari. **Evidenca (vlerësim regjistri i arritjeve akademike, regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave)** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Si një detyrim ligjor kundrejt ministrisë përgjegjëse për arsimin, Universiteti i Tiranës, mbi bazën e raporteve të hartuara nga njësitë kryesore, harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij, në të cilin analizohet dhe vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore, ajo shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. Raporti vjetor i FSHN, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njësive bazë përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Në këto raporte pasqyrohen edhe masat/rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Ndër treguesit bazë të cilësisë së mësimdhënies në analizë është mesatarja e shkollës së mesme tek të regjistruarit në këtë program studimi, si dhe kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve. Në raportet vjetore të departamentit paraqiten rezultate analitike mbi numrin e të regjistruarve, dhe të diplomuarve të programit të studimit. **Evidenca 1.14**<br>Gjithashtu propozohen dhe masa/rekomandime për përmirësime të procesit mësimor.Në zbatim të Udhëzimit të MAS, UT-ja harton Raportin Vjetor me të gjithë elementet përbërës të tij në të cilin vlerësohet, ndër të tjera, veprimtaria mësimore dhe shkencore, si dhe ecuria e programeve që ofrohen. **Evidenca 1.15:** Raporti, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njësive kryesore/bazë dhe rektoratit, përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. **Evidenca 1.16, Evidenca 1_9** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Larte dhe Rregullores dhe Statutit të UT, studentët marrin pjesë në disa organe kolegjiale si: Senati Akademik, Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, Komisioni i përhershëm i kurrikulës, Këshilli i Etikës. **Evidenca 3_5.** Gjithashtu studentët marrin pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm për vlerësimin e programeve të studimit dhe vlerësimin institucional. Studentët janë dhe pjesë e vlerësimit të mësimdhënies dhe personelit akademik, nëpërmjet pyetësorëve që organizohen periodikisht me ta. **Evidenca 3_6** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se | Megjithëse institucioni ka të përcaktuar në aktet rregullatore përfshirjen e studentëve, angazhimi i tyre real, është i ulët. Edhe në vlerësimin e |

| | |
|---|---|
| përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | aktiviteteve universitare nëpërmjet anketimeve, pjesëmarrja e studentëve është në numër të ulët kundrejt totalit të studentëve. Kjo përbën edhe një bazë të ulët statistikore për vlerësimin korrekt të rezultateve të pyetësorëve. Sipas akteve rregullatorë të UT-së (Statuti i UT, Rregullore e UT), **Evidenca 1.1,** përfshirja dhe angazhimi i studentëve bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet e tjera në fuqi. **Evidenca 1.5.** Në UT, studentët marrin pjesë në: Senat, Këshilla Studentore, Komisione te përhershme në nivel universiteti sipas përcaktimeve statutore. **Evidenca 3.5, Evidenca 3.6, Evidenca, tabela përmbledhëse Tabela 24** |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | Referuar të dhënave të Programit të Studimit "Bachelor në Fizikë", ky program është i hartuar mbi bazën e akteve nënligjore në fuqi. Programi është i shtrirë në 3 vite akademike, 6 semestra. Çdo semestër ka 30 kredite dhe një ngarkesë prej rreth 20-21 orësh në javë në auditor dhe harmonizim të formave të vlerësimit brenda një ngarkese normale. **Evidenca 1.1**Gjithashtu edhe njohja e plotë ose e pjesshme e studimeve të mëparshme nëpërmjet transferimit të krediteve përkatëse të fituara më përpara në IAL tjetër, kryhet konform Statutit të UT. Në ndryshimet e reflektuara në vite është marrë parasysh ngarkesa e studentëve duke bërë një shpërndarje të kësaj ngarkese mes punës në auditor dhe jashtë tij. Programi ofron mundësi për transferimin e studentëve, të cilët kanë përfunduar të paktën një vit studimor në programe të të njëjtit cikël, prej institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, si dhe për transferime nga programet e mëparshme të ciklit të parë në programet e sotme brenda ose jashtë institucionit. **Evidenca 1.5;** Njohja e studimeve të mëparshme përmes transferimit të krediteve të përftuara në një IAL tjetër është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore. |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit është e garantuar me pjesëmarrjen reale të tyre në organet kolegjiale ku ata kanë mundësinë të shprehin mendimin dhe sugjerimet e tyre. Njëkohësisht ata kanë mundësi edhe gjatë kryerjes së pyetësorëve në nivel departamenti dhe fakulteti, por edhe në kontaktet që kanë me Kujdestarin Akademik të vitit përkatës. **Evidenca 1.1;** Gjithashtu, nga biseda e GVJ me studentët, u konstatua që ata shprehin këto sugjerime dhe mendime në Këshillin Studentor. **Takimi me studentët.** Sugjerimet dhe kontributi i studentëve merret edhe në nivel departamenti, në mënyrë të drejtëpërdrejtë për programin konkret të studimit që ata ndjekin nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës dhe mësimdhënies, fokus-grupe, kërkesave/ankesave, etj. Informacionet e mbledhura e ndihmojnë stafin akademik në përmirësimin e mësimdhënies. **Evidenca 3.5, Evidenca 3.6** |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Studentët janë pjesë integrale e vendimarrjes si e dhënies së mendimit nëpërmjet pyetsorëve.<br>Nga pikëpamja ligjore, në Rregulloren e UT dhe Rregulloren e programit të studimit, studentëve iu garantohet plotësisht mundësia për të ankimuar procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve si dhe rezultatin në to, me një procedurë plotësisht të përcaktuar. Nga biseda e GVJ me studentët, rezultoi që kjo realizohet në realitet konform rregullores. **Evidenca 1.5;** Studentët kanë të drejtë të njihen me korrigjimin e provimeve nga pedagogët e lëndës. Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit, i cili bën verifikimet e duhura dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni |

| | |
|---|---|
| | dekanin/drejtorin, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit/drejtorit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. **Evidenca 1.3. takimi me studentë** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Bazuar tek dokumentet kryesore zyrtare ligjore të UT: Rregullore, Statut, Rregullore e programit të studimit etj., funksionojnë disa njësi të posaçme me kompetenca të përcaktuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve si: zyra IT, Njësia bazë, Kujdestari Akademik, Dega e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës, Këshilli Studentor, Biblioteka e FSHN, Sekretaria Mësimore. **Evidenca 25.**<br>Nga biseda e GVJ me studentët rezultoi që të gjitha këto njësi janë funksionale, ku secila prej tyre informon studentët brenda fushës së vet të kompetencës. Departamenti në bashkëpunim me njësi/struktura të tjera si sekretaria mësimore, kujdestarët akademikë, dega e IT, zyra e financës (shërbimi i bursave), informon studentët mbi programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në programin e studimit dhe afatin e përfundimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, fillimin dhe mbarimin e vitit akademik, pushimet/festat zyrtare, sezonet e provimeve etj. **Takimi me studentë** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Rezulton që studentët informohen, këshillohen, asistohen në lidhje me çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit, nëpërmjet rregulloreve institucionale të publikuara në faqen ëeb të Universitetit të Tiranës dhe në atë të FSHN-së. Në faqen ëeb të Fakultetit të Shkencave të Natyrës gjenden edhe informacione të tjera që lidhen me procesin mësimor dhe infrastrukturën përkatëse në shërbim të studentëve. Në stendat informative ka të afishuara detaje lidhur me orarin mësimor, datat e provimeve, oraret e konsultimeve me personelin akademik. Gjithashtu, kujdestari akademik i vitit përkatës është një tjetër burim i vazhdueshëm informimi dhe këshillimi. Po ashtu, sekretaria mësimore është kontakti i parë dhe i vazhdueshëm për informacion për studentët. **Evidenca 1.1, Evidenca 4.13, www.fshn.edu.al** |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacion nëpërmjet faqes zyrtare të Fakultetit të Shkencave të Natyrës/Departmenti i Fizikës. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi rregulloret, zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Departamenti ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme |

| | |
|---|---|
| kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | akademike të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.<br>Programi i studimit Bachelor në Fizikë, nuk ka të parashikuar praktikë profesionale, nga ku studentët të mund të kishin një qasje jo vetëm për praktikë, por edhe për zhvillim karriere. **Evidenca 6.11.**<br>Institucioni ka të ngritur degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës e cila ka edhe përgjegjësinë së bashku me njësinë bazë, të orientojë studentët drejt karrierës së tyre profesionale. Gjatë takimit në institucion, dhe në veçanti me studentët, u vu re se kjo njësi informon studentët kryesisht me anë të postës elektronik rreth mundësive për punësim apo intershipe. Megjithatë nuk ka një qasje të orientuar rreth këshillimit të studentëve për qasjen që duhet të kenë në fillimin e karrierës së tyre profesionale. Kjo edhe si rrjedhojë e numrit të ulët të personelit të angazhuar në këtë sektor.<br>Për të rritur cilësinë e shërbimit të këshillimit të karrierës, mendojmë se institucioni duhet të rrisë përfshirjen e kësaj njësie në takime jo vetëm virtuale por edhe në auditor me studentët jo vetëm për të parashtuar njoftimet e kompanive për punë apo intershipe, por edhe për t'i orientuar ata rreth tregut të punës, mundësive të zhvillimit profesional apo krijimin e start-up apo kompani në fushën e këtij programi studimi. Evidenca 6.1. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Njësia që informon, këshillon dhe orienton studentët gjatë studimeve deri në diplomim me kontakte të drejtpërdrejta ose me material informuese, edhe në ciklin e dytë dhe më pas duke mbledhur të dhëna për punësimin e tyre edhe pas diplomimit është Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Gjithashtu UT organizon në mënyrë periodike edhe panairet e punës ku studentët mund të marrin informacione direkt nga punëdhënës të ndryshëm.<br>**Evidenca 2.10** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me | Mbështetur në evidencat përkatëse dhe verifikimi në realitet, rezulton që UT, në zbatim të detyrimeve ligjore që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, në dokumentet e tij zyrtare Statut etj., ka përcaktuar qartë strukturat dhe funksionet e tyre, që mbulojnë sigurimin e cilësisë. Është miratuar Manuali i Sigurimit te Cilësisë ku përcaktohen qartë parimet |

| | |
|---|---|
| parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | dhe procedurat për zbatimin e tij. **Evidenca 1.1;** Janë ngritur strukturat në rang universiteti, siç janë Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Komisioni i Kurrikulës, etj. funksionet, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të tyre janë të përcaktuara në Statutin e UT. **Evidenca 1.2; Evidenca 3.6**<br>Gjithashtu, në vijim janë ngritur strukturat në rang njësie kryesore, siç është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC apo DSBCK), e cila ndër të tjerash në bashkëpunim me Zv. Dekanin përkatës që mbulon Ciklin e parë dhe të Dytë të studimeve, organizon pyetësorët me studentët për cilësinë e mësimdhënies për disiplinat e programit të studimit, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. NJSBC harton raportet e vlerësimeve. **Evidenca 3.5** Në statutin e Universitetit të Tiranës, parashikohet gjithashtu, edhe ngritja e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) në njësitë kryesore. Ndër të tjera, detyra e NJSBC është organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. Në përfundim të procesit, NJSBC harton raportet e vlerësimeve, të cilat përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies e të kërkimit shkencor në njësitë kryesore të UT-së. **Evidenca 3.7, Evidenca tabela përmbledhëse, Tabela 24** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Në Universitetin e Tiranës Funksionon KPSSC si struktura përgjegjëse e ngarkuar nga Senati Akademik për të ndjekur dhe garantuar plotësimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo strukturë përbëhet nga 11 anëtarë, 8 anëtarë personel akademik dhe 3 anëtarë studentë, ku FSHN përfaqësohet me 1 anëtar personel akademik. UT ka krijuar Sektorin e Sigurimit të Cilësisë si strukturën ndihmëse akademike që mbështet veprimtarinë e KPSSC dhe NJSBC në njësitë kryesore. **Evidenca 3.6.**<br>FSHN ka ngritur si strukturë funksionale, Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK), e cila është në varësi të Dekanit, përbëhet nga dy punonjës me kohë të plotë, një kryetar dhe një specialist dhe veprimtaria e së cilës kryhet e bazuar në "Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës", mbështetur në "Manualin e Cilësisë" dhe "Paketën e Instrumenteve të Cilësisë", të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Tiranës. Nga verifikimi në realitet, rezultoi funksionale gjithë veprimtaria e saj.<br>**Evidenca 4.2. Evidenca 3.5, Evidenca 3.7** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Universiteti i Tiranës ka përfunduar disa procese të akreditimit institucional. Këtë vit institucioni ka kryer vlerësimin e jashtëm nga ASCAL dhe ekspertë të huaj. Njëkohësisht UT është në proces të akreditimit të të gjithë programeve të studimit që ofron. **Evidenca 3.7**<br>Siç rezulton dhe nga evidencat dhe bashkëbisedimi gjatë vizitës së GVJ në FSHN, Njësia e sigurimit të cilësisë bashkëpunon dhe bashkërendon punën me departamentin për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të realizuar vlerësimin e brendshëm, ftohen studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit të studimit. Njëkohësisht, Departamenti i Fizikës harton analizat vjetore ku ndër të tjera në të përfshihen edhe tipet e pyetësorëve të realizuar gjatë vitit akademik dhe konkluzionet përkatëse. Në bazë të tyre, hartohet nga Departamenti dhe plani i masave për përmirësim . DSBCK në FSHN bashkëpunon dhe |

| | |
|---|---|
| | bashkërendon punën me njësitë bazë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të mundësuar vlerësimin e brendshëm, FSHN bazuar në tipet e pyetësorëve të ofruara nga paketa e instrumentave, fton studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët/formularët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit. **Evidenca 6.11, 6.12, (raporte vjetore)** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Universiteti i Tiranës ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike në kuadër të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në dokumentet zyrtare siç është Statuti i UT-së parashikohen qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. **Evidenca 1.1**<br>Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentet dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njëkohësisht, në ndihmë të këtij procesi përveç pyetësorëve periodikë, Departamenti i Fizikës harton dhe në mënyrë të përvitshme analizat vjetore të punës së tij dhe harton dhe panin e masave për përmirësime te mundshme. **Evidenca 3.5;** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të Studimit të Ciklit të Parë, rezulton që UT ka të ngritura njësi të posaçme kryesore: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës etj.<br>Njëkohësisht, në nivel njësie kryesore, është ngritur dhe funksionon realisht Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Në këtë kuadër, dhe në mbështetje edhe të njësive të mësipërme, koordinimi i Përgjegjësit të Departamentit me zv. Dekanin që mbulon Ciklit e Parë të studimeve dhe zv. Dekanin që mbulon kërkimin shkencor, ndihmon në realizimin e analizave të punës mësimore-kërkimore dhe hartimin e raporteve përkatëse, të cilat më pas integrohen në raportimet vjetore si FSHN. **Evidenca 1.14; Evidenca 1.16**<br>Për një analizë më efektive, bazuar edhe në ndryshimet e shpejta teknologjike në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe në ngarkesën administrative të drejtuesit të njësisë bazë, monitorimi dhe rishikimi i programit të studimit, bazuar kryesisht vetëm në analizën e drejtuesit të njësisë kryesore, nuk rezulton efektiv. Kjo bazuar edhe në numrin e lartë të programeve të studimit që ofron kjo njësi bazë (tetë programe në total) dhe angazhimeve të tjera administrative të kërkuara |

| | |
|---|---|
| | prej drejtuesit të saj. **Evidenca 1.15; anekse tabela përmbledhëse, Tabela 24** |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Universiteti i Tiranës, si dhe njësitë kryesore përbërëse, kanë rregullore institucionale dhe formalisht të unifikuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë: raportet vjetore në rang departamenti dhe fakulteti e më tej në rang universiteti, që marrin në analizë punën mësimore-kërkimore; nga praktika konkrete të evidentuara Rezulton që ndiqen procedura standarde të bazuara në ligjin e arsimit të lartë, VKM, udhëzimet e MAS dhe dokumentet zyrtare ligjore të UT, për ndryshime në programin e studimit Bachelor në Fizikë. **Evidenca 1.14.** Gjithashtu, hartohen dhe zbatohen një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve mësimore të cilat rezultojnë pas plotësimit të pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies i cili realizohet për disiplinat e programit të studimit në fund të çdo semestri dhe para sezonit të provimeve. **Evidenca 1.15, Evidenca 1.16; Tabela përmbledhëse, Tabela 11** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës në FSHN përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve të cilat bazohen në dokumentin "Paketa e instrumenteve të cilësisë" të miratuar nga Senati Akademik. Këto mekanizma përfshijnë: **Evidenca 23, Evidenca 24**<br>- vlerësimin e lëndës nga studenti (pyetësor që plotësohet përpara provimit);<br>- vlerësimi i studentëve që diplomohen (pyetësor që plotësohet përpara se të marrin diplomën për cilësinë e programit të studimit);<br>- raporti i studentëve (pyetësor me studentët e diplomuar për cilësinë e arsimimit të tyre);<br>- vlerësimi i pedagogut (pyetësor që plotësohet nga studentët përpara provimit);<br>- Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu (i cili plotësohet nga çdo personel akademik në fund të çdo semestri në lëndët ku janë titullarë duke kryer një vetvlerësim dhe analizë bazuar në përqindjen e kalueshmërisë të studentëve dhe shpërndarjes së notave në përqindje);<br>Prej tyre, prodhohen statistika për program studimi, për lëndët e programit të studimit, për metodat e mësimdhënies (rasti i veçantë i përdorimit të platformës online në kohën e pandemisë) si dhe analiza për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programit mësimore aty ku shihet e nevojshme. **Evidenca 3.11;** Të gjitha këto mekanizma janë të unifikuar dhe të përfshira në Manualin e Cilësisë, Paketën e instrumenteve të cilësisë të miratuara në Senatin Akademik. **Evidenca 3.7**<br>Problem mbetet përqindja e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Ndoshta duhet të shtohet në këto mekanizma, edhe një vlerësim nga vetë personeli akademik, |

| | |
|---|---|
| | lidhur me infrastrukturën apo element të tjera të organizimit të institucionit. **Evidenca 3.10, Evidenca 3.12, Evidenca 3.8, Evidencë 3.4** |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Një ndër dokumentet bazë dhe të rëndësishëm që prodhohen nga mekanizmat e përmendura tek kriteri 3 më sipër, është raporti i veprimtarisë mësimore-kërkimore të njësisë bazë, i cili hartohet dhe merret në analizë në fund të vitit akademik, për t'u integruar më tej në raportet në nivel njësie kryesore. Në këto raporte gjenden të analizuara statistika të studentëve të regjistruar për çdo vit, të diplomuar për çdo vit, të çregjistruar, aktiviteti kërkimor i personelit akademik, përmirësimi i infrastrukturës, ngarkesa mësimore e personelit akademik, përqindja e kalueshmërisë dhe përqindja e të diplomuarve, të dhëna nga raportet e Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës lidhur me pyetësorët e studentëve etj.. . **Evidenca 3.10, Evidenca 3.12, Evidenca 3.8, Evidencë 3.4** |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | Të gjitha këto raporte të analizave vjetore në nivel njësie bazë, njësie kryesore dhe raporti i DSBCK, paraqesin përveç rezultateve të pritshme, edhe adresime të mangësive të ndryshme për përmirësimin e cilësisë. Raportet e DSBCK gjenden të publikuara edhe në faqen ëeb të FSHN. **Evidenca 1.15; Evidenca 1.16**<br>Si një element shumë i rëndësishëm i përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, kryhet dhe vlerësimi i performancës së personelit akademik që bazohet tek Manuali i Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, miratuar nga Senati Akademik dhe ku parashikohen të qarta parimet, procedurat, kriteret, periudhat e vlerësimit. Njëkohësisht, ky proces kryhet edhe për personelin ndihmës akademik që bazohet në Manualin "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës" të miratuar nga Senati Akademik. **Evidenca 1.14, www.fshn.edu.al** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin | Si elementë të rëndësishëm të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit janë analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore të departamentit, të cilat më pas integrohen në analizat në rang fakulteti dhe që kryhen periodikisht çdo vit. **Evidenca 3.1.** Gjithashtu, pjesë e vlerësimit të brendshëm, janë dhe analizat çdo vit të Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës, mbi bazën e pyetësorëve, të cilat publikohen edhe në rubrikën e vet në faqen ëeb të FSHN.<br>Të gjitha raportet vjetore në nivel fakulteti, të cilat më tej përdoren për raportet vjetore në nivel universiteti, janë pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit. Gjithashtu raportet/analizat e |

| | |
|---|---|
| institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | përvitshme të pyetësorëve të hartuara dhe realizuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës, e cila ka funksionin e Njësisë të Brendshme të Cilësisë, janë gjithashtu pjesë e këtij vlerësimi. **Evidenca 3.10, Evidenca 3.12, Evidenca 3.8, Evidencë 3.4** |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Sikundër përmendëm, eksperienca në akreditimin institucional ka shërbyer si një përvojë pozitive edhe për metodikën e punës por edhe për të formalizuar gjithë instrumentet e posaçme për vlerësimin e programit të studimit: Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Manualin e Vlerësimit të Performancës të Personelit Akademik, Rregullorja "Mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në Universitetin e Tiranës" si dhe njësi kryesore për mbikëqyrjen e këtij procesi: **Evidenca 3.5.** Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Kurrikulës në rang universiteti dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe e Karrierës në rang fakulteti. Të gjitha këto instrumenta përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit që IAL ofron. **Evidenca 3.6, Evidenca 3.7;** Paketa e instrumenteve të cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera. | Bazuar në gjetjet gjatë vizitës në institucion rezulton se në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies: analizat vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore në rang departamenti, dhe më pas në nivel fakulteti të cilat pasqyrohen në raportet përkatëse ku analizohen të gjithë elementët matës të cilësisë; dekanati me strukturat e tij ushtrojnë kontrolle mbi kryerjen e procesit mësimor përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore monitorojnë procesin e mësimit, realizimin e programit mësimor, veprimtarinë kërkimore-shkencore, realizimin e seancave laboratorike të studentëve, procesin e provimeve, performanca e personelit akademik. **Evidenca 1.14; Evidenca 1.15** Gjithashtu, nga ana tjetër, DSBCK realizon pyetësorët periodikë me studentët dhe harton analizat dhe raportet përkatëse të cilat publikohen edhe në faqen ëeb dhe merren në analizë nga departamenti. Programi i studimit, mbi bazën e sugjerimeve të bëra, është fleksibël dhe pasqyrohen ndryshimet deri 20%. **Evidenca 1.16, Evidenca 2.7, Evidenca 3.11. Evidenca 3.10, Evidenca 3.12, Evidenca 3.8, Evidencë 3.4** |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që | Përdoren disa metoda dhe praktika të tërthorta vlerësimi: nëpërmjet pyetësorëve, merret mendimi dhe vlerësimi për cilësinë e programit të studimit nga studentët përpara diplomimit. Gjithashtu, merret dhe mendimi dhe vlerësimi i të diplomuarve për argumente që vlerësohen si kyçe për cilësinë e programit të studimit. Njësia bazë ka realizuar gjithashtu edhe një studim tregu, përtej asaj të realizuar në nivel institucional. **Evidenca 3.7.** UT kryen në rang institucional analizë të tregut të punës, për të parë tendencën e tregut të punës për të diplomuarit në programet e studimit, vështirësitë dhe analizohen elementët që duhen përmirësuar në cilësinë e programeve të studimit. Gjithashtu, departamenti realizon në fund të çdo semestri pyetësorin "Raport i vetëvlerësimit të lëndës" nga secili anëtar i personelit akademik, i cili ndihmon të evidentohen edhe përmirësimet që duhen të bëhen për lëndët dhe ndryshimet në përputhje me standardet dhe kërkesat e ASCAL. |

| | |
|---|---|
| bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | Njëkohësisht, në procesin e vlerësimit të programit mësimor merr pjesë edhe personeli ndihmës akademik. **Evidenca 1.9**<br>Gjithashtu, një instrument i rëndësishëm për të tërhequr mendim dhe vlerësim mbi programin e studimit dhe sa i përgjigjet ai tregut të punës janë dhe studimet e tregut të punës të organizuara nga Universiteti i Tiranës ku përfshihet dhe pjesa e Departamentit të Fizikës.<br>Gjithashtu, tërheqja e mendimit të studentëve të diplomuar është realizuar edhe nëpërmjet statistikave të punësimit. Konkretisht, Univesiteti i Tiranës ka realizuar në vitin 2018 Studimin e Tregut në nivel institucional. Grupi i punës i ngritur me vendim të Senatit Akademik Nr. 4, datë 22.02.2018, hartoi një raport të hollësishëm mbi tregun e punës për studentët e diplomuar në UT përfshirë edhe studentët e FSHN. Raporti jep një panoramë të specialiteteve që ofron Universiteti i Tiranës në tregun e punës bazuar në të dhënat e marra nga Fakultetet e Universitetit dhe të numrit të studentëve që diplomohen. **Evidenca 1.8** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Mbështetur në gjithë dokumentet zyrtare të tij, UT parashikon dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Një nga aktorët e rëndësishëm të brendshëm janë studentët, të cilëve ju garantohet edhe pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në struktura si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës apo angazhohen edhe në Grupet e Vlerësimit të Brendshëm për vlerësime institucionale dhe të programit të studimit. Në dokumentet zyrtare si Statuti dhe rregullore të tjera institucionale, UT ka të sanksionuar një politikë dhe procedurë të brendshme të përcaktuar qartë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. **Evidenca 3.17, Evidenca tabela përmbledhëse Tabela 24** |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, UT ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike të brendshme me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Statuti i UT-së përshkruan qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet instrumentat dhe burimet për sigurimin e brenshëm të cilësisë. **Evidenca 1.1, Evidenca 1.2;**<br>Studentët janë të angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse lidhet direkt me sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. **Evidenca 3.5;** Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT. **Evidenca 3.17, Evidenca tabela përmbledhëse Tabela 24** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | Nga verifikimet gjatë vizitës, përveç studentëve, aktorët bazë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit janë edhe anëtarët e njësisë bazë dhe njësia kryesore (FSHN) me strukturat e saj. Roli i tyre është i mirë përcaktuar në aktet rregullatore institucionale në kuadër të përmirësimit të vazhduar të cilësisë në UT. FSHN ka përfaqësuesit e saj në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) dhe Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës, kurse Departamenti ka përfaqësuesit e tij në Komisionin e Përhershëm të Kurrikulës. Në FSHN është ngritur dhe funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) e cila organizon dhe mbikëqyr gjithë procesin e sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti. Studentëve iu garantohet pjesëmarrja aktive në organet vendimmarrëse në të gjitha nivelet, por edhe në strukturat e sigurimit të cilësisë së programit të studimit, ashtu dhe si faktor që jep mendime dhe vlerësime për përmirësimin e programit të studimit, qoftë direkt me anketimet, pyetësorët, procesit të këshillimit brenda Departamentit, ashtu edhe nëpërmjet Këshillit Studentor. **Evidenca 3.17, Evidenca tabela përmbledhëse Tabela 24**<br>**Ankes; Tabela 24, ASCAL.** |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | Në respekt të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", gjatë procedurave që kryhen nga strukturat përkatëse të sigurimit të cilësisë për vlerësimin e programit të studimit, respektohet integriteti akademik, etika dhe liria akademike. Të gjithë pyetësorët që kryhen me studentët në mënyrë periodike janë të tilla që ruajnë anonimatin dhe konfidencialitetin e tyre.<br><br>**Evidenca; Faqe web e Degës së sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe karrierës në FSHN.** |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Nga evidentimi i bërë, rezulton që në aspektin e aktivizimit si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm, kryhet Panairi i Karrierës të organizuara nga UT/FSHN ku marrin pjesë subjekte publike dhe private. Gjithashtu është organizuar dhe "Java e Europës në Universitetin e Tiranës". Gjithashtu mobilitetet Erasmus/+ kanë ndihmuar në këtë proces.<br>Nga takimi i GVJ me stafin e Departamentit të Fizikës, u vu re se DF organizon takime me studentët (kryesisht në kuadër të lëndës "Njohje me profesionin") duke ftuar here pas here ish studentë të këtij programi studimi që janë në punë në sektorë të ndryshëm dhe të cilët në takime me studentët aktuale paraqesin përvoja të tyre apo dhe paraqesin tema nga sektori i tyre i punës. Kjo praktikë vlerësohet shumë pozitive për të motivuar studentët e këtij programi studimi në thellimin e njohurive të tyre profesionale sipas edhe eksperiencës së profesionistëve të formuar në këtë program studimi. Gjithashtu, Departamenti organizon edhe leksione të hapura nga vetë personeli akademik ose dhe të ftuar nga jashtë vendit. **Evidenca 2.10** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi VI.5**

| Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Institucioni bën transparente dhe publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit, politikën, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për të gjitha programet e studimit. **Evidence 1.2; Evidenca 3.8**<br>Në faqet ëeb të FSHN dhe UT bëhen publike Analiza e Pyetësorëve, Statuti, Rregullorja, Vendime të Senatit Akademik, Vendime të Bordit të Administrimit, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Edhe njësia bazë, në faqen e vet bën publike dokumentacionet bazë që lidhen me këtë program studimi.**Evidencë 3.4, Evidenca 1.5 Evidenca 3.9** |
| **Kriteri 2.** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Vlerësojmë se gjithë rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit që përpilojnë strukturat e institucionit respektojnë lirinë dhe etikën akademike, duke u bazuar edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 11.09.2018. **Evidenca 3.10; Evidenca 3.11; Evidenca 3.12; Evidenca 3.4** |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Rezulton që rezultatet e vlerësimit shoqërohen me plan masash konkrete për përmirësimin e mangësive dhe dobësive që janë evidentuar nga procesi i anketimeve me studentët dhe vetëvlerësimi i personelit akademik.<br>**Evidenca 3.10; Evidenca 3.11; Evidenca 3.12; Evidenca 3.4;** |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstaton një vullnet të qartë nga ana e UT-se në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. Nëpërmjet këtij plani Departamenti i Fizikës siguron efektivitet për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të studimit. **Evidenca 1.2, Evidenca 3.11; Evidenca 3.12** |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion, rezulton se Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës organizon aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin Studentor, me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion. Megjithatë, kjo nuk ka rezultuar e mjaftueshme për të rritur pjesëmarrjen e studentëve në plotësimin e pyetësorëve apo anketimeve në lidhje me të gjithë aspektet akademike dhe administrative të organizuara. Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në këto anketime, do të rriste bazën statistikore për të bërë të vlefshme rezultatet e përgjigjeve nga ana statistikore. **Evidenca 1.2, Evidenca 3.11** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Fizikë", ofruar nga Universiteti i Tiranës**

a. **Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Programi i studimit Bachelor në Fizikë është programi i vetëm në fizikë në nivel kombëtar, i cili siguron diplomimin e studenëve në një program specifik studimi me rëndësi kombëtare.
2. Programi ofrohet nga një prej departamenteve me më eksperiencë dhe përvojë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vend, prej të cilit janë diplomuar breza të tërë profesionistësh e kërkuesish shkencorë të njohur brenda dhe jashtë vendit.
3. Përmbajtja e programit garanton thellim të njohurive dhe avancim në karrierën akademike dhe kërkimin shkencor për studentët që duan dhe synojnë karrierën akademike.
4. Departamenti i Fizikës ka në strukturën e vet personel akademik të kualifikuar dhe me eksperiencë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
5. Infrastruktura laboratorike në funksion të programit të studimit janë cilësore dhe garantojnë aplikim të njohurive në praktikë.
6. Departamenti dhe fakulteti kanë infrastrukturë cilësore në shërbim të studentëve, përfshirë bibliotekën, shërbimet e teknologjisë së informacionit, shërbimin e karrierës, etj.

b. **Pika të dobëta:**

1. Programi i studimit nuk ka të parashikuar në kurrikul kreditet respektive për praktikën profesionale.
2. Kërkesa dhe regjistrimi në programin e studimit rezulton të jetë i ulët nga maturantët, çka rrezikon ecurinë afatgjatë të funksionimit të tij.
3. Pamundësia për të regjistruar maturantë me rezultate të larta, ndikon në cilësinë e studentëve të diplomuar.

c. **Rekomandime:**

1. Në vitet në vijim, brenda nivelit 20%, të shihet mundësia e përfshirjes së praktikës profesionale në programin e studimit.
2. Programi i studimit ka nevojë të mbështetet nga institucioni nëpërmjet politikave promovuese në mënyrë që të rritet interesi i maturantëve për tu regjistruar në të ardhmen në këtë program studimi.

## Conclusions of the evaluation of the first cycle study program Bachelor, in "Physics" of the University of Tirana

**a. Strengths and Affirmations:**

1. The Bachelor study program in Physics, is the only program at the national level, which ensures the graduation of students in a specific study program of national importance.
2. The program is offered by one of the departments with the most experience and in the field of higher education and scientific research in the country, from which many generations of professionals and scientific researchers, known in the country and abroad, have graduated.
3. The content of the program guarantees deepening of knowledge and advancement in academic career and scientific research for students who want and aim for academic career.
4. The department of Physics has in its structure qualified academic personnel with many years of experience in teaching and scientific research.
5. Laboratory infrastructure in function of the study program are qualitative and guarantee the application of knowledge in practice.
6. The department and faculty have quality infrastructure in the service of students, including the library, information technology services, career service, etc.

**b. Weaknesses:**

1. The study program does not provide the respective credits for professional practice in the curriculum.
2. The demand and enrollment in the study program turns out to be low among graduates, which endangers the long-term progress of its operation.
3. The inability to register graduates with high results affects the quality of graduated students.

**c. Recommendations:**

1. In the following years, within the 20% level, the possibility of including professional practice in the study program should be considered.
2. The study program needs to be supported by the institution through promotional policies in order to increase the interest of graduates to enroll in this study program in the future.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |

Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

1. RVB_i_plote_Bachelor ne Fizike.pdf
2. Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Fizika.pdf
3. Vetdeklarimi Fizike.pdf
4. 1. Mendimi Dekanit Fizike.pdf
5. Lista e dokumenteve bazë për proçesin e akreditimit.pdf
6. 2. Statuti_UT.pdf
7. 3.Strategjia_ e_zhvillimit_UT.pdf
8. 4. Plani_strategjik_zhvillimi_programit.pdf
9. 5. Rregullore_UT.pdf
10. 6. Rregullore_ Departamentit_Fizike.pdf
11. 7. Rregullore Bachelor Fizike.pdf
12. 8. Rregullore_ DSBC_FSHN.pdf
13. 9. Rregullore_sekretarise_mesimore_FSHN.pdf
14. 9.1 Vendim Miratim Rregulloresh.pdf
15. 10. Rregullore Diplomimi per Programet e Ciklit I_FSHN.pdf
16. 11. Rregullore_zyres_burimeve_njerezore.pdf
17. 14.1 Modeli_diplomes_Fizike.pdf
18. 14.2 Suplementi_diplomes_Fizike.pdf
19. 15 Studimi_ i_ tregut_ te_ punes.pdf
20. 16.Tabelat permbledhese per Aneks_RVB Fizika.pdf
21. 17.1 Marreveshjet_e_bashkepunimit_Fizika.pdf
22. 17.2 Marrëveshje_bashkepunimi_FSHN.xlsx
23. 18. Raport_i_perfitimeve_marreveshjet.pdf
24. 19. Vendimi_koordinatori +detyrat.pdf
25. 22. Pyetesori_i_stafit_akademik.doc
26. 22. Udhezues-i-UT-per-mesimin-ne-distance.pdf
27. 23. Pyetesori_i_studentit_ 2020-2021.pdf
28. 24. Pyetesori_i_stafit_akademik.pdf
29. 25. Te dhena per infrastrukturen FSHN.pdf
30. 26. Te_dhena_te_plota_aktivitete_kualifikime_kerkime.pdf
31. 27. Formati_dosjes_personale.pdf
32. 28.1 Lista_e_teksteve_ne_ biblioteke.pdf
33. 28.2 Rregullore Bibliotes-FSHN.pdf
34. 29.1 Udhezues e-Pedagog.pdf
35. 29.2 Udhezues e-Student.pdf
36. 30. Te dhena_ ËEB_kritere_pranimi.pdf
37. 31. Politikat_programi transparences_linqet_UT_FSHN_DF.docx
38. 32.1 Buxheti_UT_2021.pdf
39. 32.2 Buxheti_UT_2020.pdf
40. 32.3 Buxheti_UT_2019.pdf
41. 32.4 Buxheti_UT_2018.pdf
42. 33 Pojekt-Buxhet_ Fizika_2021.xlsx
43. 35. Procedura_ndryshim_kurrikule.pdf
44. 36. Procesverbal_mbledhje_vendime.pdf
45. 47-48 - Raporti financiar vjetor institucional që lidhen me kostot e programit Bachelor ne Fizike.docx
46. 18.1 Raporti vjetor FSHN_2020-2021.docx
47. 18.1.1 Shkrese percjellese per raportin vjetor 2020-2021.pdf
48. 18.2 Raporti vjetor_ FSH _2019-2020.docx
49. 18.2.1 Shkrese percjellese per raportin vjetor 2019-2020.pdf
50. 18.3 Raporti vjetor FSHN_2018-2019.docx
51. 18.3.1 Shkrese percjellese per raportin vjetor 2018-2019.pdf
52. Raport_Vjetor_DSBCK_2019_2020.pdf
53. Raport_Vjetor_DSBCK_2020_2021.pdf
54. analiza e veprimtarise 19-20-10012019215949.pdf
55. analiza e veprimtarise 20-21-10012019220222.pdf

56. analiza e veptimtarise 18-19-10012019215813.pdf
57. 1_10_BROSHURE_DITET E INFORMIMIT TE MATURANTEVE_2019.pdf
58. 1_10_ditet e maturantit 2.pdf
59. 1_10_ditet e maturantit.jpg
60. 1_10_IMIT TE MATURANTEVE_2019.pdf
61. 1-Plani mesimor për programin e studimit Bachelor në Fizikë për vitin akademik 2021-2022.pdf
62. 2-Plani mesimor për programin e studimit Bachelor në Fizikë për vitin akademik 2020-2021.pdf
63. 3-Plani mesimor për programin e studimit Bachelor në Fizikë për vitin akademik 2019-2020.pdf
64. 4-Plani mesimor për programin e studimit Bachelor në Fizikë për vitin akademik 2018-2019.pdf
65. 5-Raport mbi programin e studimit Bachelor në Fizike.pdf
66. 6- Personeli akademik 2021-2022 për programin Bachelor në Fizikë.docx
67. 7- Personeli akademik 2020-2021 për programin Bachelor në Fizikë.docx
68. 10- Suplement diplome BSc Fizike.pdf
69. 11-Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Fizikë.pdf
70. Lista e paraqitjes se materialeve ne dosje.docx
71. Syllabuset e lëndëve 2018 - 2019.pdf
72. Syllabuset e lëndëve 2019 - 2020.pdf
73. Syllabuset e lëndëve 2020-2021 (te printuara Viti I, II, III).pdf
74. 1_1_Statuti i UT 2018.pdf
75. 1_2_Strategjia-e-zhvillimit-UT-2018-2023.pdf
76. 1_3_RREGULLORE_Bachelor ne Fizike.docx
77. 1_4_PLANI STRATEGJI D.FIZ. 2017-2027 FINAL.doc
78. 1_5_RREGULLORE_UT_perditesuar_2016_1_a10025c5c0.pdf
79. 1_6_Rregullore Dep Fiz e perditesuar.docx
80. 1_8_Suplement_Diplome_BSc_Fizike.pdf
81. 1_9_Studimi i tregut te punes_final_2018.pdf
82. 1_10_BROSHURE_DITET E INFORMIMIT TE MATURANTEVE_2019.pdf
83. 1_10_ditet e maturantit 2.pdf
84. 1_10_ditet e maturantit.jpg
85. 1_10_IMIT TE MATURANTEVE_2019.pdf
86. 1_11_Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf
87. 1_12_B. Institucionale & Projekte.xlsx
88. 1_12_Bashkepunime.departamenti Fizika.xlsx
89. 1_14_RAPORTI VJETOR FSHN UT 2019-2020_Final.docx
90. 1_14_shkrese percjellese per raportin vjetor 2019-2020.pdf
91. 1_15_RAPORTI VJETOR FSHN UT 2020-2021_final.docx
92. 1_15_shkrese percjellese per raportin vjetor 2020-2021.pdf
93. 1_16_FSHN_Raporti Shkencor 2018-2019 (1).docx
94. diplomat (1).rar
95. RAPORTI VJETOR 2018-2019 DEP FIZIKA.rar
96. suplementet e diplomes.rar
97. 2_1_VKM_nr_41_date_24_1_2018_9fab9164a8.pdf
98. 2_3_VKM_Nr_879_date_18_12_2019_46b1a0c982.pdf
99. 2_4_VKM-nr.-418-date-10.5.2017.pdf
100. 2_5_Udhezim-nr.-10-date-15-05-2019-i-përditësuar-pranimet-ne-IAL.pdf
101. 2_7_vendim i senatit, nr 29, 21.10.2020.pdf
102. 2_11_Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf
103. 2_12_Udhezimi-nr.-36-dt.-23.11.2018.pdf
104. 2_13_Udhezimi-nr.-37-dt.-04.12.2018.pdf
105. udhezimi 15. date 4.4.2008.pdf
106. 3_2_Udhezues-i-UT-per-mesimin-ne-distance.pdf
107. 3_4_Raporti mbi sondazhin e mesimit online semestri II v.a. 2019-2020.pdf
108. 3_5_UT_Rregullore_per_sigurimin_e_cilesie (1).docx
109. 3_6_UT-Manual i sigurimit te cilesise- (2).docx
110. 3_1_Rregullore e posacme e Universitetit te tiranes mbi zhvillimin online te sezonit te dimrit, 2020-2021.pdf
111. 3_7_UT-Paketa e instrumentave (1).doc
112. 3_8_7.Dep.Fizikës_Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, Sem I 2020-2021.docx
113. 3_8_Raport i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu, Sem I 2020-2021.pdf
114. 3_9_Statistika në nivel lëndësh për semestri I 20-21.pdf

115.3_10_Raport Vleresimi i studenteve qe diplomohen_2020-2021_ FSHN UT.pdf
116.3_11_Statistika në nivel programi studimi, Sem 1 2020-2021.pdf
117.3_12_Raporti i Studentit, 20-21 FSHN UT.pdf
118.3_13_PROJEKT-BUXHETI I DEPARTAMENTIT TE FIZIKES PER 2021 (1).xlsx
119.3_14_RREGULLORE-PER-FUNKSIONIMIN-E-SISTEMIT-INFORMATIK-NË-UNIVERSITETIN-E-TIRANËS.pdf
120.3_17_ANETARET GVB FSHN-05112018234332.pdf
121.3_17_GVB-FSHN.pdf
122.3_20_Marrëveshje të FSHN me kompani,institucione të tjera v. 1016-2021.xlsx
123.3_21_vendimi-nr28-1.pdf
124.3_22_Plan Mes Bach_FIZIKA 2021-2022.xlsx
125.3_23_teze provimi.docx
126.3_24_kodi-i-etikes i UT.pdf
127.3_25_Vendim_Senati_nr._9.1.pdf
128.3_26_proces verbal provimi.pdf
129.Vendim_Senati_Akademik_Nr.11.pdf
130.Evidenca 4.2 Organigrama_366fe6f64d.pdf
131.Evidenca 4.3 Vendimi-I-KM-Nr.-329-datë-1242017.pdf
132.Evidenca 4.5 MANUALI PUNESIMIT V. NR.2 DATE 24.01.2022- (1).pdf
133.Evidenca 4.7 APP_PEDAGO_INFORMA_DHE_FIZIKE_1_e54b6d67a9.pdf
134.Evidenca 4.10 Ëorkshop The Third International Ëorkshop on recent LHC result and related topics in Tirana.pdf
135.Evidenca 4.11 THIRRJE-PËR-PROJEKTE-NË-PROGRAMIN-"UT-KËRKIM-EKSELENCË-DHE-INOVACION".docx
136.Evidenca 4.12 Udhezues_i_UT_per_mesimin_ne_distance_f2c2b81980.pdf
137.Evidenca 4.13 INFRASTRUKTURA FSHN.pdf
138.Evidenca 4.14 Laboratoret Bachelor.pdf
139.Evidenca 4.15 Buxheti_2018_912d0505b3.pdf
140.Evidenca 4.16 Buxheti_2019_ff1c57cca3.pdf
141.Evidenca 4.17 Miratim_buxheti_2020_UT_f7c6ff4722.pdf
142.Evidenca 4.18 Miratim_buxheti_2021_UT_d1e66cd832.pdf
143.Evidenca 4.19 Inventar i laboratorit te Optikes.pdf
144.Evidenca 4.20 Inventar i laboratorit te Informatikes.pdf
145.Evidenca 4.23 EKUJVALENTIME_ KATEGORIA TRANSFERIME_ DEGE TE DYTA-23092018044644.pdf
146.Evidenca 4.29 vendim_126_dt25.07.2019.pdf
147.Evidenca 4.33 Vendimi-nr.-56-datë-20.11.2019.pdf
148.Evidenca 4.34 Vendim_i_Bordit_të_Administrimit_UT.pdf
149.Evidenca 4.35 Rregullore Bibliotes-FSHN.pdf
150.Evidenca 4.36 Manual perdorimi e-Student.pdf
151.Evidenca 4.37 Manual Pedagog e-Student.pdf
152.Certifikate_Notash_708a75015a.pdf
153.Liste_notash_bbe16f89c3.pdf
154.Program_studimi_ne_anglisht_9c6fcb760a.pdf
155.Program_studimi_ne_shqip_2eee4a0ed4.pdf
156.Tarifa_per_studentet_e_Ciklit_te_Pare_Viti_I_67d392774c.pdf
157.Vertetim_studenti_4663fbb0e0.pdf
158.Procedure punesimi PAE 1.pdf
159.Procedure punesimi PAE.pdf
160.Procedure punesimi PAK.pdf
161.Evidenca 5.1 Viti_akademik_2019_2020_c2710f6af4.pdf
162.Evidenca 5.2 Viti_akademik_2020_2021_aaa4157cc0.pdf
163.Evidenca 5.3 PRANIMET E REJA V. 2019-2020.pdf
164.Evidenca 5.4 VKM-436-Datë-03.06.2020.pdf
165.Evidenca 5.5 Viti_akademik_2020_2021_ab7a515122.pdf
166.Evidenca 5.6 Udhëzim-nr.17-datë-30.7.2019.pdf
167.Evidenca 5.7 Urdhër i Përbashkët Nr.2 dt 02.07.2020.pdf
168.Evidenca 5.8 BROSHURA_DITET E INFORMIMIT TE MATURANTEVE_2022.pdf
169.Evidenca 5.11 GUIDA_E_FAKULTETIT_TE_SHKENCAVE_TE_NATYRES_19_20_2b20916888.pdf

170. Evidenca 5.12 GUIDA_E_FAKULTETIT_TE_SHKENCAVE_TE_NATYRES_9b4520b309.pdf
171. Evidenca 5.15 Studimi i tregut te punes_final_2018.pdf
172. Evidenca 5.17 63.Udhëzim-I-Ministrise-së-Arsimit-Sportit-dhe-Rinisë-Nr.-5-datë-19022018.pdf
173. Evidenca 5.18 Vendim-nr-50-PËR-MIRATIMIN-E-RAPORTIT-VJETOR-TË-VEPRIMTARISË-SË-UNIVERSITETIT-TË-TIRANËS-PËR-VITIN-AKADEMIK-2017-2018.pdf
174. Evidenca 5.19 Vendim 26 i SA.pdf
175. Evidenca 6.1 Vendim-nr-51-PËR-MIRATIMIN-E-PAKETËS-SË-DOKUMENTAVE-PËR-SIGURIMIN-E-CILËSISË-NË-UNIVERSITETIN-E-TIRANËS.pdf
176. Evidenca 6.3 Vendim Nr. 39 i Bordit të Administrimit, datë 04.04.2018.pdf
177. Evidenca 6.5 Vendimi i Bordit te Akreditimit Nr.84, date 27.10.2018.pdf
178. Evidenca 6.6 vendim 29 i Senatit Akademik.pdf

Evidenca 6.7 Vendimi_i_Senatit_Akademik_nr._12_date_26.04.2018.pdf

179. Evidenca 6.8 1841_1 Prot. Përcillen raportet e pyetësorëve të zhvilluar për vitin akademik 2020-2021.pdf
180. Evidenca 6.9 Statistika në nivel lëndësh për semestri I 20-21.pdf
181. Evidenca 6.10 2018-2019_Njoftim per percjelljen e rezultateve te pyetesoreve per pedagoget.pdf
182. Evidenca 6.11 Raport Vjetor DSBCK 2020-2021.pdf
183. Evidenca 6.12 Raport_Vjetor_DSBCK_2019_2020_1236688c4e.pdf
184. Evidenca 6.13 vendimi-nr30-1.pdf
185. Evidenca 6.14 Manuali i perfomances se pesonelit akademik.pdf
186. Evidenca 6.15 VENDIMI_NR_3_DT_24_01_2022.pdf
187. Evidenca 6.17 Grupet mesimore kerkimore.pdf
188. Evidenca 6.18 Performance e pedagogeve MSc.pdf
189. Evidenca 6.19 Vendimi_i_SA_nr._4_date_22.02.18.pdf
190. Evidenca 6.20 Urdher i brendshem Nr.25 i GVB UT Akreditimi Institucional.pdf
191. Evidenca 6.22 RAPORTI_I_VLERESIMIT E_LENDEVE_SEMESTRI_I_20_21Nivel_Fakultetit_dhe_Departamenti_7d28de74fd.pdf
192. Evidenca 6.26 Ligji_9887_date_10_-03_2008_i_ndryshuar-2.pdf
193. Evidenca 6.27 certifikate-akreditimi.pdf
194. Evidenca 6.28 Plani i masave nga Departamenti i Fizikes.pdf
195. Lista e CV staf.doc
196. Takimi me përgjegjësin e departamentit
197. Takimi me personelin akademik
198. Takimi me studentët
199. Vizita në mjediset e institucionit